



INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI

# LIGJSHMËRIA E KËSHILLIT GJYQËSOR DHE PROKURORIAL

Monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial:  
Analizë e zbatimit të pakos ligjore të gjyqësorit



Prill, 2016

**Autorët:** Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

**Juristë dhe monitorues:** Adem Krasniqi, Erlina Tafa, Valdet Hajdini,  
Arbelina Dedushaj, Diana Berisha, Lutfi Morina, Verona Kadriu, Syzana Rexhepi

**Monitoruese:** Hyrije Mehmeti, Bukurezë Surdulli, Gita Lushi

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

## **RRETH IKD**

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Objekti C2, Hyrja II, Kati IV, Nr. 8

Rr. Hajdar Dushi

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:



British Embassy  
Pristina

## Përmbajtja

|       |   |    |
|-------|---|----|
| I.    | PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....  | 5  |
| II.   | METODOLOGJIA .....  | 8  |
| III.  | ZBATIMI I LIGJEVE TË GJYQËSORIT NGA KGJK DHE KPK DHE ZBATIMI I<br>STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE .....             | 9  |
|       | a) Pavarësia e gjyqësorit.....  | 12 |
|       | b) Dështimi i KGJK dhe KPK në miratimin e legjislacionit sekondar.....  | 13 |
|       | c) Llogaridhënia e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.....   | 15 |
|       | d) Amnistia e shkeljeve të supozuara nga gjykatësit dhe prokurorët përmes ligjeve.....                        | 18 |
|       | e) Transparenca e KGJK dhe KPK në raport me publikun dhe mediat .....   | 20 |
|       | f) Transferimi dhe ngritja në detyrë e gjykatësve dhe prokurorëve.....  | 21 |
|       | g) Mungesa e mbrojtjes efikase gjyqësore për gjykatësit dhe prokurorët .....                                  | 23 |
| IV.   | OBLIGIMET E KGJK DHE GJYKATËS SUPREME LIDHUR ME ZBATIMIN E LIGJEVE<br>TË PLOTËSUARA PËR KGJK DHE GJYKATA..... | 24 |
| V.    | MIRATIMI I LEGJISLACIONIT SEKONDAR DHE POLITIKAVE NGA KGJK .....  | 26 |
|       | a) Rregulloret .....  | 27 |
|       | b) Pjesëmarrja dhe diskutimi i anëtarëve të KGJK-së në takime .....   | 32 |
|       | c) Transparenca e KGJK-së në publikimin e rregulloreve, strategjive, raporteve dhe vendimeve .....            | 35 |
| VI.   | OBLIGIMET E KPK LIDHUR ME ZBATIMIN E LIGJEVE TË PLOTËSUARA PËR KPK<br>DHE PSH.....                            | 36 |
| VII.  | MIRATIMI I LEGJISLACIONIT SEKONDAR DHE POLITIKAVE NGA KPK .....   | 38 |
|       | a) Rregulloret .....  | 40 |
|       | b) Vendimet e KPK .....   | 53 |
|       | c) Pjesëmarrja dhe diskutimi i anëtarëve të KPK-së në takime .....  | 55 |
|       | d) Transparenca e KPK në publikimin e rregulloreve, strategjive dhe vendimeve .....                           | 58 |
| VIII. | REKOMANDIMET .....  | 59 |
|       | a) Rekomandimet për Ministrinë e Drejtësisë.....  | 59 |
|       | b) Rekomandimet për Kuvendin e Kosovës.....   | 60 |
|       | c) Rekomandimet për Këshillin Gjyqësor të Kosovës .....   | 60 |
|       | d) Rekomandimet për Këshillin Prokurorial të Kosovës.....   | 62 |

## SHKURTESAT:

|        |   |
|--------|---|
| AKK    | Agjencia Kundër Korrupsionit                    |
| BE     | Bashkimi Evropian                               |
| IKD    | Instituti i Kosovës për Drejtësi                |
| KPK    | Këshilli Prokurorial i Kosovës                  |
| KGJK   | Këshilli Gjyqësor i Kosovës                     |
| GJTh   | Gjykatë Themelore                               |
| PTh    | Prokurori Themelore                             |
| PSRK   | Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës     |
| PA     | Prokuroria e Apelit                             |
| ZPD    | Zyra e Prokurorit Disiplinor                    |
| MD     | Ministria e Drejtësisë                          |
| OAK    | Oda e Avokatëve të Kosovës                      |
| ZKPSH  | Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit                |
| KEDNJ  | Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut     |
| GJEDNJ | Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut      |
| UA     | Udhëzime Administrative                         |
| KEED   | Komisioni European për Efikasitetin në Drejtësi |
| KPGJP  | Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial  |
| KLGP   | Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial       |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kuvendi i Republikës së Kosovës në maj të vitit 2015 ka miratuar plotësim ndryshimin e pakos së ligjeve të gjyqësorit, me qëllim të harmonizimit të dispozitave ligjore në mes këtyre ligjeve që ndërlihet me procesin e emërimit, ri-emërimit, transferimit, disiplinimit dhe shkarkimit të gjykatësve dhe prokurorëve dhe dispozitave tjera. Harmonizimi i dispozitave të këtyre ligjeve ishte caktuar kriter që duhej plotësuar nga Kosova lidhur me procesin e liberalizimit të vizave dhe Marrëveshjes për Stabilizim Asociim mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Edhe përkundër faktit që Kosova kishte arritur që të plotësoj këtë kriter përmes miratimit të pakos së ligjeve, në praktikë gjatë miratimit të akteve dhe politikave të brendshme, Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial kishte devijuar këtë rrugë, duke aplikuar praktika dhe standarde të ndryshme. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka vërejtur se ka munguar bashkëpunimi dhe koordinimi në mes të dy Këshillave gjatë plotësimit dhe ndryshimit të akteve të brendshme në pajtim me pakon e ligjeve të gjyqësorit.

Këshillat përballen me mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale në planifikimin, hartimin dhe miratimin e legjislacionit sekondar. Këshillat ende nuk kanë arritur të ndërtojnë mekanizma efikas për monitorimin e zbatimit të politikave të miratuara nga dy Këshillat, legjislacionit primar dhe sekondar nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial.

Përfundimisht pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës në aspektin kushtetues dhe ligjor mund të konsiderohet i pavarur nga dy pushtetet tjera. Kjo pasi në fund të shkurtit 2016, Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka votuar ndryshimet kushtetuese për sa i përket shumicës së anëtarëve të KGJK-së që përzgjidhen nga vetë gjyqësori. Ky rekomandim, ishte adresuar vazhdimisht nga IKD dhe organizata ndërkombëtare, për të siguruar pavarësinë e sistemit gjyqësor. Pavarësisht këtyre hapave të rëndësishëm në drejtim të rritjes së pavarësisë të sistemit gjyqësor mbetet të shihet nëse do të ketë vullnet politik të aprovohen kërkesat buxhetore për të mundësuar funksion efikas dhe efektiv të gjyqësorit.

Edhe sa i përket pavarësisë së sistemit prokurorial është shënuar një avancim në drejtim të pavarësisë të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK). Me miratimin e ndryshimeve të Ligjit për KPK-në, nga 1 janari 2016, përfaqësuesi i pushtetit ekzekutiv, Ministri i Drejtësisë, më nuk është anëtar i KPK-së. Gjithashtu, Kryeprokurori i Shtetit, nuk është Kryesues i KPK-së, por vetëm anëtar.

Për shkak të rregullimit të gabuar të dispozitave ligjore në Ligjin për KGJK dhe KPK, Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) ka mbetur e papërfaqësuar në të dy Këshillat. Këto ligje, ia ndalojnë avokatëve që zgjidhen si anëtarë të Këshillave që të ushtrojnë funksionin e tyre. Kjo praktikisht ka lënë OAK-u pa përfaqësim në të dy Këshillat. Ndërsa, funksionimi në KPK vazhdon pa përfaqësim nga Shoqëria Civile dhe Fakultet Juridike.

IKD ka gjetur se përbërja e KPK-së pjesën më të madhe të vitit 2015, ka qenë në përbërje të kundërligjshme. Kjo ishte evidentuar edhe në vet raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2015.

KGJK dhe KPK kanë dështuar në masë të madhe të zbatojnë obligimet ligjore në nxjerrjen e legjislacionit sekondar. Pavarësisht një numri të rregulloreve të miratuara nga të dy Këshillat, mungojnë një numër i madh i rregulloreve bazike që mundësojnë funksionimin efikas të sistemit

prokurorial dhe gjyqësor. Ndër rregulloret më të rëndësishme ndërlidhen me transparencën dhe llogaridhënien e sistemit prokurorial dhe gjyqësor. Bartësit dhe përfaqësuesit e të dy Këshillave theksojnë se mungesa e legjislacionit sekondar ka krijuar vështirësi në praktikë dhe këto vështirësi kanë qenë konkrete si dhe kanë krijuar mundësi reale për krijimin e praktikave jo të mira, madje në disa raste edhe me standarde të dyfishta.

Një numër i Rregulloreve, Planeve të Veprimit dhe Vendimeve kanë probleme serioze për shkak se kanë devijuar nga fryma e legjislacionit bazik dhe standardet e praktikave më të mira ndërkombëtare. Në këtë drejtim, vlen të theksohet Rregullorja për Emërimin e Kryeprokurorëve, e cila ka devijuar nga Ligji për KPK-në dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit, duke ngatërruar kompetencat e këtyre dy institucioneve të pavarura. Rrjedhimisht, Kryeprokurori i Shtetit është fuqizuar me kompetenca të cilat janë ekskluzivisht të KPK-së. Ngjashëm është vepruar me Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit për Ngritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Llorupsionit dhe Krimeve Ekonomike, përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme. Ky plan tejkalon kompetencat ligjore dhe bie ndesh me standardet ndërkombëtare dhe si i tillë duhet të rishikohet me urgjencë në mënyrë që sistemi prokurorial të ushtroj funksionet në përputhje me ligjin dhe të mundësojë arritjen e rezultateve në luftimin e korrupsionit.

Në lidhje me funksionimin dhe llogaridhënien e gjyqësorit si një dimension i rëndësishëm që lidhet edhe me parimin e pavarësisë së tij, Raporti i Progresit vazhdimisht, ka kërkuar nga sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial të bëjë më shumë për të siguruar funksionimin dhe llogaridhënien e tyre. Mekanizmat aktual të llogaridhënies në sistemin gjyqësor dhe prokurorial deri më tash nuk janë dëshmuar si efikas dhe efektiv. Në kuptim të efikasitetit dhe efektivitetit të këtyre mekanizmave, IKD ka vërejtur një shkelje në mes të KGJK-së dhe Gjykatave si dhe KPK-së dhe Prokurorive. Kjo shkelje ka pamundësuar zbatimin e obligimeve të ndërsjella, rrjedhimisht duke mos u mbajtur askush llogaridhënës. Ende nuk ka asnjë rast kur ndonjë Kryetar Gjykatë apo Kryeprokuror është degraduar për performancë të dobët, mungesë të rezultateve dhe mos zbatim të akteve të Këshillave. Sa i përket llogaridhënies së Këshillave, për dallim prej KGJK-së, e cila ka miratuar Rregulloren për Përgjegjësinë Disiplinore të Anëtarëve të vetë, KPK asnjëherë nuk e ka miratuar një rregullore të tillë lidhur me përgjegjësinë disiplinore për anëtarë të KPK-së. Në praktikë mungesa e kësaj rregulloreje ka imunituar anëtarë të caktuar të KPK-së gjatë vitit 2014 dhe 2015, për të cilët ka pasur akuza publike për shkelje dhe cënim të imazhit të sistemit prokurorial.

IKD gjithashtu ka gjetur se KGJK dhe KPK kanë dështuar në mënyrë të vazhdueshme në kryerjen e obligimeve dhe kompetencave kushtetuese lidhur me mbikëqyrjen dhe kontrollin e gjykatave dhe prokurorive. Të dy Këshillat nuk kanë ndërtuar mekanizma efikas për të ushtruar kontroll mbi gjykatat dhe prokuroritë. Kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët e Prokurorive nuk kanë kryer obligimin për të raportuar para Këshillave lidhur me menaxhimin dhe administrimin e gjykatave dhe prokurorive sipas legjislacionit në fuqi. Tek në fund të vitit të vitit 2015, Kryetarët e Gjykatave Themelore kanë raportuar para KGJK-së, por raporti ka qenë formal dhe aspak llogaridhënës.

Përderisa gjatë vitit 2015, nuk ka pasur ngritje të llogaridhënies, ka pasur amnisti dhe promovim të shkelësve potencial të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale. Kjo është mundësuar përmes neneve 15 dhe 16 të Ligjit për KGJK dhe KPK gjatë procesit të ndryshimit dhe plotësimit të këtyre ligjeve. Me këtë rast, IKD ka reaguar publikisht që kjo amnisti ka prodhuar pasoja negative dhe të pariparueshme për sistemin e drejtësisë. Këto dispozita kanë shkurtuar minimalisht mundësinë e hetimit disiplinor nga Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD), e cila është kufizuar në shkeljet e supozuara që janë të vjetra vetëm deri në dy vjet. Rrjedhimisht, kjo ka prodhuar amnistinë e përgjithshme për një kategori të gjykatësve dhe prokurorëve që kanë qenë duke u trajtuar nga ZPD.

Transparenca dhe llogaridhënia në sistemin gjyqësor dhe prokurorial ende mungon. Kjo ka të bëjë me mungesën e vullnetit të KGJK-së dhe KPK-së për të miratuar *Rregulloren lidhur me Kualifikimin dhe Klasifikimin e Dokumenteve në KGJK dhe Gjykata*, si dhe *Rregulloren për Komunikim me Median dhe Publikun*. Sistemi gjyqësor tanimë ka një numër më të madh të zëdhënësve, por të njëjtit e kanë të vështirë të jenë transparent, përderisa ka mungesë të rregullave për klasifikimin e dokumenteve.

IKD ka gjetur se nuk janë aplikuar praktika dhe standarde uniforme të bazuara në parimin e konkurrencës dhe të bazuar në meritë gjatë procesit të transferimit apo avancimit të gjykatësve dhe prokurorëve. Transferimet deri më tash janë realizuar kryesisht në bazë të kërkesave individuale të paraqitura nga gjykatësit apo prokurorët. Mungesa e rregullave dhe procedurave, ka rezultuar në praktikë me mos zbatim të dispozitave të Ligjit për KGJK dhe KPK, lidhur me caktimin dhe avancimin e gjykatësve dhe prokurorëve, me mungesë të llogaridhënies dhe ndërhyrjeve politike si dhe po ashtu me krijimin e praktikave selektive dhe me standarde të dyfishta lidhur me transferimin dhe avancimin e gjykatësve dhe prokurorëve. Kjo problematikë është theksuar në Raportin i Progresit për vitin 2015, ku janë shprehur shqetësimet lidhur me emërimet e kontestuara dhe se mandatet e paqarta në KGJK, KPK dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Një çështje tejet e rëndësishme që nuk është adresuar në pakon e ligjeve të gjyqësorit në Kuvendin e Kosovës, ndërlidhet me mbrojtjen gjyqësore për gjykatësit dhe prokurorët si dhe palët e tjera kur janë subjekt i vendimeve të Këshillave dhe potencialisht me këto vendime atyre i shkelen të drejtat e tyre. Kjo zbrazëti juridike ishte theksuar në Raportin e Progresit, duke iu referuar procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, ku është kërkuar që gjatë plotësimit ndryshimit të këtyre ligjeve, “*të prezantohen mjetet e duhura ligjore kundër vendimeve të Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor për të shmangur që mundësia e vetme kundër këtyre vendimeve të jetë Gjykata Kushtetuese*”.

Sidoqoftë, edhe përkundër këtij shqetësimi të ngritur dhe kërkesës së paraqitur nga Komisioni Evropian përmes Raportit të Progresit, gjatë plotësimit ndryshimit të ligjeve për KGJK dhe KPK, kjo çështje edhe pse nga Ministria e Drejtësisë ishte propozuar në draftligje, nuk kishte gjetur përkrahje nga Kuvendi i Kosovës.

Aspekt tjetër i rëndësishëm është mungesa e debatit në mesin e anëtarëve të dy Këshillave. IKD gjatë monitorimit të takimeve të KGJK-së dhe KPK-së, ka vërejtur se mungon debati profesional dhe i arsyeshëm në procesin e bërjes së politikave dhe marrjes së vendimeve.

## II. METODOLOGJIA

IKD me qëllim që të përpiloj një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me zbatimin e pakos së ligjeve të gjyqësorit, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit. Në fokus të monitorimit kanë qenë takimet publike dhe aktivitetet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK). Gjithashtu, IKD ka monitorues në të gjitha Gjykatat dhe Prokuroritë e Republikës së Kosovës, të cilët monitorojnë me fokus të veçantë trajtimin e rasteve të korrupsionit. Krahas këtij obligimi monitoruesit e IKD-së janë të fokusuar në zbatimin e obligimeve ligjore nga ana e bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale si dhe stafit mbështetës. Monitorimi fokusohet në baza ditore tek performanca e Gjykatave dhe Prokurorive në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit të cilat miratohen nga KGJK dhe KPK. Të gjitha gjetjet e monitorimit, grumbullohen në Qendrën e IKD-së në Prishtinë, në të cilën analistët juridikë të Institutit, zhvillojnë hulumtim ligjor dhe praktik me të dhënat e terrenit. Kjo metodologji e hulumtimit ofron mundësi praktike që të bëhet identifikimi i problemeve dhe të analizohen të gjitha çështjet që janë me interes në shërbim të zbatimit të ligjit.

Pas identifikimit dhe analizimit të gjetjeve dhe çështjeve problematike karshi ligjit, standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, IKD ka zhvilluar intervista të thella me të gjithë hisedarët e bërjes së politikave dhe ligjeve për institucionet e drejtësisë dhe zbatuesit e këtyre politikave dhe ligjeve. Intervistat janë zhvilluar në bazë të indikatorëve të vendosur si rezultat i monitorimit, gjetjeve dhe vlerësimeve nga ana e analistëve juridikë të IKD-së, të cilat kanë shërbyer për të nxjerrë në pah problemet reale në fushën e legjislacionit primar dhe sekondar si dhe në zbatimin e tyre në praktikë. Intervistat e zhvilluara janë kodifikuar ashtu që çështjet dhe informatat e dala nga to janë përfshirë në raport.

Poashtu, për të qenë sa më të saktë në identifikimin e problemeve si dhe propozimin e rekomandimeve për zgjidhje të problemeve në zbatimin e drejtë të ligjit dhe funksionimin e mirëfilltë nga KGJK dhe KPK, IKD ka analizuar bazën ligjore dhe dokumente relevante vendore dhe ndërkombëtare, të cilat ndërlidhen me pavarësinë dhe funksionimin e Këshillave Gjyqësor dhe Prokurorial.



### **III. ZBATIMI I LIGJEVE TË GJYQËSORIT NGA KGJK DHE KPK DHE ZBATIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE**

Me datë 28 maj 2015, Kuvendi i Kosovës ka miratuar pakon e ligjeve mbi gjyqësorin, respektivisht plotësim ndryshimin e ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ( LKGJK), Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës (LKP), Ligjin për Gjykatat (LGJ) dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit (LPSH). Të gjitha këto ligje ishin miratuar paraprakisht në vitin 2010, dhe kishin hyrë në fuqi me 1 janar 2011 dhe 2013, respektivisht.

Që nga 1 janari 2011, me hyrjen në fuqi të LKGJK dhe LKP, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, veprojnë si dy institucione të ndara, të pavarura nga njëra tjetra si dhe nga pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ, gjatë ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësi të tyre. Përbërësit, LKP neni 5 kishte paraparë që Ministri i Drejtësisë të ishte anëtar i këtij Këshilli sipas detyrës zyrtare, nga nëntë (9) anëtarë të këtij Këshilli. Sidoqoftë, më plotësim ndryshimin e LKP, numri i anëtarëve të LKP-së është ngitur në 13 anëtar, ku Ministri i Drejtësisë nga data 1 janar 2016, nuk është paraparë të jetë anëtar i Këshillit. Po ashtu ndryshim sa i përket anëtarëve të Këshillit, është se nga 1 janari 2016, Kryeprokurori i Shtetit, nuk është sipas detyrës zyrtare Kryetar i Këshillit, por anëtar.

LKGJK përcakton se KGJK është plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një sistemi të drejtësisë të pavarur, të drejtë, të qasshëm, profesional dhe të paanshëm i cili pasqyron natyrën shumë etnike të Republikës së Kosovës dhe zbaton Kushtetutën si dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore. Ky ligj poashtu rregullon organizimin dhe funksionet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) duke përfshirë procedurat për rekrutim, propozim për emërim dhe shkarkim të gjykatësve, riemërim, transferime, disiplinim, vlerësim, ngritje në detyrë dhe trajnim të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë; për menaxhimin dhe administrimin e gjykatave, për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit; dhe themelimin e gjykatave dhe degëve të reja.

LKP përcakton se Këshilli është institucion tërësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një sistemi prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm që pasqyron natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht të barazisë gjinore.

KGJK dhe LKP, si dy institucione të pavarura, janë kompetent dhe përgjegjës në menaxhimin dhe administrimin e gjithmbarshëm të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Republikën e Kosovës, të cilat kompetenca i kanë ushtruar që nga janari 2011. Përbërësit, dy Këshillat nuk kanë pasur kompetence dhe kontroll mbi gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë të EULEX-it, të cilët kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre i kanë ushtruar konform Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë; Ligjit Nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës; Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit; etj.

Plotësim ndryshimi i ligjeve që ndërlidhen me pakon e gjyqësorit, është paraqitur si kërkesë edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2014, ku ndër të tjera thuhej se ligjet e lartpërmendura duhet të harmonizohen për të adresuar mospërputhjet në çështje të tilla si

shkarkimi, emërimi, transferimi, sistemi disiplinor dhe procedurat për rishikimin e vendimeve të marra nga këshillat.<sup>1</sup>

Raporti i progresit po ashtu përcakton se duhet bërë më shumë për të siguruar funksionimin dhe llogaridhënien e gjyqësorit. Për të siguruar zbatimin e plotë të ligjeve për këshillin gjyqësor dhe prokurorial, të dy këshillat ende duhet të miratojnë disa pjesë të legjislacionit zbatues. Kritika e paraqitur në raportin e progresit të Komisionit Evropian, përsëritet poashtu edhe në Konkluzionet e Komisionit sektorial për Drejtësi, Liri dhe Siguri, lidhur me Procesin e Dialogut për Stabilizim Associm mes BE-së dhe Kosovës, të mbajtur me datë 27-29 janar 2015 në Bruksel<sup>2</sup> dhe në takimin e pestë (5) plenar të procesit të dialogut për stabilizim associm mes BE-së dhe Kosovës, të mbajtur në Prishtinë me datë 8 korrik 2015<sup>3</sup> lidhur me mos zbatimin e një sërë obligimesh nga Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Plotësim ndryshimi i ligjeve të lartëpërmendura ka paraparë ndërmarrjen e veprimeve konkrete nga dy këshillat për zbatimin e obligimeve ligjore, lidhur me ndryshimet substanciale sa i përket procesit të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përbërjes së re të Këshillit Prokurorial të Kosovës në pajtim me kushtetutë dhe ligj, kalimin e sekretariatit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, themelimin e komisioneve të reja të përhershme të Këshillit Prokurorial, etj.

Plotësim ndryshimi i këtyre ligjeve dhe harmonizimi i dispozitave ligjore të këtyre ligjeve, ndërlidhej me kërkesat e Bashkimit Evropian në plotësimin e kriterëve për liberalizim të vizave dhe procesin e dialogut për stabilizim associm mes Kosovës dhe BE-se.

Edhe përkundër plotësim ndryshimit të ligjeve mbi gjyqësorin, zbatimi i tyre në praktikë ka filluar ta paraqes efektet e saj të para negative. Neni 15 i LKGJK, plotëson nenin 36 të ligjit bazik, duke përcaktuar se procedura disiplinore ndaj gjyqtarëve nuk do të fillohet dhe zbatohet në Komisionin Disiplinor të KGJK, pasi të kaloj afati një (1) vjeçar nga njoftimi i pranuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor dhe kur kanë kaluar dy vite nga dita e shkeljës së supozuar.

Përderisa, Neni 16 i LKPK plotëson nenin 25 të ligjit bazik, duke përcaktuar se procedura disiplinore ndaj prokurorëve nuk do të fillohet dhe zbatohet në Komisionin Disiplinor të KPK, pasi që të kaloj afati një (1) vjeçar nga njoftimi i pranuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor dhe kur kanë kaluar dy vite nga dita e shkeljës së supozuar.

Afatet e përcaktuara me këto nene në dy ligjet duke kufizuar hetimin ndaj shkeljeve të supozuara nga gjyqtarët dhe prokurorët në vetëm në një vit, nga njoftimi i pranuar në ZPD, do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në kualitetin e punës së Zyrës së Prokurorit Disiplinor, duke marr për bazë numrin e

---

<sup>1</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2014, faqe 13: (Shih linkun [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf).) (qasur për herë të fundit më 10 prill 2016).

<sup>2</sup> Konkluzionet e Komisionit Sektorial për Drejtësi, Liri dhe Siguri, lidhur me Procesin e Dialogut për Stabilizim Associm mes BE-së dhe Kosovës, të mbajtur me datë 27-29 janar 2015 në Bruksel. (Shih linkun [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press\\_corner/2015/20150303\\_final\\_sapd\\_jls\\_folloë-up\\_actions.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/2015/20150303_final_sapd_jls_folloë-up_actions.pdf)) (qasur për herë të fundit më 30 mars 2016).

<sup>3</sup> Konkluzionet e Komisionit Sektorial për Drejtësi, Liri dhe Siguri, lidhur me Procesin e Dialogut për Stabilizim Associm mes BE-së dhe Kosovës, të mbajtur me datë 8 korrik 2015 në Prishtinë. (Shih linkun [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press\\_corner/2015/20150727\\_5th\\_sapd\\_plenary\\_meeting\\_conclusions\\_final.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/2015/20150727_5th_sapd_plenary_meeting_conclusions_final.pdf)) (qasur për herë të fundit më 30 mars 2016).

madh të lëndëve të pranuar dhe të trajtuara nga kjo zyrë. Kjo do të vështirësoj funksionimin e ZPD dhe do të ia pamundësoj ushtrimin e mandatit në bazë të ligjit, në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale.

Përmes këtyre dispozitave po ashtu, në mungesë të burimeve të mjaftueshme njerëzore në ZPD, në raport me numrin e madh të parashtrësive të paraqitura ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, në praktikë do të mund të vie deri tek drejtësia selektive apo perceptimi se ZPD zbaton drejtësi selektive ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve të caktuar.

Kufizimi i përcaktuar prej një viti, duhet të rishikohet dhe ky afat të zgjatet në së paku dy vite, duke paraparë po ashtu ngritjen e resurseve njerëzore në ZPD me pozita shtesë të personelit të kualifikuar, me përvojë dhe ekspertize në trajtimin e këtyre lëndëve.

LKGJK dhe LKPK, nuk parashohin dispozita kalimtare lidhur me lëndet që janë aktualisht në punë në ZPD. Duke pasur parasysh se ZPD aktualisht është duke trajtuar më qindra lëndë të cilat janë pranuar në punë vite me parë, dhe për të cilat nuk është paraqitur raport para komisioneve të KGJK dhe KPK, do të amnistohen. Në bazë të këtyre dispozitave, në të gjitha rastet kur njoftimet janë paraqitur para ZPD, lidhur me shkeljet e supozuara nga gjyqtarë dhe prokurorë, dhe ka kaluar një vit dhe ZPD nuk ka paraqitur raport para komisioneve disiplinore, nuk të trajtohen nga Komisionet disiplinore të dy Keshillave.

Me hyrjen në fuqi të pakos së ligjeve për gjyqësorin në vitin 2011, përfshi Ligjin për KGJK, Ligjin për KPK, Ligjin për Gjykatat<sup>4</sup> dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit në vitin 2013<sup>5</sup>, KGJK dhe KPK kishin ndërmarrur një varg aktivitete dhe veprimesh konkrete për zbatimin e këtyre ligjeve, duke përfshirë edhe kalimin në strukturën e re organizative të gjykatave dhe prokurorive më 1 janar 2013.

Kalimi në strukturën e re organizative të gjykatave dhe prokurorive, si dhe përmbushja e një varg obligimesh që kanë dalë nga ligjet e miratuara në vitin 2010, lidhur me pakon e ligjeve të gjyqësorit u reflektua edhe në Raportet e Progresit për Kosovën, për vitin 2013 dhe 2014. Ndër të tjera në Raportin e Progresit të vitit 2013 theksohej: *“Në muajin janar u prezantua një sistem i ri gjyqësor dhe një Kod i ri Penal si dhe ka hyrë në fuqi Kodi i Procedurës Penale. Gjykata Supreme ka lëshuar një opinion formal për korrigjimin e paqartësive në lidhje me zbatimin retroaktiv të dispozitave kalimtare në lidhje me pranimin e provave para-gjykimin në rastet që kanë filluar para se Kodi i ri Procedural të hyjë në fuqi. Përqendrimi tani duhet të jetë mbi zbatimin e legjislacionit”*.<sup>6</sup>

Përderisa, Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2014, konfirmonte së *“strukturat gjyqësore të Kosovës janë përshtatur mirë me reformën strukturore të vitit 2013”*, të gjeturat në këtë raport po ashtu konfirmonin dështimet dhe fushat në të cilat dy Këshillat duhej të ndërmerrnin veprime në zbatimin e legjislacionit dhe përmbushjen e obligimeve që dalin nga pakoja e ligjeve të gjyqësorit.<sup>7</sup>

---

<sup>4</sup>Ligji për Gjykatat ka hyrë në fuqi më 1 janar 2011 për nenet 29, 35, 36, 38 dhe 40, ndërsa nenet e tjera kanë filluar të zbatohen nga 1 janari 2013 (neni 43 i Ligjit për Gjykatat).

<sup>5</sup>Ligji për Prokurorin e Shtetit, Nenet 21, 28 dhe 29 ka hyrë në fuqi më 1 janar 2011, derisa pjesa tjetër e këtij ligji ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013 (neni 33 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit).

<sup>6</sup> Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2013, faqe 10. (shih linkun: [http://ëëë.mei-ks.net/repository/docs/1FINAL-ALB\\_MIE-Kosovo\\_Progress\\_Report\\_2013\\_\(alb\)\\_2\).pdf](http://ëëë.mei-ks.net/repository/docs/1FINAL-ALB_MIE-Kosovo_Progress_Report_2013_(alb)_2).pdf)) (qasur për herë të fundit më 25 mars 2016).

<sup>7</sup> Shih fusnotën 4.

## a) Pavarësia e gjyqësorit

Përfundimisht pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës në aspektin kushtetues dhe ligjor mund të konsiderohet i pavarur nga dy pushtetet tjera. Kjo pasi në fund të shkurtit 2016<sup>8</sup>, Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka votuar ndryshimet kushtetuese për sa i përket shumicës së anëtarëve të KGJK-së që përzgjidhen nga vetë gjyqësori. Ky rekomandim, ishte adresuar vazhdimisht nga IKD<sup>9</sup> dhe organizata ndërkombëtare, për të siguruar pavarësinë e sistemit gjyqësor. Zbatimi i këtij rekomandimi ishte kërkuar në mënyrë eksplicite nga Raporti i Progresit qysh në vitin 2014, “*që shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të zgjidhen nga kolegët e tyre, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias.*” E njëjta kërkesë e Komisionit Evropian, ishte paraqitur edhe në Raportin e Progresit për vitin 2015. Plotësimi i këtij kriteri nga Kuvendi i Kosovës, kërkonte plotësim ndryshimin e nenit 108, të Kushtetutës së Kosovës, lidhur me zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të KGJK-së. Duhet theksuar se Kuvendi i Kosovës ishte sfiduar nga Ministria e Drejtësisë<sup>10</sup>, përkatësisht Qeveria që të bëjnë ndryshimin e Kushtetutës për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit, por vullneti i ekzekutivit nuk kishte ekzistuar edhe tek legjislativi, i cili nuk kishte votuar ndryshimet kushtetuese për këtë çështje në atë kohë.<sup>11</sup> Njëherësh ky vullnet i institucioneve të Republikës së Kosovës për të ndryshuar mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të KGJK-së është një hap përpara, në kuptim të krijimit edhe *de jure* të një pushteti gjyqësor kushtetutëshmërisht dhe ligjërisht të pavarur. Hyrja në fuqi tashmë i këtij ndryshimi kushtetues ka shtuar dhe forcuar mekanizmat për një sistem gjyqësor të pavarur, sepse Kushtetuta e Republikës së Kosovës përveç kësaj ka ofruar dhe ofron një numër mekanizmesh që sigurojnë pavarësinë e organeve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial<sup>12</sup>.

Në vijim nga sa u tha më sipër, neni 108 i Kushtetutës përcaktonte se tetë (8) anëtarë të KGJK-së i zgjedhin deputetët e Kuvendit të Kosovës, që është në kundërshtim me opinionin nr. 32 të Komisionit të Venecias në Raportin lidhur me Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor, pjesa e I, Pavarësia e Gjykatësve.<sup>13</sup>

<sup>8</sup> *Shënim:* Kuvendi i Republikës së Kosovës më 24 shkurt 2016, në mbështetje të nenit 65 (2) dhe nenit 144 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka miratuar “Amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës” – Amandamenti nr. 25: “Neni 108, paragrafi 6, nënparagrafi 1 dhe 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndryshohen si në vijim:

1. Shtatë (7) anëtarë të do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit.  
2. Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtarë.”

<sup>9</sup>Rekomandimi 8: “*Përzgjedhja e anëtarëve të KGJK-së, ku tetë nga trembëdhjetë anëtarët përzgjidhen me vota të Kuvendit, paraqet problem për përfaqësimin e pavarur të gjyqësorit. Rrjedhimisht për të siguruar pavarësi në çdo aspekt tjetër, pjesa më e madhe e anëtarëve të KGJK-së duhet të përzgjidhen nga vetë gjyqtarët*”. Gashi A. dhe Musliu B. “Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë: *Analizë e pavarësisë financiare dhe individuale*”. (Prishtinë: Instituti i Kosovës për Drejtësi, nëntor 2012).

<sup>10</sup> Kuvendi i Kosovës ka votuar më 14 mars 2013 kundër propozimit të Ministrisë së Drejtësisë që të ndryshohet përbërja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit. Procesverbal i Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 14, 15 dhe 19 mars 2013. (shih linkun [http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_s\\_2013\\_03\\_14\\_10\\_4805\\_al.pdf](http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_s_2013_03_14_10_4805_al.pdf)). (qasar për herë të fundit më 25 mars 2016).

<sup>11</sup> IKD intervistë me z. Hajredin Kuçi, Ministër i Drejtësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Gusht 2015.

<sup>12</sup> *Shënim:* Këtu nënkuptohen të gjitha mekanizmat kushtetues të parapara në kapitullin VII-të të Kushtetutës të Republikës së Kosovës apo mekanizmat ligjorë që kanë garantuar dhe garantojnë pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

<sup>13</sup> *Shënim:* Këtu nënkuptohen të gjitha mekanizmat kushtetues të parapara në kapitullin VII-të të Kushtetutës të Republikës së Kosovës apo mekanizmat ligjorë që kanë garantuar dhe garantojnë pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. [1] Raport mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor. Pjesa I: Pavarësia e Gjyqtarëve. Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias). 32. Për të përmbledhur, pikëpamja e Komisionit të Venecias është se kjo është një metodë e përshtatshme për të garantuar për pavarësinë e gjyqësorit që një këshill i pavarur gjyqësor të ketë ndikim vendimtar në vendimet mbi emërimin dhe karrierën e gjyqtarëve. Duke marrë parasysh pasurinë e kulturës ligjore në Evropë, e cila është e çmuar dhe duhet të mbrohet, nuk ka asnjë model të vetëm i cili vlen për të gjitha vendet. Gjatë vlerësimit të sistemeve juridike të ndryshme, Komisioni i Venecias rekomandon që shtetet të cilat nuk e kanë konsideruar ende themelimin e një Këshilli të pavarur Gjyqësor, apo të një trupi të ngjashëm. Në të gjitha rastet këshilli duhet të ketë një përbërje pluraliste, nëse jo shumica, një pjesë e konsiderueshme e tyre të jenë gjyqtarë. Me përjashtimin e anëtarëve ex-officio, zgjedhja e këtyre gjyqtarëve duhet të bëhet nga kolegët. (Shih linkun

Gjithashtu aspekti i pavarësisë ndërlidhet edhe me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me propozimin e buxhetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, i cili është dërguar në dy adresa, në Qeveri dhe Kuvend. Praktika ka dëshmuar se Qeveria gjithmonë ka bërë shkurtime buxhetore në raport me kërkesat e dy Këshillave, duke ua pamundësuar funksionimin efikas dhe efektiv të tyre. Mënyra e propozimit të buxhetit dhe shkurtime të tij nga Qeveria qartazi reflekton si ndërhyrje e drejtpërdrejtë e pushtetit ekzekutiv në pushtetin gjyqësor dhe prokurorial.<sup>14</sup> Këto ndërhyrje në gjyqësor, pas presioneve të shumta publike, përfundimisht, kanë ndikuar në ndryshimin e qasjes dhe shprehjen e vullnetit të ekzekutivit dhe legjislativit që të reflektohet në ligjet e reja, duke ia mundësuar KGJK-së dhe KPK-së, që propozimin e buxhetit ta bëjnë drejtpërdrejt në Kuvendin e Kosovës, duke synuar rritjen e pavarësisë së këtyre sistemeve. Për më tepër ky ndryshim i qasjes, nënkupton se me ligjet e reja, KGJK dhe KPK, kërkesat e tyre buxhetore i dërgojnë drejtpërdrejtë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili në aspektin formal paraqet një garancion të ri ligjor për të rritur pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Në këtë drejtim vlen të theksohet se IKD konsideron se ka qenë promotori më i fuqishëm për të avokuar për sigurimin e pavarësisë buxhetore për sistemin gjyqësor dhe prokurorial dhe në vazhdimësi ka ofruar ekspertizën e vet përmes analizave<sup>15</sup> kualitative, duke ngritur debatin publik.<sup>16</sup>

Pavarësisht këtyre hapave të rëndësishëm në drejtim të rritjes së pavarësisë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial mbetet të shihet nëse vullneti politik i dëshmuar përmes ndryshimit të ligjeve do të zbatohet në praktikë, dhe nëse do të merren parasysh, propozimet e paraqitura nga Këshillat në Kuvendin e Kosovës apo nëse ato do të aprovohen pa bërë shkurtime buxhetore sikurse është vepruar deri më tani.

#### **b) Dështimi i KGJK dhe KPK në miratimin e legjislacionit sekondar**

IKD në vazhdim të këtij punimi ka bërë elaborimin e dështimeve të KGJK-së dhe KPK-së në miratimin e legjislacionit sekondar të domosdoshëm për të mundësuar zbatimin efikas dhe të efektshëm të pakos së ligjeve të gjyqësorit (Ligji për KGJK, Ligji për KPK, Ligji për Gjykatat dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit).

KGJK prej hyrjes në fuqi të LKGJK ka arritur të miratojë këto Rregullore<sup>17</sup>. Obligimet e dala nga Ligji për KGJK dhe Ligji për Gjykata nuk janë përmbushur në tërësi. Më poshtë janë radhitur lista e

---

[http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2010\)004-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2010)004-e). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).

<sup>14</sup> Gashi A. dhe Musliu B. "Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë: *Analizë e pavarësisë financiare dhe individuale*". (Prishtinë: Instituti i Kosovës për Drejtësi, nëntor 2012).

<sup>15</sup> Gashi A. dhe Musliu B. "Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë: *Analizë e pavarësisë financiare dhe individuale*". (Prishtinë: Instituti i Kosovës për Drejtësi, nëntor 2012).

<sup>16</sup> *Shënim*: IKD në vitin 2012 ka zhvilluar një hulumtim kualitativ, në të cilin janë analizuar shumë aspekte të rëndësishme të pavarësisë së gjyqësorit, me fokus në pavarësinë financiare institucionale dhe individuale të gjyqësorit. Në këtë punim janë nxjerrë rekomandime konkrete për rregullimin e çështjes së pavarësisë së gjyqësorit, përfshirë çështjen kyçe të pavarësisë së buxhetit. IKD ka mbajtur tryeza publike dhe ka avokuar fuqishëm për pavarësimin e gjyqësorit, duke kërkuar prej ekzekutivit dhe legjislativit ndryshimin e pakos së ligjeve, për të mundësuar KGJK-së dhe KPK-së, që buxhetin ta kalojnë direkt në Kuvendin e Kosovës, pa ndërhyrjen e Qeverisë.

<sup>17</sup> Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Supreme; Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën e Apelit; Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatat Themelore në Prishtinë, Pejë; Gjakovë, Prizren; Ferizaj; Mitrovicë; dhe Gjilan; Rregullorja për Mbajtjen e Evidencave për Persona të Dënuar; Rregullorja për Zgjedhjen e Anëtarëve të KGJK-së nga Gjyqësori; Rregullorja për Organizimin e Gjykatave; Rregullore për Procedurën Disiplinore për Anëtarë të KGJK-së; Rregullore për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtarëve; Rregullorja për Punën e Komisionit Disiplinor; Rregullore për Procedurën për Emërim dhe Ri-emërim për Gjyqtarë; Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Panelit me Lirim me Kusht; Rregullore për Organizimin dhe Veprimtarinë e KGJK-së; Rregullore për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve; Rregullore për Çaktimin e Normës së Punës së Gjyqtarëve; Kodet e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Anëtarë të KGJK-së, Gjyqtarë dhe Staf Mbështetës; Rregullore për Plotësimin Ndryshimin e Rregullores për Zgjedhjen e Anëtarëve të KGJK-së, Rregullore për Emërimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësor, Rregullore për

rregulloreve, të cilat nuk janë miratuar deri në fund të vitit 2015, në bazë të obligimeve të dy ligjeve të lartpërmendura:

- Rregulloren për Klasifikimin dhe Kualifikimin e Dokumenteve në Sistemin Gjyqësor të Kosovës.
- Rregulloren për Komunikim me Publikun dhe Mediat.
- Rregulloren për Publikimin e Aktgjykimeve.
- Rregulloren për Gjykatën Supreme rreth menaxhimit, caktimit të gjykatësve dhe caktimit të kolegjeve dhe kryesuesve të kolegjeve.
- Rregulloren për Gjykatën e Apelit rreth caktimit të gjykatësve në departamente për të siguruar efikasitet në trajtimin e lëndëve, caktimin e udhëheqësve të departamenteve sipas nevojës dhe që siguron se secila lëndë i caktohet kolegjeve.
- Rregulloren për Gjykatësit Porotë.
- Rregulloren për Bashkëpunëtorët Profesional.
- Rregulloren për përfshirjen e Gjykatësve në Arsimimin e Vazhdueshëm Ligjor.
- Rregulloren për Transferimin e Gjykatësve.
- Rregulloren për Rregullat dhe Procedurat që Qeverisin Ankesat ndaj vendimeve të KGJK-së rreth zhvendosjes së përhershme apo transferimit kundër vullnetit të Gjykatësve që tejkalojnë periudhën gjashtë (6) mujore.
- KGJK dhe KPK duhet të ndryshojnë dhe plotësojnë Rregulloren e KGJK-së për Funkcionimin e Zyrës së ZPD-së ku përcaktohet çështja e mandatit të Drejtorit të ZPD-së.

Sikurse KGJK edhe KPK që nga themelimi tij dhe prej hyrjes në fuqi të LKPK dhe LPSH ka arritur të miratojë vetëm një numër të Rregulloreve<sup>18</sup>. Sikundër obligimet e dala nga Ligji për KPK dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit nuk janë përmbushur deri në fund të vitit 2015, pra janë një numër i rregulloreve dhe dokumenteve që nuk janë miratuar përfshi, ato si në vijim: :

---

Emërimin e Ekspertëve Gjyqësor, Rregullore për Përcaktimin e Rregullave dhe Procedurave për Organizimin e Provimit për Kandidatë për Gjyqtar.

<sup>18</sup> KPK ka miratuar këto rregullore që nga themelimi i tij në vitin 2011: Rregullore për Strukturën Organizative dhe Funkcionin Mbështetës të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit; Rregullore mbi Caktimin e Procedurave dhe Kriterëve për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve dhe Prokurorive; Rregullore për Përzgjedhjen e Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive; Rregullorja për Strukturën Organizative dhe Funksionale të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive; Rregullore për Procesin e Emërimit të Prokurorëve; Rregullore për Punën e Komisionit Disiplinor; Rregullore për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizim të Vendeve të Punës në Këshillin Prokurorial dhe Prokurorin e Shtetit; Rregullore për Caktimin dhe Transferimin e Prokurorëve (Zbatimi i ligjit për Prokurorin e Shtetit lidhur me caktimin dhe transferimin e prokurorëve sipas strukturës së re organizative); Rregullore për Caktimin dhe Transferimin e Stafit Mbështetës; Rregullore për Mbatjen e Mbledhjes së Përbashkët të KGJK-së dhe KPK-së; Rregullore për Mandatin, Strukturën dhe Funkcionimin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave të Krimit; Rregullore për Procesin e Rekrutimit, Emërimit dhe Ri-emërimit të Prokurorëve; Rregullore për Funkcionimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial; Rregullore për Kriteret dhe Procedurën e Nominimit dhe Propozimit për Emërim të Kryeprokurorit të Shtetit; Rregullore për Themelimin dhe Funksionalizimin e Koordinatorit Kombëtar në Luftimin e Krimeve Ekonomike; Rregullore për Caktimin e Rregullave dhe Procedurave për Organizimin e Provimit për Prokurorë nga Komuniteti jo shumicë në Kosovë; Kodet e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Anëtarë të KPK-së, për Prokurorë dhe Staf Mbështetës.

- Rregulloren për Klasifikimin dhe Kualifikimin e Dokumenteve në Sistemin Prokurorial të Kosovës.
- Rregulloren për Komunikim me Media dhe Publikun;
- Rregulloren për Transferimin e Prokurorëve.
- Rregulloren për Avancimin e Prokurorëve.
- Rregulloren për Procedura Disiplinore efektive (për prokurorë, anëtarët e KPK-së);
- Rregulloren për Përgjegjësinë Disiplinore të Anëtarëve të KPK-së;
- Rregulloren për Standardizim lidhur me Ligjërimin e Prokurorëve;
- Procedurat Standarde të Veprimit lidhur me Evitimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funkcionit nga Anëtarët e KPK-së;
- Rregulloren për Rregullat dhe Procedurat që Qeverisin Ankesat ndaj vendimeve të KPK-së rreth zhvendosjes së përhershme apo transferimit kundër vullnetit të Prokurorëve që tejkalojnë periudhën gjashtë (6) mujore.

Mungesa e miratimit të legjislacionit sekondar nga KGJK<sup>19</sup> dhe KPK<sup>20</sup> ka krijuar probleme të mëdha në praktikë në përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësi të sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial, duke paraqitur pengesë në funksionimin adekuat në praktikë. Bartësit dhe përfaqësuesit e këtyre dy institucioneve theksojnë se mungesa e legjislacionit sekondar ka krijuar vështirësi në praktikë dhe këto vështirësi kanë qenë konkrete si dhe kanë krijuar mundësi reale për krijimin e praktikave jo të mira, madje në disa raste edhe me standarde të dyfishta.

IKD vlerëson ndër të tjera se mungesa e legjislacionit sekondar ka krijuar probleme serioze në zbatimin e drejtë të obligimeve ligjore në praktikë. Shpesh herë KGJK dhe KPK në mungesë të këtyre akteve nënligjore, kanë penguar në mënyrë të drejtëpërdrejtë gjykatësit, prokurorët dhe personelin mbështetës në përmbushjen e obligimeve, funksioneve dhe përgjegjësi të tyre në bazë të obligimeve që dalin nga ligji. Kjo qasje ndër të tjera siç është theksuar edhe më lartë ka mundësuar krijimin e praktikave jo adekuate dhe me standarde të dyfishta.

### **c) Llogaridhënia e sistemit gjyqësor dhe prokurorial**

Në lidhje me funksionimin dhe llogaridhënien e gjyqësorit si një dimension i rëndësishëm që lidhet edhe me parimin e pavarësisë së tij, Raporti i Progresit vazhdimisht, ka kërkuar nga sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial të bëjnë më shumë për të siguruar funksionimin dhe llogaridhënien e tyre . Ndër të tjera në këtë raport theksohet: *“Për të siguruar zbatimin e plotë të ligjeve për Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial, të dy këshillat ende duhet të miratojnë disa pjesë të legjislacionit zbatues”.*<sup>21</sup> Mekanizmat aktual të llogaridhënies në sistemin gjyqësor dhe prokurorial deri më tash nuk janë

<sup>19</sup> IKD intervistë me z. Enver Peci, Kryesues i KGJK-së; dhe z. Agim Maliqi anëtar i KGJK-së, njeherësh Kryetar i Komisionit për Akte Normative në KGJK. Tetor, dhjetor 2015.

<sup>20</sup> IKD intervista me z. Teki Bokshi, anëtar joprokuror i KPK-së dhe njëherësh Kryetar i Komisionit për Akte Normative në KPK; z. Florent Muçaj anëtar joprokuror i KPK-së nga radhët e shoqërisë civile; z. Jetish Maloku anëtar i KPK-së dhe z. Besim Kelmendi prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, përfaqësues i autorizuar i Kryeprokurorit për tu intervistuar për këtë hulumtim të IKD-së. Tetor, Dhjetor 2015.

<sup>21</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2014. Faqe 13. (Shih linkun <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/2be0beff-485a-44f5-93c0-bceca4f5d6b3/Raporti-i-Progresit-2014-per-Kosoven.aspx>). (Qasur për herë të fundit më 12 mars 2016).



dëshmuar si efikas dhe efektiv. Në kuptim të efikasitetit dhe efektivitetit të këtyre mekanizmave, IKD ka vërejtur një shkëputje në mes të KGJK-së dhe Gjykatave, duke mos zbatuar obligimet e ndërsjella, rrjedhimisht duke mos u mbajtur fare llogaridhënës dhe përgjegjës. Lidhur me aspektin e llogaridhënies vlen të theksohet që ndër të tjera KGJK nuk ka krijuar mekanizma për të obliguar Kryetarët e Gjykatave Themelore në lidhje me përgjegjësitë që kanë në zbatimin e obligimeve ligjore, strategjive, planeve dhe dokumenteve tjera të miratuara nga KGJK. Në këtë drejtim, një prej obligimeve të Kryetarëve të Gjykatave Themelore është raportimi i rregullt me shkrim çdo tre muaj në KGJK. Ky obligim nuk është përmbushur nga këta drejtues të Gjykatave.<sup>22</sup> Kjo qasje ndaj llogaridhënies ka krijuar probleme praktike, të cilat kanë ndikuar në moszbatimin e dispozitave ligjore. Rrjedhimisht deri më tash asnjëherë KGJK nuk ka mbajtur përgjegjës askënd dhe nuk ka marrë masa ndëshkuese ndaj ndonjë Kryetari të Gjykatës për performancë të dobët, mungesë të rezultateve dhe mos zbatim të politikave dhe akteve të Këshillit.<sup>23</sup> Kjo vërteton shkëputjen praktike të krijuar në mes të KGJK-së dhe Gjykatave, në kuadër të obligimeve të ndërsjellta, siç është konstatuar më lartë. Po ashtu në anën tjetër as KGJK asnjëherë nuk ka zbatuar detyrimet ligjore që të mbajë përgjegjës Kryetarët e Gjykatave për mos raportim në KGJK. Këto veprime reciproke kanë dobësuar tej mase sitemin e kontrollit dhe mbikëqyrjes andaj IKD vlerëson se në këto raste mungon sistemi i llogaridhënies dhe vullneti reciprok në mes të KGJK-së dhe Kryetarëve të Gjykatave për të respektuar dhe zbatuar dispozitat ligjore në fuqi. Për më tepër vetëm më 2 dhjetor 2015, të gjithë Kryetarët e Gjykatave Themelore kanë raportuar para KGJK-së, për tërë vitin 2014 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2015, meqë kjo qasje e llogaridhënies duket të jetë krejt formale vetëm sa për të realizuar një obligim të caktuar ligjor dhe nënligjor.

Njëjtë qëndron situata me llogaridhënien në sistemin prokurorial. IKD ka vërejtur se edhe këtu, ekziston një shkëputje në mes të KPK-së dhe Prokurorive. Praktika e njëjtë e mos raportimit të Kryeprokurorëve të të gjitha niveleve në KPK është shumë e evidente. Kësisoj përkundër obligimeve të përcaktuara në aktet e brendshme të KPK-së, ato nuk janë respektuar rregullisht përse i përket këtyre mekanizmit të llogaridhënies. Kjo vërehet edhe me faktin se mospërmbushja e obligimeve asnjëherë nuk është përcjellë me inicim të masave disiplinore ndaj Kryeprokurorëve nga KPK, dhe deri më tash nuk ka asnjë rast kur ndonjë Kryeprokuror është degraduar për performancë të dobët, mungesë të rezultateve dhe mos zbatim të akteve të Këshillit.<sup>24</sup> Në anën tjetër as KPK ka dështuar në zbatimin e detyrimeve ligjore që të mbajë përgjegjës Kryeprokurorët për mos respektim të obligimeve ndaj KPK-së.

Për dallim prej KGJK-së, e cila ka miratuar Rregulloren për Përgjegjësinë Disiplinore të Anëtarëve të KGJK-së,<sup>25</sup> KPK asnjëherë nuk e ka miratuar një rregullore të tillë lidhur përgjegjësinë disiplinore për

---

<sup>22</sup> Neni 24 paragrafi 3 i LKGJK parashihet se: "Kryetari i një Gjykate Themelore ka autoritet të përgjithshme administrative dhe do të sigurojë administrimin efikas dhe efektiv të drejtësisë nga të gjitha Degët, Departamentet dhe Divizionet e Gjykatës. Kryetari i Gjykatës, në bashkëpunim me gjyqtarët e Gjykatës, zhvillon planin vjetor për menaxhimin e lëndëve dhe cakton lëndët tek Departamentet dhe gjyqtarët në atë mënyrë që të sigurojë zgjidhjen efikase të lëndëve. Kryetari i Gjykatës Themelore në baza vjetore i dërgon Këshillit një raport mbi suksesin e zbatimit të planin të mëparshëm vjetor për menaxhimin e lëndëve. Kryetari i Gjykatës Themelore i dërgon Këshillit raport tremujor me shkrim që adreson punën e gjykatës, identifikon çfarëdo probleme me të cilat ballafaqohet gjykata, si dhe propozon hapa riparues për të adresuar probleme të tilla. Kryetari i Gjykatës, brenda rregullave dhe urdhërësive të Këshillit, do të ndërmarrë hapa të tjerë të atillë sipas nevojës për të siguruar menaxhim efektiv të gjykatës dhe burimeve të saja si dhe gjykimin e lëndëve brenda kohës". Ligji për Këshillin Gjyqësor i Kosovës.

<sup>23</sup> IKD intervista me z. Enver Peci, Kryesues i KGJK-së dhe z. Albert Avdiu, Drejtor i Sekretariatit të KGJK-së. Gusht 2015.

<sup>24</sup> IKD intervista me z. Besim Kelmendi, prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, përfaqësues i autorizuar për intervistë rreth këtij hulumtimi të IKD-së nga Kryeprokurori i Shtetit, z. Aleksandër Lumezi dhe z. Shkëlzen Maliqi, Drejtor i Sekretariatit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Shtator 2015.

<sup>25</sup> Rregullorja për Procedurën Disiplinore për Anëtarët e KGJK-së (shih linkun [http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/Rregullore\\_per\\_proceduren\\_disiplinore\\_per\\_anetaret\\_KGJK\\_se\\_262530.pdf](http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/Rregullore_per_proceduren_disiplinore_per_anetaret_KGJK_se_262530.pdf);) (Qasur për herë të fundit më 30 tetor 2016).



anëtarë të KPK-së. Ky institucion që nga themelimi në vitin 2011, si institucion i pavarur në menaxhimin dhe administrimin e sistemit prokurorial në Kosovë, edhe pse ka qenë i obliguar me ligj, ende nuk ka miratuar Rregullore që përcakton dhe publikon rregullat dhe procedurat disiplinore të zbatueshme ndaj anëtarëve të KPK-së, duke përfshirë ato procedura që përcaktojnë hetimin, pezullimin apo rekomandimin për shkarkim të cilitdo anëtar të Këshillit.<sup>26</sup> Mungesa e rregullores dhe rregullave lidhur me zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj anëtarëve të KPK-së, iu ka siguruar amnisti të plotë dhe imunitet anëtarëve të Këshillit lidhur me çdo veprim apo aktivitet të tyre, edhe jashtë imunitetit funksional të garantuar me nenin 11 të LKPK. Në praktikë mungesa e kësaj rregulloreje ka imunizuar<sup>27</sup> anëtarë të caktuar të KPK-së gjatë vitit 2014 dhe 2015, për të cilët ka pasur akuza publike për shkelje dhe cenim të imazhit të sistemit prokurorial, pasi ndaj tyre është pamundësuar ndjekja disiplinore në mungesë të rregullave dhe procedurave.<sup>28</sup>

Mungesa e llogaridhënies së gjykatësve dhe prokurorëve është paraqitur në Strategjinë për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë 2016-2019, në të cilën theksohet se nevojiten përmirësime në këtë drejtim. Përveç në këtë Strategji, kritikën për mos disiplinim efektiv të gjykatësve dhe prokurorëve janë paraqitur në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2014, ku mes tjerash thuhet: *“Kjo në mes tjerash edhe për arsye se përkundër shqiptimit të masave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë vitit 2012 dhe 2013, këto masa nuk kanë rezultuar me largimin e ndonjërit nga puna. Në këtë aspekt kërkohet që rregulloret e masave disiplinore të KPK-së dhe KGJK-së ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të përmirësohen në mënyrë që masat disiplinore dhe politikave ndaj luftës kundër korrupsionit në gjyqësor të japin rezultate konkrete.”*<sup>29</sup>

Në këtë dokument strategjik për asistencë në sektroin e sundimit të ligjit në Kosovë 2016-2019, theksohet poashtu se *“në këtë aspekt duhet të parashihet krijimi dhe ngritja e kapaciteteve të Njësiteve për Analiza dhe Politika në KGJK dhe KPK, profesionalizimi i Komisioneve Disiplinore si dhe forcimi i Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZPD) do duhej të kishin efekte pozitive. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për faktin se me përfundimin e mandatit të tanishëm të Misionit të EULEX-it, më nuk ekziston mundësia ligjore dhe praktike që në rastet në fjalë përgjegjësia të kalojë te gjyqtarët përkatësisht prokurorët e EULEX-it.”*<sup>30</sup>

Për më tepër, IKD ka qenë pjesë e zhvillimit të Planit Strategjik të KGJK-së, në të cilin janë vendosur korniza të avancuara për zhvillimin e sistemit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe aspektin e llogaridhënies në kuadër të sistemit Gjyqësor. Ndër të tjera, theksohet mungesa e resurseve njerëzore dhe profesionale në planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike. KGJK nuk ka ndonjë strukturë që është përgjegjëse për koordinim, planifikim dhe hulumtim të politikave. Në Planin Strategjik të KGJK-së është rekomanduar themelimi i Zyrës për Planifikim Strategjik në KGJK ose të paktën të caktojë zyrtarë për zbatimin e këtyre aktivitetëve.<sup>31</sup>

<sup>26</sup> Neni 11 i Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës: Këshilli përcakton dhe publikon rregullat dhe procedurat disiplinore të zbatueshme ndaj anëtarëve të vet duke përfshirë ato procedura që përcaktojnë hetimin, pezullimin apo rekomandimin për shkarkim të cilitdo anëtar të Këshillit.

<sup>27</sup> IKD intervistë me z. Teki Bokshi, anëtar i KPK-së. Dhjetor 2015.

<sup>28</sup> IKD intervistë me z. Jetish Maloku, anëtar i KPK-së. Mars 2016.

<sup>29</sup> Strategjia për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë 2016-2019. Faqe 15.

( Shih linkun [http://www.md-](http://www.md-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Asistence_ne_Sektorin_e_Sundimit_te_Ligjit_ne_Kosove_2016...pdf)

[ks.net/repository/docs/Strategjia\\_per\\_Asistence\\_ne\\_Sektorin\\_e\\_Sundimit\\_te\\_Ligjit\\_ne\\_Kosove\\_2016...pdf](http://www.md-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Asistence_ne_Sektorin_e_Sundimit_te_Ligjit_ne_Kosove_2016...pdf)) (qasur për herë të fundit më 1 shkurt 2016).

<sup>30</sup> Shih fusnotën 30.

<sup>31</sup> Plani Strategjik i Gjyqësorit të Kosovës 2014 – 2019. Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Prill 2014.

#### **d) Amnistia e shkeljeve të supozuara nga gjykatësit dhe prokurorët përmes ligjeve**

Ndryshimet dhe plotësimet e reja në pakon e ligjeve të gjyqësorit gjithashtu kanë prodhuar pasoja negative dhe të pariparueshme për sistemin e llogaridhënies. IKD ka reaguar ndaj amnistisë ligjore të gjykatësve dhe prokurorëve, që janë subjekt i procedurave hetimore dhe disiplinore të paraqitura në ZPD. Kjo amnisti është mundësuar përmes plotësim ndryshimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (LKGJK) dhe Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës (LKPK), respektivisht neneve 15 dhe 16 të tyre.

Në të dy ligjet e lartpërmendura, ndryshimet kanë përcaktuar se: “procedura disiplinore ndaj gjykatësve dhe prokurorëve nuk do të fillohet dhe zbatohet në Komisionin Disiplinor të KGJK dhe KPK, pasi që të kaloj afati një (1) vjeçar nga njoftimi i pranuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, për shkeljen e supozuar dhe dy (2) vite nga dita shkeljes së supozuar”.

IKD vlerëson se plotësimet e këtyre dispozitave ligjore, prodhojnë pasoja negative të pariparueshme dhe si të tilla qartazi mundësojnë një amnisti të përgjithshme për gjykatësit dhe prokurorët, të cilët supozohet se kanë kryer sjellje të pahijshme apo kanë vepruar në kundërshtim me kodet e etikës dhe sjelljes profesionale për gjykatës dhe prokurorë. Për të rritur edhe më shumë paqartësinë e dispozitave të neneve 15 dhe 16 të ligjeve respektive në LKGJK dhe LKPK, nuk janë paraparë dispozita kalimtare lidhur me lëndët që janë aktualisht në punë në ZPD.

Duke pasur parasysh se ZPD aktualisht është duke trajtuar me qindra lëndë, të cilat janë pranuar në punë vite me parë, dhe për të cilat nuk ka paraqitur raport para Komisioneve të KGJK dhe KPK, të njëjtat nuk do të mund të trajtohen nga këto dy komisione në rastet kur ka kaluar afati prej një viti kur është pranuar njoftimi në ZPD apo kur kanë kaluar dy vite nga dita e shkeljes së supozuar.

Në kuptim të këtyre dispozitave të gjitha këto raste do të mbesin të pa trajtuara dhe me këtë edhe nuk do të ketë pasoja ndaj gjykatësve apo prokurorëve ndaj të cilëve është parashtruar inicimi i procedurave disiplinore. Pra kjo arsyeton qartazi tezën e ngritur më lartë se kjo është një amnisti e heshtur e gjykatësve dhe prokurorëve të cilët supozohet se kanë bërë shkelje të Kodit të Etikës dhe që lëndët disiplinore ndaj tyre janë zvarritur me vite në ZPD.

IKD vlerëson se përmes ndryshimit të këtyre ligjeve, janë shkaktuar dëme të pariparueshme që do të ndikojnë drejtpërdrejtë në dëmtimin e mëtutjeshëm të integritetit të bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale dhe vetë integritetin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Kultura e pandëshkueshmërisë ndaj gjykatësve dhe prokurorëve për sjelljet e tyre potencialisht të pahijshme tashmë është garantuar përfundimisht në dispozitat konkrete të këtyre dy ligjeve bazike për sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Besimi i ulët në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, pavarësisht faktit se këto muaj ka shënuar rënien më të madhe, përmes kësaj amnistie të shkelësve nga radhët e gjykatësve dhe prokurorëve, do të mund të ndikojë përfundimisht në një rënie edhe më të madhe të besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi.

Këto dispozita të ligjeve të lartpërmendura që mundësojnë që një numër i konsiderueshëm i gjykatësve dhe prokurorëve të amnistohen nga shkeljet e supozuara të tyre transmetojnë qartazi edhe vullnetin e brishtë të KGJK-së dhe KPK për ndërtimin e një sistemi efikas të llogaridhënies.

Se ka mungesë të ndëshkimit të shkelësve të ligjit brenda gjyqësorit në Kosovë, është potencuar edhe në Raportin e Progresit për vitin 2015, i cili ndër të tjera thekson: “*Sidoqoftë, gjyqësia mbetet e nënshtruar nga ndikimet politike. Përpjekje të mëtutjeshme kërkohen për të siguruar pavarësinë*

*përmes ligjeve dhe në praktikë, për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin brenda gjyqësisë, të rekrutohet dhe trajnohet personel i kualifikuar dhe të alokohen resurse adekuate.*<sup>32</sup>

Po ashtu, me plotësimin e këtyre ligjeve, shqetësuese mbeten afatet e shkurta të përcaktuara me këto ndryshime duke kufizuar hetimin ndaj shkeljeve të supozuara nga gjykatësit dhe prokurorët në vetëm një vit, nga njoftimi i pranuar në ZPD. Ky kufizim do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në kualitetin e punës së Zyrës së Prokurorit Disiplinor, duke marr për bazë numrin e madh të lëndëve të pranuar dhe të trajtuara nga kjo zyrë.<sup>33</sup> Kjo gjithashtu do të vështirësoj funksionimin e ZPD-së dhe do t'ia pamundësoj ushtrimin e mandatit në bazë të ligjit për të funksionuar në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale.

Në raport me ZPD-në, ky afat i shkurtër i parashkrimit të hetimit nënkupton mes tjerash edhe nevojën për vetëdijësimin e tyre që lëndët disiplinore të hetohen dhe të përcillen në Komisionet Disiplinore në një afat më të shpejtë. Megjithatë për të arritur këtë shtrohet edhe nevoja e shtimit të kapaciteteve të ZPD-së, në të kundërtën vërtetohet ajo që është thënë më lartë, pra vështirësitë që mund të hasë ZPD në punën e saj.

Në vijim të kësaj IKD shpreh shqetësim se si rezultat i këtyre dispozitave, në mungesë të resurseve të mjaftueshme njerëzore në ZPD, në raport me numrin e madh të parashtrësive të paraqitura ndaj gjykatësve dhe prokurorëve, në praktikë do të mund të vijë deri tek drejtësia selektive apo perceptimi se ZPD zbaton drejtësi selektive ndaj gjykatësve apo prokurorëve të caktuar. Kjo për shkak se resurset e mangëta dhe kufizimi i afatit kohor për trajtimin e rasteve do të pamundësojë që të njëjtit të trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit, e drejtë kjo fundamentale e garantuar me Kushtetutë.

IKD gjatë vitit 2015, gjatë monitorimit të punës së ZPD po ashtu ka vërejtur zbatim të drejtësisë selektive gjatë trajtimit të rasteve disiplinore ndaj gjykatësve dhe prokurorëve, dhe për këtë ka pasur ankesa publike nga akterët që kanë qenë pjesë e këtyre procedurave disiplinore.<sup>34</sup> Ankesat që janë paraqitur në raport me punën e ZPD, janë ndërlidhur me dyshimet se kjo zyrë në raste të caktuara rastet ndaj gjykatësve apo prokurorëve i kryen brenda një afati shumë të shkurtër kohor më shpejtësi të dritës<sup>35</sup>, përderisa ka numër jashtëzakonisht të madh të rasteve të cilat janë raportuar në këtë zyre me vite të tëra dhe të njëjtat nuk janë trajtuar apo proceduar për në Komisionet Disiplinore të KGJK-së apo KPK-së. *“Kjo zyre bën drejtësi selektive, pasi që ka lëndë të tëra ku hetohen gjyqtarët dhe prokurorët për shkelje të rënda të Kodit të Etikës dhe të detyrave të punës dhe presin me vite e nuk i zgjedh”.*<sup>36</sup>

Me këtë rast IKD i rekomandon Ministrisë së Drejtësisë që urgjentisht të filloj me plotësim ndryshimin të këtyre dy ligjeve bazike për funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial për të përmirësuar administrimin e drejtësisë në rastet disiplinore kur subjekt mund të jenë gjykatësit apo prokurorët. Përmes ndryshimeve duhet të adresohet çështja e afateve kohore të trajtimit të rasteve nga ZPD, Komisionet Disiplinore dhe Këshillat, të cilat duhet të përshtaten me kontekstin dhe specifikat e

<sup>32</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015. Faqe 5. (Shih linkun [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 10 mars 2016).

<sup>33</sup> IKD intervistë me z. Zef Prendrecaj, Drejtor i ZPD-së. Dhjetor 2015.

<sup>34</sup> IKD, intervistë me znj. Shpresa Bakija, Kryeprokurore e Prokurorisë Themelore në Gjakovë. Nëntor 2015. (Shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/drejtësia-selektive/>). (Qasur për herë të fundit më 12 mars 2016).

<sup>35</sup> IKD, intervistë me z. Shyqyri Sylja, Kryeprokurore e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë. Mars 2016. (Shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/lufta-kunder-korrupsionit/>). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).

<sup>36</sup> Kryeprokurore i Mitrovicës akuzon ZPD-në, mbrojtja Prokuroren Badivuku. (Shih linkun <http://www.arbresh.info/lajmet/kryeprokurore-i-mitrovices-akuzon-zpd-ne-mbrojti-prokuroren-badivuku/>). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).

sistemit të drejtësisë në Kosovë. Kufizimi i përcaktuar prej një viti, duhet të rishikohet dhe ky afat të zgjatet në së paku dy vite, duke paraparë po ashtu edhe ngritjen e resurseve njerëzore në ZPD me pozita shtesë të personelit të kualifikuar, me përvojë dhe ekspertizë në trajtimin e këtyre lëndëve.

Duke pasur për bazë resurset aktuale të ZPD-së dhe numrin enorm të shkeljeve të supozuara nga ana e gjykatësve dhe prokurorëve, IKD rekomandon që “procedura disiplinore ndaj gjykatësve dhe prokurorëve nuk do të fillohet dhe zbatohet në Komisionin Disiplinor të KGJK dhe KPK, pasi që të kaloj afati dy (2) vjeçar nga njoftimi i pranuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, për shkeljen e supozuar dhe gjashtë (6) vite nga dita shkeljes së supozuar”. Ndërsa sa i përket afatit kohor për trajtimin e rasteve të dorëzuara nga ZPD, IKD rekomandon që Komisioni Disiplinor të përfundojë rastin si shkallë të parë brenda afatit prej gjashtë (6) muaj. Së këndejmi, në rastet e ankesave, KGJK dhe KPK rekomandohet që trajtimin e këtyre rasteve ta përfundoj brenda afatit kohor prej tre (3) muajve.

IKD konsideron se është e nevojshme që ZPD të përgatisë një raport të detajuar me të gjitha informatat që përfshijnë numrin e rasteve të cilat do të amnistohen ndaj gjykatësve dhe prokurorëve, si rezultat i këtyre dispozitave të reja ligjore të lartpërmendura, në mënyrë që qytetarët e Republikës së Kosovës të informohen me vullnetin e shprehur të ligjvënësve, për të amnistuar shkelësit e sistemit të drejtësisë.

Sikurse ZPD duhet që të krijoj një mekanizëm përcjellës, ku do të regjistroheshin të gjitha rastet e pranuar në punë, duke përfshirë datën e pranimit të raporteve dhe trajtimit të tyre sipas radhës, përveç rasteve kur administrimi i drejtësisë në raste të caktuara kërkon të ndërmerren veprime urgjente. Kjo do të ndikonte që kjo zyrë të kryej obligimet e saj në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale, dhe do të evitonte rastet kur kjo zyrë pranon dhe procedon raste disiplinore në komisionet disiplinore të KGJK-së dhe KPK-së brenda një kohe shumë të shkurtër që nuk kalon në raste të caktuara muaj, kurse rastet e vjetra të cilat qëndrojnë në sirtar me vite të tëra edhe parashkruhen.

#### **e) Transparenca e KGJK dhe KPK në raport me publikun dhe mediat**

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm që ndërlidhet me ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor dhe prokurorial asnjëherë nuk është adresuar nga të dy Këshillat. Me këtë rast KGJK ka arritur të rekrutojë zëdhënës në të gjitha nivelet e gjykatave me qëllim të lehtësimit dhe ngritjes së bashkëpunimit me media dhe me publikun, si dhe në maj të vitit 2014 ka miratuar Strategjinë e Komunikimit 2014-2019. Ndër të tjera në këtë dokument theksohet se: *“Qëllimi i kësaj strategjie është krijimi dhe zbatimi i udhëzimeve për publikimin e informatave të të gjitha gjykatave dhe KGJK-së që janë me rëndësi për publikun. Kjo Strategji mundëson që KGJK dhe gjykatat të veprojnë me Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në transparencë të plotë dhe në pajtim me standardet demokratike për të drejtat e njeriut dhe sigurisë publike të njohura ndërkombëtarisht.”*<sup>37</sup>

Sidoqoftë, zbatimi në praktikë i ligjit është vështirësuar në mungesë të rregulloreve përkatëse. Në këtë drejtim, KGJK ende nuk ka miratuar *Rregullore lidhur me Kualifikimin dhe Klasifikimin e Dokumenteve në KGJK dhe Gjykata*, si dhe *Rregulloren për Komunikim me Median dhe Publikun*. Edhe përkundër faktit se ky ishte obligim që duhej plotësuar sipas nenit 4 paragrafi 1.23 të ligjit bazik për KGJK, respektivisht hartimin dhe shpalljen e akteve nën-ligjore në përputhje me ligjet për

<sup>37</sup> Programi për Sundim Efektiv të Ligjit dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Strategjia e Komunikimit 2014-2019. Maj 2014.

informimin publik që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe zbulimin e informacionit që ruhet nga gjyqësori i Kosovës.

Situatë e njëjtë sikur në KGJK qëndron edhe në KPK, e cila përkundër obligimit të paraparë me nenin 4 paragrafi 1 pika 25, e LKPK, ende nuk ka miratuar *Rregulloren lidhur me Kualifikimin dhe Klasifikimin e Informacioneve dhe Dokumenteve në Sistemin Prokurorial*, respektivisht në KPK dhe nëpër prokuroritë përkatëse. Përveç kësaj njëjtë nuk është miratuar as *Rregullorja për Komunikim me Publikun dhe Mediat*. Ndërkaq në përputhje me këtë , KPK ka caktuar dy persona kontaktues lidhur me kërkesat për Qasje në Dokumente Publike dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Duhet theksuar se mungesa e rregullave dhe rregulloreve lidhur me klasifikimin dhe kualifikimin e dokumenteve në sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial paraqet pengesë në praktikë lidhur me sigurimin e informacionit nga publiku, mediat dhe shoqëria civile, i cili informacion është i garantuar me legjislationin e aplikueshëm lidhur me Ligjin për Qasjen në Dokumente Publike, duke respektuar dhe mbrojtur të dhënat personale siç parashihet me ligj.

Mungesa e këtyre dokumenteve ka ndikim të drejtpërdrejtë në mungesën e bashkëpunimit në mes të sistemit gjyqësor dhe prokurorial me media, individë dhe organizata përgjegjëse për monitorim të pavarur të sistemit të drejtësisë, dhe me këtë edhe në mungesën e transparencës dhe llogaridhënies.<sup>38</sup>

Një shqetësim që vazhdon të sfidojë seriozisht funksionimin efikas dhe efektiv të Prokurorit të Shtetit është mungesa e deritashme e rregullore bazike për funksionimin e këtij sistemi. Përkundër obligimit ligjor, KPK vetëm në fund të vitit 2015, ka miratuar Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Prokurorive, dhe e cila ka hyrë në fuqi me 15 janar 2016. Prokurori i Shtetit, organizimin e brendshëm të punës deri me këtë datë e ka bazuar në një Udhëzim Administrativ të Prokurorit të Shtetit të vitit 2010.<sup>39</sup> Udhëzimi në fjalë i referohet Organizimit të Brendshëm të Punës në Prokurorin e Shtetit, duke marr për bazë strukturën organizative të prokurorive para hyrjes në fuqi të ligjit për Prokurorin e Shtetit në vitin 2013. Megjithëse është miratuar kjo rregullore, shumë çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me organizimin e brendshëm të Prokurorit të Shtetit kanë mbetur pa u adresuar qartë. Në kuadër të kësaj është e rëndësishme të theksohet se vitet e tëra të veprimtarisë së KPK-së pa këtë rregullore kanë krijuar shumë vështirësi praktike në punën efikase të prokurorit të shtetit.

#### **f) Transferimi dhe ngritja në detyrë e gjykatësve dhe prokurorëve**

IKD gjatë analizimit të vendimeve të KGJK për vitin 2014 dhe vitin 2015, ka vërejtur se KGJK gjatë këtyre dy viteve ka transferuar tre gjykatës prej një Gjykate Themelore në një Gjykatë tjetër Themelore në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, përderisa transferim të përhershëm ka ndodhur në dy (2) raste, një rast prej Gjykatës Themelore në Gjilan në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe anasjelltas.<sup>40</sup> Në mungesë të Rregullorës për Transferim të miratuar nga KGJK, transferimet e

<sup>38</sup> *Shënim:* IKD vazhdimisht ka bërë kërkesa për qasje në dokumente publike dhe informacione të ndryshme në KPK dhe përgjigja e zyrtarëve të KPK-së për një pjesë të kërkesave ka qenë pozitive, ndërsa për një pjesë nuk ka pasur fare përgjigje.

<sup>39</sup> Udhëzuesi për Zyrat Prokuroriale të Republikës së Kosovës: Procedurat Administrative. Maj 2010. (Shih linkun <http://www.drejtësia->

[ks.org/repository/docs/PAM%20Prosecution%20Administrative%20Manual\\_ALB%2030%20May%202010.pdf](http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/PAM%20Prosecution%20Administrative%20Manual_ALB%2030%20May%202010.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).

<sup>40</sup> **Vendim nga mbledhja e 138-të e KGJK-së të mbajtur më 21 tetor 2015**, Z. Kreshnik Radoniqi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë, transferohet përkohësisht, për periudhë gjashtë (6) muajve në Gjykatën Themelore në Prishtinë; **Vendim nga mbledhja e 141-të e KGJK-së të mbajtur më 18 nëntor 2015**,; Apropohet kërkesa e z. Burim Emerllahu, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan për transfer në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe Apropohet kërkesa e z. Venhar Salihu, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj për transfer në Gjykatën Themelore në Gjilan; **Vendim nga mbledhja e 144-të e KGJK-së të mbajtur më 31 dhjetor 2015**: Gjyqtari Elmaz Zenuni, transferohet përkohësisht në afat kohor prej gjashtë (6) muaj duke filluar nga data 1 janar 2016, nga Gjykata Themelore në Ferizaj në Gjykatën Themelore në Prishtinë në

lartëpërmendura janë realizuar kryesisht në bazë të kërkesave individuale të paraqitura nga gjykatësit dhe të bazuara në praktika që ka krijuar në këtë rast KGJK. KGJK vetëm në fund të vitit 2015, kishte miratuar rregullore që mbulon këtë fushë.

Po ashtu edhe KPK nuk ka përcaktuar rregullat dhe procedurat lidhur me transferimin dhe avancimin e prokurorëve.<sup>41</sup> Mungesa e këtyre rregullave dhe procedurave, ka rezultuar në praktikë me mos zbatim të nenit 22 të LKPK, lidhur me caktimin dhe avancimin e prokurorëve, me mungesë të llogaridhënies dhe ndërhyrjeve politike si dhe po ashtu me krijimin e praktikave selektive dhe me standarde të dyfishta lidhur me transferimin dhe avancimin e prokurorëve. Në lidhje me këtë Raporti i Progresit për vitin 2015, shpreh shqetësimet lidhur me emërimet e kontestuara dhe se mandatet e paqarta kanë minuar aktivitetet e institucioneve kyqe si të KGJK-së, KPK-së dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.<sup>42</sup> Përderisa neni 22 i ligjit përcakton se:

- “Me paraqitjen e kërkesës nga Kryeprokurori, KPK mund të transferojë një prokuror në një prokurori tjetër për një periudhë kohore jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj për një herë.
- Transferimi sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të ndërmerret në rastet kur një prokurori ka numër të pamjaftueshëm të prokurorëve për të kryer lëndët që i ka në kompetencë.
- Për raste të jashtëzakonshme, Kryeprokurori i Shtetit mundet përkohësisht të transferojë një prokuror në një prokurori tjetër. Transferim i ndërmarrë sipas kësaj dispozite nuk mund të tejkalojë tridhjetë (30) ditë përveç nëse Këshilli miraton një periudhë më të gjatë”.

Këshilli Prokurorial tanimë e ka shndërruar në praktikë ngritjen në detyrë të prokurorëve nga Departamenti i Përgjithshëm në atë për Krime të Rënda, vetëm në bazë të kërkesës së paraqitur nga Kryeprokurori i Prokurorisë përkatëse. Praktikrat e deri tanishme të ndërtuara nga KPK nga viti 2011, kanë anashkaluar institutin e konkursit, duke mos iu ofruar kushte të barabarta të gjithë kandidatëve të interesuar dhe që plotësojnë kriteret për të u ngritur në detyrë.<sup>43</sup> Shqetësuese mbetet fakti se nuk ekziston mekanizëm mbrojtës për prokurorët në sistem për të paraqitur ankesë ndaj vendimeve të tilla kur kanë pakënaqësi edhe pse KPK ka pasur obligim që që të “shpallë rregullat dhe rregulloret që përcaktojnë standardet dhe procedurat që qeverisin ankesat.”<sup>44</sup>

Në kontekst të asaj që u konstatua më lartë, në përputhje edhe me konceptin e llogaridhënies dhe transparencës një fakt i rëndësishëm që vlen të theksohet ka të bëjë më atë se KPK edhe përkundër faktit se ka autorizuar Komisionin për Akte Normative të KPK-së, për hartimin e Rregullores për Caktimin e Kritereve dhe Procedurave për Përzgjedhjen dhe Emërimin e Kryeprokurorëve, një rregullore e tillë është miratuar në Këshill vetëm në fund të vitit 2015. Kjo ka ndikuar që pozita e Kryeprokurorit të PSRK-së ende të jetë më ushtrues detyre që nga viti 2014. Po ashtu, Prokuroria e Apelit në Prishtinë udhëhiqet nga ushtruesi i detyrës së kësaj prokurorie. KPK ende nuk ka shpallur konkursin për këto dy pozita.

---

Departamentin për Krime të Rënda. Gjyqtari Valon Kurtaj, transferohet përkohësisht në afat kohor prej gjashtë (6) muaj duke filluar nga data 1 janar 2016, nga Gjykata Themelore në Prizren në Gjykatën Themelore në Prishtinë në Departamentin për Krime të Rënda.

<sup>41</sup> KPK në muajin prill 2016, ka miratuar Rregullore për Transferim të Prokurorëve.

<sup>42</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015. Faqe 12. (Shih linkun [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 15 mars 2016).

<sup>43</sup> KPK nga 1 janar 2013 deri më 31 dhjetor 2015, ka marrë 36 Vendime për transferim apo avancim të prokurorëve vetëm në bazë të kërkesave individuale apo kërkesave të paraqitura nga Kryeprokurorët e prokurorive përkatëse, ndërsa tre (3) kërkesa për transferim apo avancim nuk janë miratuar në KPK.

<sup>44</sup> Neni 22 pika 6 e Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Ndër të tjera mungesa e vullnetit të KPK-së për të emëruar Kryeprokurorin e PSRK-së, ka ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e kësaj prokurorie, dhe me këtë edhe në mungesën e rezultateve në këtë prokurori. PSRK ka kompetenca pothuajse ekskluzive në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë, dy fushat kyçe që për Kosovën janë bërë pengesë në procesin e integritetit evropian,<sup>45</sup> dhe kjo është reflektuar edhe në Raportin e Progresit për vitin 2015. “Kosova është në fazën fillestare të përgatitjes në luftën kundër korrupsionit. Një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike është e nevojshme për të siguruar rezultate reale në luftimin e korrupsionit endemik në Kosovë. Hetimet e rralla të korrupsionit të nivelit të lartë deri më tani nuk kanë rezultuar me dënime përfundimtare”. Sikurse tashmë është dëshmuar mungesa e vullnetit të KPK-së për të fuqizuar dhe funksionalizuar PSRK. Kjo prokurori nga 18 pozita të lejuara për prokurorë ka të plotësuar vetëm 8 pozita. Kjo qasje e KPK-së dëshmon konstatimin e Raportit të Progresit se mungon një ëasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike për të krijuar se paku kushtet bazike në PSRK për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin e nivelit të lartë, krimet e luftës, shpërlarjen e parasë dhe veprat penale të terrorizmit.

Raporti i Progresit për vitin 2015, po ashtu në mënyrë të qartë konfirmon mungesën e llogaridhënies dhe vullnetit të bartësve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial për të ndërmarr veprime që hyjnë në kuadër të kompetencave të tyre për të funksionalizuar gjyqësorin në Kosovë. Ndër të tjera në këtë raport theksohet: “Sidoqoftë, administrimi i drejtësisë është i ngadalshëm dhe ka mungesë të llogaridhënies së zyrtarëve gjyësor. Strukturat gjyqësore ende janë të nënshtruara ndaj ndërhyrjeve politike. Ka shqetësime se emërimet e kontestuar dhe mandatet e paqarta kanë minuar aktivitetet e institucioneve kyçe si KGJK dhe KPK, Zyrat e Prokurorive të Kosovës dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit”.<sup>46</sup>

### **g) Mungesa e mbrojtjes efikase gjyqësore për gjykatësit dhe prokurorët**

Një çështje tejet e rëndësishme që nuk është adresuar në pakon e ligjeve të gjyqësorit në Kuvendin e Kosovës, ndërlidhet me mbrojtjen gjyqësore për gjykatësit dhe prokurorët kur janë subjekt i vendimeve të Këshillave dhe potencialisht me këto vendime atyre i shkelen të drejtat e tyre. Kjo zbrazëti juridike ishte theksuar në Raportin e Progresit, duke iu referuar procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, ku është kërkuar që gjatë plotësimit ndryshimit të këtyre ligjeve, “të prezantohen mjetet e duhura ligjore kundër vendimeve të Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor për të shmangur që mundësia e vetme kundër këtyre vendimeve të jetë Gjykata Kushtetuese”.

Sidoqoftë, edhe përkundër këtij shqetësimi të ngritur dhe kërkesës së paraqitur nga Komisioni Evropian përmes Raportit të Progresit, gjatë plotësimit ndryshimit të ligjeve për KGJK dhe KPK, kjo çështje problematike nuk është adresuar në këto ligje, edhe përkundër faktit se dispozitat që sigurojnë mbrojtjen gjyqësore për gjykatës dhe prokuror, kanë qenë pjesë e draftligjeve të paraqitura nga Ministria e Drejtësisë në Kuvendin e Kosovës.<sup>47</sup> Dispozitat lidhur me mbrojtjen gjyqësore nuk kanë gjetur përkrahje nga legjislativi i shtetit.

<sup>45</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015. Faqe 3. (Shih linkun [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)) (Qasur për herë të fundit më 15 mars 2016).

<sup>46</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015. Faqe 12. (Shih linkun [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 15 mars 2016).

<sup>47</sup> IKD intervistë me z. Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore në MD. Dhjetor 2015.



Mungesa e mjetit efektiv juridik ndaj vendimeve të KGJK-së dhe KPK-së paraqet një pasiguri juridike për gjykatësit<sup>48</sup> dhe prokurorët dhe palët e tjera gjatë ushtrimit të funksionit të tyre. Një gjë e tillë i privon me automatizëm ata që një të drejtë të tyre ta realizojnë në kohë të arsyeshme, siç është e paraparë në nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), që zbatohet drejtëpërdrejtë në Republikën e Kosovës por edhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) që po ashtu zbatohen drejtëpërdrejtë në Republikën e Kosovës, në përputhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Mungesa efektive e mbrojtjes ligjore ndaj vendimeve të KGJK-së dhe KPK-së lidhur me disiplinimin, emërimin, ri-emërimin, propozimin për shkarkim, vlerësimin e performancës apo transferimin e gjykatësve dhe prokurorëve do të reflektoj në kufizimin e të drejtave të gjykatësve dhe prokurorëve si subjekt të vendimeve të dy Këshillave, dhe me këtë edhe kufizim të llogaridhënies, pavarësisë dhe transparencës së sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial. Çështja e mjetit efektiv të mbrojtjes ligjore ndaj vendimeve të këshillave është rekomanduar të zgjedhet edhe nga Komisioni i Venecias,<sup>49</sup> i cili ka rekomanduar që të krijohet mundësi të ankimit ndaj vendimeve të Këshillit.<sup>50</sup> Mungesa e një mjete ligjor ndaj vendimeve të KGJK dhe KPK krijon mundësinë reale për shkelje të të drejtave të njeriut të paraparë në Kushtetutë dhe në KEDNJ, sidomos të drejtën për mjete efektive juridike.<sup>51</sup>

#### **IV. OBLIGIMET E KGJK DHE GJYKATËS SUPREME LIDHUR ME ZBATIMIN E LIGJEVE TË PLOTËSUARA PËR KGJK DHE GJYKATA**

Me ndryshimet e reja në pakon e ligjeve të gjyqësorit është ndërruar koncepti dhe praktika e deritanishme në lidhje me procedurat dhe kriteret që kanë të bëjnë me rekrutimin dhe emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve. Me hyrjen në fuqi të këtyre ligjeve, KGJK dhe KPK së voni kanë miratuar rregulloret dhe aktet e brendshme të dy këshillave lidhur me procesin e rekrutimit dhe propozimit për emërim të gjykatësve dhe prokurorëve të rinj. Këto ndryshime kanë ardhur duke pasur parasysh se me Raportin e Progresit për vitin 2014, ishte kërkuar që ndër të tjera të harmonizohen dispozitat që kanë të bëjnë me rekrutimin e gjykatësve dhe prokurorëve. Të dy këshillat gjatë plotësimit të rregulloreve për rekrutim është dashur të harmonizojnë të njëjtat, duke marrë parasysh specifikat për gjykatës dhe prokurorë.

Së këndejmi plotësim ndryshimi i Ligjit të KGJK-së, lidhur me këtë çështje specifike, ka reflektuar ndryshimet substanciale lidhur me përcaktimin e rregullave dhe procedurave për organizimin e provimit për kandidatë për gjykatës dhe shpalljen dhe organizimin e provimit për gjykatës, kriter ky

<sup>48</sup> IKD intervistë me z. Agim Maliqi, anëtar i KGJK-së. Dhjetor 2015.

<sup>49</sup> Raport mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor. Pjesa I: Pavarësia e gjyqtarëve. Komisioni Evropian për Pavarësi përmes Ligjit (*Komisioni i Venecias*). Komenti 43. Komisioni i Venecias në vazhdimësi ka mbështetur parimin e patundshmërinë në kushtetuta. Transferet në kundërshtim me vullnetin e gjyqtarëve mund të jenë të lejueshme vetëm në raste të veçanta. Sa i përket procedurave disiplinore, Raporti i Komisionit në mbi Gjyqësorin CDL-AD(2010)004- 10 – Emërimet4 favorizon që kompetencat për procedura disiplinore t'i kenë këshillat gjyqësorë ose gjykatat disiplinore. Përveç kësaj, Komisioni vazhdimisht ka argumentuar se duhet lënë mundësi për të bërë ankesa në gjykata, kundër vendimeve të organeve disiplinore. Faqe 9-10.(Shih linkun [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2010\)004-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2010)004-e)). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).

<sup>50</sup> Raport mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor. Pjesa I: Pavarësia e gjyqtarëve. Komisioni Evropian për Pavarësi përmes Ligjit (*Komisioni i Venecias*). Përmbledhje e Komisionit të Venecias: “*Këshillat gjyqësorë, apo gjykatat disiplinore, duhet të ketë një ndikim vendimtar në procedura disiplinore. Mundësia e ankimit në gjykatë kundër vendimeve të organeve disiplinore duhet të sigurohet për*”. Faqe 17. (Shih linkun [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2010\)004-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2010)004-e)). (Qasur për herë të fundit më 15 mars 2016).

<sup>51</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 22.2, neni 32, neni 53 dhe 54.



përcaktuar me nenin 26 pika 1.7 të Ligjit për Gjykatat. KGJK këto rregulla dhe procedura nuk i ka miratuar deri më 31 dhjetor 2015, ndërsa miratimi i tyre është bërë tek në prill 2016.<sup>52</sup> Kjo edhe njëherë vë në pah dinamikën e ngadalshme të këtyre ndryshimeve substanciale dhe shumë të nevojshme.

Një problem i shfaqur në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për KGJK dhe Ligjit për KPK ka të bëjë me përfaqësimin e Odës së Avokatëve në këta dy këshilla, e cila ka qenë e përfaqësuar edhe më herët para se të ndodhin këto ndryshime. Neni 3 pika 9, e ligjit të plotësuar<sup>53</sup> përcakton se anëtari i KGJK dhe KPK që vjen nga Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK), nuk mund të ushtroj funksionin e avokatit derisa është anëtar i KGJK-së, dhe se paga e këtij anëtari caktohet dhe paguhet nga OAK. Zbatimi i kësaj dispozite në praktikë paraqet sfida në radhë të parë për OAK-un për shkak të ndikimit financiar dhe mungesës së buxhetit për kompensimin e pagës së anëtarit të tij në KGJK. Gjithashtu e njëjta dispozitë është paraparë edhe për anëtarin e OAK-ut në KPK. Në kontekst të kësaj vërehet se kjo dispozitë apo zgjidhje e re ka hapur shumë probleme në praktikë, përveç çështjes së pagesës gjithashtu edhe kufizimit të ushtrimit të profesionit.

Duke u bazuar në këtë në të njëjtën kohë do të jetë e vështirë, që avokatët me përvojë dhe ekspertizë të sakrifikonin karrierën dhe klientelën e tyre në kuadër të këtij profesioni të lirë ligjor, duke pezulluar punën e tyre si avokatë për pesë vite sa zgjatë mandati i anëtarit të Këshillit, për një pagë e cila mund të i'u caktohet nga OAK-u e që akoma nuk është caktuar.

Është qartazi e dukshme që praktika e ndërtuar nga Kuvendi i Kosovës, lidhur me anëtarin e Këshillit nga OAK dhe specifikat e zgjidhjeve të reja, mund të ndikoj që pozita e anëtarit nga OAK në KGJK dhe KPK të mos plotësohet dhe mos të ketë fare përfaqësim të avokatëve në dy Këshillat. Për më tepër, ajo që forcon këtë pretendim është edhe fakti që miratimi i kësaj dispozite vlerësohet absurditet juridik nga vetë përfaqësuesit e OAK-ut, të cilët janë përfaqësuar si anëtar në KPK.<sup>54</sup> Andaj bazuar në këtë, kjo dispozitë e re ligjore objektivisht do të ndikon që në KPK mos të ketë anëtar joprokuror nga radhët e avokatëve. Vlen të theksohet se hartimi dhe miratimi i kësaj dispozite, ka ardhur si pasojë e përplasjeve politike dhe partiake<sup>55</sup>. Në raport me këtë ideja që përmes kësaj dispozite do të bëhet shmangia e konfliktit të interesit, për përfaqësuesit e OAK-ut nuk qëndron ngase anëtari joprokuror i KPK-së si avokat duhet të kujdeset vet për të shmangur konfliktin e interesit pasi futet në domenin e përgjegjësisë penale dhe kjo është qartazi e përcaktuar me rregullat e brendëshme. Për më tepër edhe në shtetet me demokraci dhe shtetet ligjore të konsoliduara kanë avokat në përbërje të institucioneve të drejtësisë.<sup>56</sup>

Në kontekst të kësaj që u theksua më sipër në këtë seksion të trajtimit, IKD rekomandon që të shqyrtohet mundësia që në bashkëpunim më Ministrinë e Drejtësisë me procedurë të përsheptuar të ri shqyrtohet ligji për KGJK dhe KPK, në mënyrë që të adresohet dhe përmirësohet çështja e anëtarit nga OAK-u por edhe plotësimi i këtyre ligjeve me dispozita kalimtare që do të sqaronin statusin e kandidatëve që kanë kaluar provimin përgatitor për gjykatës dhe prokurorë.

Me plotësim ndryshimin e Ligjit mbi Gjykatat, në nenin 6 të ligjit bazik, është shtuar obligimi i Gjykatave të publikojnë aktgjykimet e plotfuqishme në faqe të tyre zyrtare të internetit, në afat prej

<sup>52</sup> *Shënim:* Kjo rregullore së bashku me aktet e tjera dhe vendimet e KGJK-së do të jenë subjekt i analizës në raportin periodik të radhës, i cili publikohet nga IKD si rezultat i monitorimit të KGJK-së.

<sup>53</sup> Ligji nr. 05/L-33, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-233, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. (Shih linkun <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2713>). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).

<sup>54</sup> IKD intervistë me z. Teki Bokshi, anëtar i KPK-së. Dhjetor 2015.

<sup>55</sup> Shih fusnotën 55.

<sup>56</sup> IKD intervistë me z. Teki Bokshi, anëtar i KPK-së. Dhjetor 2015.

gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e arritjes së plotfuqishmërisë së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e KGJK-së, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale. Po ashtu, në vazhden e këtij trajtimi është e rëndësishme se KGJK ende nuk ka miratuar rregullore lidhur me kualifikimin dhe klasifikimin e dokumenteve në KGJK dhe Gjykata. Kjo nuk ka ndodhur edhe përkundër faktit se ky ishte obligim që do duhej plotësuar sipas nenit 4 paragrafi 1.23 të LKGJK, respektivisht hartimin dhe shpalljen e akteve nën-ligjore në përputhje me ligjet për informimin publik që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe zbulimin e informacionit që ruhet nga gjyqësori i Kosovës.

Gjithashtu në mungesë të këtij akti nënligjor publikimi i aktgjykimeve të plotfuqishme nga gjykatat, do të sfidojë këto institucione me mungesën e personelit të kualifikuar nëpër gjykata, duke pasur parasysh se çdo aktgjykim i shpallur duhet të respektoj dhe të ruaj të dhënat personale të personave të tretë në aktgjykim, apo informacion tjetër lidhur me palët e përfshira në aktgjykim, por që publikimi i tyre, përbën shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për më tepër mungesa e Rregullores lidhur me Kualifikimin dhe Klasifikimin e Dokumenteve në Gjyqësor, do të paraqitet si pengesë shtesë edhe në zbatimin efikas dhe të bazuar në ligj nga sistemi gjyqësor.

Përveç kësaj KGJK duhet urgjentisht të filloj përgatitjen dhe krijimin e infrastrukturës së re lidhur me themelimin e Degëve të reja të Gjykatave në Obiliq, Fushë Kosovë, Junik dhe Shtime, etj, duke pasur parasysh kohën e shkurtër që i është lënë në dispozicion KGJK-së lidhur me zbatimin e këtij obligimi nga Kuvendi i Kosovës. Zbatimi i këtyre dispozitave duhet të filloj nga data 1 janar 2016, edhe pse KGJK kishte kërkuar që kjo dispozitë të hynte në fuqi me 1 janar 2017.<sup>57</sup> Kjo gjithashtu do të jetë një sfidë shtesë në zbatimin sa më efikas të pakos së ligjeve të gjyqësorit, ndërkaq që ky mosefikasitet mund të sjell pasoja praktike në kuptimin e mosfunksionimit të mirëfilltë të sistemit gjyqësor por edhe të sistemit prokurorial po ashtu.

## **V. MIRATIMI I LEGJISLACIONIT SEKONDAR DHE POLITIKAVE NGA KGJK**

Procesi i hartimit dhe miratimit të politikave dhe legjislacionit sekondar nga KGJK ka qenë dhe mbetet sfidë e vazhdueshme njëjtë sikur edhe në KPK, si në aspektin cilësor dhe sasior, sidomos në mungesën e transparencës në lidhje me vendimmarrjen në hartimin e këtij legjislacioni.

IKD gjatë procesit të hulumtimit, ka vërejtur se ka munguar dhe mungon transparenca në përpilimin e akteve nënligjore, përcaktimi i agjendës së legjislacionit sekondar dhe pjesëmarrja e grupeve të interesit në këtë proces si dhe diskutimet me publikun. Mungesa e ekspertizës dhe përfshirjes së Gjykatësve dhe Kryetarëve të Gjykatave, në procesin e përpilimit të politikave dhe legjislacionit sekondar të KGJK-së ka ndikuar drejtpërdrejtë në cilësinë e akteve të miratuara nën-ligjore, të cilat krijojnë probleme gjatë zbatimit të ligjit në praktikë dhe ka vënë në pah kualitetin e tyre të dobët

Zvarritjet në miratim të akteve nënligjore nënkuptohen si neglizhencë të KGJK-së dhe mungesë të vullnetit që të zbatohen dispozitat ligjore. Kjo qasje neglizhente është vështirë të kuptohet andaj kjo vonesë është e pajustificueshme sjell efekt zinxhiror të mos zbatimit të këtyre akteve në të gjitha

---

<sup>57</sup>IKD intervista me z. Enver Peci, Kryesues i KGJK-së dhe z. Albert Avdiu, Drejtor i Sekretariatit të KGJK-së. Gusht 2015.

hallkat e institucioneve të sundimit të ligjit.<sup>58</sup> Gjithashtu, sfidë e madhe e madhe mbetet zbatimi në praktikë i këtij legjislacioni por edhe mënyra e zbatimit, qoftë kjo edhe përmes akteve nënligjore.<sup>59</sup>

KGJK gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2015, ka miratuar këto rregullore: Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Supreme; Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën e Apelit; Rregulloret për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatat Themelore në Prishtinë, Pejë; Gjakovë, Prizren; Ferizaj; Mitrovicë; dhe Gjilan; Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e KGJK dhe Njësitin për Shqyrtimin e Përformancës së Gjykatave, Rregulloren për Përcaktimin e Rregullave dhe Procedurave për Organizimin e Provimit për Gjykatës, Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Zgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga Gjyqësori, Rregulloren për Emërimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësor, Rregulloren për Emërimin e Ekspertëve Gjyqësor.

KGJK po ashtu ka miratuar Udhëzimet Administrative (UA) për zbatim të vendimit të KGJK-së për delegim të përgjegjësive në çështje të personelit, buxhetit dhe financave, prokurimit dhe logjistikës, UA për periudhën kalimtare, UA për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit, UA për zbatimin e procedurës për kompenzimin e dëmit.

Për të gjitha këto akte nënligjore të KGJK-së dhe vendimet specifike që ka nxjerrë KGJK, IKD më poshtë ka analizuar përmbajtjen e tyre, nëse të njëjtat akte janë në harmoni me legjislacionin bazë, praktikat dhe standardet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

#### a) Rregulloret

IKD në vazhdim ka analizuar disa prej akteve nënligjore më të rëndësishme, të cilat janë miratuar në nëntor dhe dhjetor 2015. Ndër të tjera gjetjet e IKD-së tregojnë se disa prej akteve të miratuara janë në kundërshtim me praktikat dhe standardet ndërkombëtare.

- **RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KGJK-SË NGA GJYQËSORI**

Rregullorja për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga gjyqësori është miratuar më 21 maj 2015, ka përcaktuar procedurat dhe rregullat për përzgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së nga radhët e kolegëve nga vetë gjyqësori.

Neni 3 i kësaj rregullore ka paraparë kriteret për përzgjedhjen e gjyqtarëve për anëtarë të KGJK-së. IKD vëren se në këtë rregullore, KGJK ndër kriteret që duhet plotësuar për t'u përzgjedhur anëtar i KGJK-së ka paraparë që gjyqtari të jetë i emëruar me mandat të përhershëm dhe të ketë kualifikime dhe ekspertizë të nevojshme profesionale. Përderisa anasjalltas rregullorja e miratuar nga KPK lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të KPK-së, nuk ka paraparë kriteret e njëjta dhe ishte kufizuar vetëm në kriteret që prokurori që kandidon për anëtar të KPK-së të mos ketë masë disiplinore të shqiptuar në tre

<sup>58</sup> IKD intervistë me znj. Ariana Qosaj Mustafa, Hulumtuese e Lartë në Institutin KIPRED. Janar 2016.

<sup>59</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015. Faqe 13. (Shih linkun [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)). (Qasar për herë të fundit më 10 mars 2016).

vitet e fundit dhe mos të jetë dënuar për vepër penale, me përjashtim të kundërvajtjeve, pra kritere këto krejt të përgjithshme.<sup>60</sup>

Siç mund të vërehet, praktika e ndjekur nga KPK, në kuptim të këtyre kritereve ka mundësuar që një numër i madh i prokurorëve që kanë kandiduar për anëtarë të KPK-së, në kohën kur kanë aplikuar kanë qenë me mandat fillestar dhe se të njëjtit edhe janë përzgjedhur anëtar të KPK-së nga 1 janar 2016.<sup>61</sup>

IKD ndër të tjera vlerëson se miratimi i Rregulloreve nga KGJK dhe KPK-së për përzgjedhjen e anëtarëve të dy Këshillave, duke aplikuar kritere të ndryshme, është në kundërshtim me frymën e dy ligjeve dhe rekomandimet dhe qëllimin e Komisionit Evropian, i cili gjatë plotësim ndryshimit të ligjeve, kishte përcaktuar si kriter për Republikën e Kosovës, harmonizimin e dispozitave ligjore dhe praktikave në mes të KGJK-së dhe KPK-së.

Miratimi i Rregulloreve në kundërshtim me frymën e ligjit dhe rekomandimet e Komisionit Evropian, është edhe një dëshmi shtesë se politikat dhe legjislacioni sekondar, hartohet dhe miratohet, duke u bazuar në interesa të caktuara individuale, gjë e cila edhe mund të vërehet qartazi.<sup>62</sup> Praktika e tillë e ndjekur paraqet pengesa serioze për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave ëga KGJK dhe KPK, siç përcaktohet në Kushtetutë dhe ligj, pasi që prokurorët e caktuar si anëtarë me mandat fillestar, të njëjtit, duhet të caktohen si anëtar të Komisioneve të Përhershme apo Komisioneve tjera të KPK-së si: Komisioni Disiplinor, Komisioni për Vlerësim të Performancës së Prokurorëve, Komisionit për Emërim, Riemërim, Avancim apo Transferim të Prokurorëve, praktikë kjo e cila bie në kundërshtim edhe me vetë logjikën dhe frymën kushtetuese përse i përket mandatit të prokurorëve si dhe ndarjen kushtetuese që ekziston në mes të mandatit fillestar dhe atij të përhershëm.

Në vijim të kësaj, IKD vlerëson se është e papranueshme që prokurorët me mandat fillestar, me përvojë ndoshta edhe disa mujore, të kenë mundësinë që me kaq pak përvojë eventuale, aftësi profesionale dhe praktike, të vlerësojnë performancën e prokurorëve me përvojë, përfshi nivelin e prokurorëve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorisë së Apelit, PSRK-së dhe PTh-ve apo të jenë përgjegjës për disiplinimin e shkeljeve të pretenduara nga kolëgët e tyre. Në fakt kjo tanimë është mundësuar dhe është prezente në përbërjen aktuale të KPK-së.

Po ashtu duhet të vënë në pah se kriteret dhe standardet profesionale për gjykatësit dhe KGJK-në, në shumicën e vendeve tjera që zbatojnë modelin e funksionimit të Këshillave Gjyqësor dhe Prokurorial, janë ekuivalente edhe për prokurorët dhe zbatohen praktika të njëjta si për gjykatësit ashtu edhe për prokurorët. Përderisa, Kosova këtë kriter e kishte plotësuar gjatë plotësimin ndryshimit të ligjeve të gjyqësorit<sup>63</sup>, përmes rregulloreve të miratuara më kritere të ndryshme, dy Këshillat kanë devijuar nga

<sup>60</sup> Rregullore për Përzgjedhjen e Anëtarëve të KPK-së, miratuar më 5 gusht 2015. Këshilli Prokurorial i Kosovës. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.786.2015-Rregullore\\_Nr.02.2015--Per\\_zgjedhjen\\_e\\_anetareve\\_te\\_KPK-se.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.786.2015-Rregullore_Nr.02.2015--Per_zgjedhjen_e_anetareve_te_KPK-se.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 15 mars 2016).

<sup>61</sup> Rregullore e Këshillit Prokurorial të Kosovës, për Zgjedhjen e Antërëve të KPK-së. Këshilli Prokurorial i Kosovës. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.786.2015-Rregullore\\_Nr.02.2015--Per\\_zgjedhjen\\_e\\_anetareve\\_te\\_KPK-se.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.786.2015-Rregullore_Nr.02.2015--Per_zgjedhjen_e_anetareve_te_KPK-se.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 18 mars 2016).

<sup>62</sup> *Shënim*: Në takimin e pestë plenar lidhur me Marrëveshjen për Stabilizim Associm mes Kosovës dhe BE-së, të mbajtur me 8 korrik 2015, z. Jean-Eric Paquet, Drejtor për Ballkanin Perëndimor të Komisionit Evropian është shprehur lidhur me zbatimin e pakos së ligjeve, duke u shprehur se: “*Mirëpresin miratimin e katër ligjeve që dalin nga pakoja e gjyqësorit. Miratimi i legjislacionit është vetëm hapi i parë i ndryshimit të sistemit apo strukturës. Kosova tani ka nevojë të fokusohet në zbatimin rigoroz dhe të përshtatshëm të këtyre ligjeve*”. Z. Paquet ka ngritur shqetësimin lidhur me bazën ligjore të mandateve të disa anëtarëve të KPK-së.

<sup>63</sup> Raporti i tretë lidhur me progresin e Kosovës, në përmbushjen e kritereve për liberalizim të vizave. Publikuar më 18 dhjetor 2015. Blloku 3, Siguria dhe Rendi Publik. Faqe 6. (Shih linkun <https://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/1/2015/EN/1-2015-906-EN-F1-1.PDF>). (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2016).

qëllimi për të cilin këto ligje ishin plotësuar dhe ndryshuar. Kjo ndodhë për shkak se në secilin vend KGJK dhe KPK kanë të njëjtin mision dhe detyrë kushtetuese, andaj edhe aplikimi i standardeve nuk mund të dallojë në mënyrë kaq të hapur.

Në vazhdim të këtij seksioni e rëndësishme është edhe fakti se KGJK më 18 nëntor 2015, ka miratuar Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Zgjedhjen e Anëtarëve të KGJK-së nga gjyqësori, e cila ishte miratuar më 21 maj 2015. Plotësim ndryshimi i kësaj rregullore ka përfshirë kufizimin e përcaktuar me nenin 3 të Ligjit për plotësim ndryshimin e Ligjit për KGJK, të Kryetarëve të Gjykatave për të konkuruar për anëtarë të KGJK-së. Lidhur me këtë përjashtimisht, Kryetarët e Gjykatave mund të kandidojnë për anëtar të KGJK-së me kusht që të japin dorëheqje nga pozita e Kryetarit të Gjykatës.

Një ndër të metat e këtij akti është se rregullorja për plotësim ndryshim dhe Rregullorja bazë nuk kishte paraparë dispozita të qarta lidhur me zbatimin e dispozitave mbi barazinë gjinore dhe përcaktimin e nivelit të gjykatësve të disa niveleve të gjyqësorit. Nuk është përcaktuar po ashtu nëse gjykatësit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe Panelit të Ankesave lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, janë të barabartë me gjykatësit e Gjykatës Supreme dhe nëse të njëjtit duhet të marrin pjesë në procesin e votimit dhe zgjedhjes për anëtarë të KGJK nga radhët e gjykatësve të Gjykatës Supreme.

Mungesa e këtyre dispozitave në Rregulloret për përzgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së nga radhët e gjyqësorit ka paraqitur pengesa në procesin e emërimit të anëtarëve të rinj të KGJK-së nga radhët e Gjykatës Supreme,<sup>64</sup> duke përfshirë mos pajtimet në mes të anëtarëve të KGJK-së lidhur me atë se kur duhet të zgjedhet Kryesuesi i ri i KGJK-së para përfundimit të mandatit apo pas përfundimit të mandatit të Kryesuesit të KGJK-së, Enver Peci, të cilit mandati i ka skaduar më 8 mars 2016, sipas vendimit të KGJK-së<sup>65</sup>. Kjo është përcjellur edhe me debate të theksuara në kuadër të këtij institucioni.

- **RREGULLORE PËR EMËRIMIN E INTERPRETËVE DHE PËRKTHYESVE GJYQËSOR**

Më 16 nëntor 2015, KGJK ka miratuar Rregulloren për Emërimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësor, përmes së cilës janë përcaktuar procedurat e emërimit, kushtet, të drejtat dhe detyrimet për përkthyes dhe interpret ligjor.

- **RREGULLORE PËR EMËRIMIN E EKSPERTËVE GJYQËSOR**

KGJK më 10 nëntor 2015, ka miratuar Rregulloren për Emërimin e Ekspertëve Gjyqësor, me qëllim të përcaktimit të procedurave të emërimit, kushtet, drejtat dhe detyrimet, lartësinë e shpërblimit si dhe mënyrën e kompensimit të tyre. Miratimi i kësaj rregullore ishte obligim ligjor i përcaktuar me nenin 33 të Ligjit të plotësuar për Gjykatat.

Neni 3 i kësaj rregullore përcakton Komisionin për Emërimin e Ekspertëve, i cili në përbërje ka paraparë një anëtar të KGJK-së, në cilësinë e Kryetarit dhe dy gjykatësve. Komisioni Evropian për efikasitetin në drejtësi, i themeluar nga Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës në vitin 2012, për

---

<sup>64</sup> Mbledhja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. 2 shkurt 2016. (Shih linkun <https://www.youtube.com/watch?v=E997F90pbOw>). (Qasur për herë të fundit më 5 mars 2016).

<sup>65</sup> *Shënim*: Megjithatë, KGJK ka vendosur të zgjedhë Kryesuesin e ri të KGJK-së, para skadimit të mandatit të Kryesuesit z. Enver Peci. Në mbledhjen e KGJK-së të mbajtur më 10 shkurt 2016, KGJK ka votuar z. Nehat Idrizi për Kryesues të KGJK-së me mandat tre vjeçar, mandati i të cilit ka filluar më 8 mars 2016.

të vlerësuar efikasitetin dhe kualitetin e sistemeve gjyqësore, ka ardhur në përfundim së nuk ka konsensus lidhur me praktika unike apo standardet evropiane lidhur me dëshmitarët gjyqësor, sikurse nuk ka një praktikë unike lidhur me rekrutimin apo emërimin e ekspertëve gjyqësor. Përderisa në një numër të shteteve të njëjtit zgjedhen nga gjyqësori, në disa shtete tjera të njëjtit zgjedhen apo emërohen nga MD.

IKD gjen se mangësi e kësaj dispozite është mungesa e përfaqësimit në Komision të përfaqësuesve nga sektori i ekspertëve gjyqësor gjatë procesit të përzgjedhjes së tyre. Edhe pse jo në mënyrë specifike, praktikat dhe standardet ndërkombëtare rekomandojnë që komisionet apo panelet e përzgjedhjes apo emërimit duhet të përfshijnë edhe ekspertët teknik.<sup>66</sup> Përzgjedhja e profesionistëve në këtë fushë ka një rëndësi të veçantë për faktin se të njëjtit ekspertë do të këshillojnë gjykatësit në raste praktike lidhur me çështje specifike juridike apo çështje tjera me interes për një çështje të caktuar gjyqësore.

Neni 5 i kësaj rregullore përcakton kriteret lidhur me procesin e emërimit të ekspertëve gjyqësor. Kriteret e përcaktuara në këtë nen janë të përgjithshme. Duke pasur parasysh se ekspertët gjyqësor mund të vijnë nga fusha të ndryshme, kriteret dhe kushtet e përcaktuara duhet të jenë të veçanta. Praktika e vendeve të ndryshme të BE-së, parasheh po ashtu mundësinë e pjesëmarrjes edhe për persona juridik. Përzgjedhja dhe kriteret e përcaktuara paraprakisht, luajnë rol kyç lidhur me besueshmërinë dhe integritetin e ekspertëve, pasi puna e tyre kërkon jo vetëm standarde të larta të ekspertizës por edhe nivel të lartë të kualifikimit, i cili duhet të jetë në pajtim të plotë me kompleksitetin e pyetjeve dhe ekzaminimit, por edhe pavarësi të plotë dhe paanshmëri të ekspertit. Në mënyrë që këto standarde të larta të përmbushen dhe të ketë proces të drejtë të përzgjedhjes dhe emërimit të ekspertëve gjyqësor është e domosdoshme që KGJK përmes kësaj rregullore të përcaktoj dhe zbatoj rregulla dhe kriteret që garantojnë dhe sigurojnë punën e ekspertit në pajtim me parimet kushtetuese.<sup>67</sup>

Së fundmi neni 11 i kësaj Rregullore përcakton procedurën e angazhimit të ekspertëve gjyqësor. Neni i kësaj dispozite kufizon caktimin e ekspertëve vetëm nga gjykata, dhe përjashton të pandehurit që të kenë të drejtë të kenë qasje në listën e ekspertëve të miratuar nga KGJK. Kjo dispozitë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet bazë të garantuara me Kushtetutë dhe Kodin e Procedurës Penale, për një gjykim të drejtë dhe barazinë e armëve të palëve në procedurën penale. Po ashtu i njëjti parim duhet të aplikohet edhe në procedurat civile dhe tregtare.

#### • **RAPORTIMI I KRYETARËVE TË GJYKATAVE THEMELORE PARA KGJK-SË**

Gjatë muajit tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2015, Kryetarët e Gjykatave Themelore në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Gjiilan, dhe Pejë kanë raportuar para KGJK-së lidhur me organizimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të duhur të gjykatave respektive, sigurimin e vlerësimeve të rregullta periodike, mbi ngarkesën e lëndëve të gjykatave lidhur me funksionimin efikas të tyre dhe obligimeve tjera që dalin nga Ligji për KGJK dhe Rregullorja për Organizim të Brendshëm të Gjykatave.<sup>68</sup>

<sup>66</sup> Raport lidhur me Sistemet Gjyqësore Evropiane, Botimi 2014, (të dhënat 2012) Efikasiteti dhe Kualiteti në Drejtësi, Kapitulli 15. Faqe 444. (Shih linkun [http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/evaluation/2014/Rapport\\_2014\\_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/evaluation/2014/Rapport_2014_en.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).

<sup>67</sup> KOMISIONI EUROPIAN PËR EFIKASITETIN NË DREJTËSI (KEED) Udhëzues i CEPEJ. Faqe 41. (Shih linkun [http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/textes/Guidelines\\_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/textes/Guidelines_en.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 8 mars 2016).

<sup>68</sup> Raportimi i Kryetarëve të Gjykatave Themelore para Këshillit Gjyqësor të Kosovës; (<https://www.youtube.com/watch?v=FoBWLokwGVA>) dhe ([https://www.youtube.com/watch?v=2I34\\_yLr6hc](https://www.youtube.com/watch?v=2I34_yLr6hc)). (Qasur për herë të fundit më 22 mars 2016).

Vendimet e publikuara nga KGJK, lidhur me raportimin e Kryetarëve të Gjykatave Themelore nuk iu kanë referuar fare raportimit të përcaktuar me nenin 24<sup>69</sup> të Ligjit për KGJK-në. Përderisa, neni 24 paragrafi 4 i Ligjit për KGJK-në përcakton se “Kryetari i Gjykatës është përgjegjës për të siguruar se gjykata dhe proceset e saja janë të hapura dhe transparente për publikun. Pas shqyrtimit dhe pranimit nga Këshilli, raportet tremujore dhe vjetore mbi planin për menaxhimin e lëndëve do të bëhen publike.” Edhe përkundër këtij obligimi raportet e miratuara të punës së Gjykatave Themelore nga KGJK, nuk janë publikuar dhe nuk janë të qasshme për publikun.

IKD gjatë monitorimit të procesit të raportimit të Kryetarëve të Gjykatave Themelore, ka gjetur se ky proces më tepër ishte përbushje formale e një obligimi ligjor të përcaktuar me ligjin për KGJK-në dhe Rregulloren e Brendshme, vlerësim i gjendjes aktuale dhe identifikim i problemeve që ekzistojnë brenda Gjykatave Themelore, ku të gjithë kryetarët pa dallim po thuajse kanë paraqitur ankesa lidhur me mungesën e gjykatësve në gjykata, numrin e madh të lëndëve të vjetra në punë, kushtet jo adekuate për punë si në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, problemet dhe kushtet e rënda për punë në Pallatin e Drejtësisë, etj. Kjo dhe njëherë tregon nivelin e konstatuar edhe më lartë të seriozitetit në kuptim të instalimit të një llogaridhënie efikase.

Për më tepër përderisa, anëtarët e KGJK-së në shumicën e rasteve në raportimet e Kryetarëve të Gjykatave kanë pohuar problemet me të cilat ballafaqohen Kryetarët, Gjykatësit dhe gjyqësori në praktikë ata në asnjë rast nuk kanë kërkuar llogari apo nuk kanë tentuar për të mbajtur përgjegjës asnjë Kryetar të Gjykatave Themelore për mungesë të rezultateve.

Qartazi KGJK, gjatë procesit të raportimit të Kryetarëve të Gjykatave ka dështuar për të kryer obligimin e saj kushtetues dhe ligjor të mbikëqyrjes së gjykatave dhe funksionimit efikas dhe efektiv të tyre.<sup>70</sup> Pas raportimit të Kryetarëve të Gjykatave Themelore, KGJK nuk ka marr asnjë vendim, masë apo rekomandim konkret lidhur me performancën e Gjykatave konkrete apo gjyqësorit në përgjithësi për ngritje të efikasitetit. Po ashtu, gjatë procesit të raportimit nga Kryetarët e Gjykatave, vetëm një numër i kufizuar i anëtarëve të KGJK-së kanë qenë aktiv përmes pyetjeve dhe kërkesave për sqarime, ndërsa pjesa më e madhe e anëtarëve të KGJK-së, nuk kanë marr pjesë në diskutim. Kjo është dëshmi se ky proces është vlerësuar si formalitet ligjor.

Asnjë anëtar i KGJK-së nuk ka bërë pyetje për Kryetarët e Gjykatave lidhur me zbatimin e planeve strategjike, politikave apo obligimeve tjera të miratuara nga vetë KGJK.

Përmes mungesës së mbikëqyrjes proaktive nga KGJK lidhur me performancën e Gjykatave Themelore respektive, në praktikë në mënyrë të vazhdueshme sjell deri te mos ushtrimi i kompetencave dhe përgjegjësi që me Kushtetutë dhe ligj i janë dhënë KGJK-së.

<sup>69</sup> Neni 24-“Përgjegjësitë e Kryetarit të Gjykatës”.“Kryetari i një Gjykate Themelore ka autoritet të përgjithshme administrative dhe do të sigurojë administrimin efikas dhe efektiv të drejtësisë nga të gjitha degët, departamentet dhe divizionet e gjykatës. Kryetari i Gjykatës, në bashkëpunim me gjyqtarët e gjykatës, zhvillon planin vjetor për menaxhimin e lëndëve dhe cakton lëndët tek departamentet dhe gjyqtarët në atë mënyrë që të sigurojë zgjidhjen efikase të lëndëve. Kryetari i Gjykatës Themelore në baza vjetore i dërgon Këshillit një raport mbi suksesin e zbatimit të planin të mëparshëm vjetor për menaxhimin e lëndëve. Kryetari i Gjykatës Themelore i dërgon Këshillit raport tremujor me shkrim që adreson punën e gjykatës, identifikon çfarëdo probleme me të cilat ballafaqohet gjykata, si dhe propozon hapa riparues për të adresuar probleme të tilla. Kryetari i Gjykatës, brenda rregullave dhe urdhërësive të Këshillit, do të ndërmarrë hapa të tjerë të atillë sipas nevojës për të siguruar menaxhim efektiv të gjykatës dhe burimeve të saja si dhe gjykimin e lëndëve brenda kohës. Kryetari i Gjykatës mund të kryejë delegime të përshtatshme të autoritetit.” Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

<sup>70</sup> Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Neni 4 i Ligjit për KGJK.

## • **PLANI I VEPRIMIT PËR ZGJIDHJEN E LËNDËVE TË KORRUPSIONIT**

KGJK më 25 shtator 2015 ka miratuar Planin e Veprimit për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit. IKD<sup>71</sup> në bashkëpunim me KGJK-në kishin propozuar draft planin për zgjidhjen e rasteve të korrupsionit, i cili plan me ndryshime dhe plotësime ishte miratuar nga KGJK.

Përmes këtij plani KGJK prezanton situatën e përgjithshme, dobësitë e tanishme me rastin e trajtimit të lëndëve të korrupsionit, identifikimin dhe ndarjen e lëndëve. Gjithashtu plani ka përcaktuar aktivitete konkrete dhe afate kohore praktike për rritjen e aktivitetit të trajtimit të lëndëve të korrupsionit. Përmes këtij plani është paraparë themelimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Planit, kompetencat e të cilit janë të kufizuara vetëm sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të Planit të Veprimit dhe në asnjë lëndë nuk do të diskutojnë apo ndërhyjnë lidhur me meritën e rastit apo personave që janë subjekt të procedurave gjyqësore, por do të kufizohen vetëm në zbatimin e afateve ligjore, duke respektuar standardet më të larta të pavarësisë së gjykatësve.

Ky plan i veprimit kishte paraparë edhe afate kohore lidhur me vlerësimin e zbatimit të planit. Vlerësimi i parë i zbatimit të planit do të duhej të bëhej në muajin nëntor të vitit 2015, përderisa vlerësimi i dytë në janar të vitit 2016. Edhe përkundër obligimeve të përcaktuara me këtë Plan të veprimit, KGJK ka dështuar të realizoj obligimet e saj të vlerësimit sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit.

Po ashtu, gjatë raportimit të Kryetarëve të Gjykatave Themelore para KGJK-së, nuk është raportuar lidhur me zbatimin e këtij plani, sikurse ka munguar diskutimi apo pyetjet nga anëtarët e KGJK-së lidhur me zbatimin e këtij plani në praktikë nga Gjykatat Themelore.

### **b) Pjesëmarrja dhe diskutimi i anëtarëve të KGJK-së në takime**

KGJK gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit 2015, ka mbajtur tre takime. Në të gjitha takimet e KGJK-së kanë marrë pjesë 10 anëtarë nga 11 anëtarë aktual të emëruar në KGJK, përveç takimit të datës 18 nëntor 2016, ku ka munguar Gjimshit Gaushi. Në të gjitha takimet e KGJK-së ka munguar anëtari Salih Mekaj i cili është suspenduar si rezultat i masës disiplinore të shqiptuar nga KGJK.

Në bazë të Ligjit për KGJK, kuorumi i Këshillit formohet me nëntë (9) anëtarë, dhe vendimet e Këshillit merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse ligji parasheh ndryshe.<sup>72</sup>

IKD gjatë monitorimit të takimeve të KGJK-së, njëjtë sikurse të rasti i KPK-së ka vërejtur mungesën e debatit në mes të gjithë anëtarëve të KPK-së lidhur me pikat që kanë qenë pjesë e diskutimit. Edhe në KGJK, një numër i kufizuar i anëtarëve të Këshillit kanë marr pjesë aktive në takime të Këshillit, përmes vërejtjeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve lidhur me politikat, strategjitë dhe vendimet e diskutuara dhe miratuara në Këshill, përderisa një numër i madh i anëtarëve kanë qenë pasiv, duke marr pjesë vetëm gjatë procesit të votimit. Kjo qasje duket të jetë jo edhe aq e duhur për një organ i cili i përcakton dhe mbron politikat e sistemit gjyqësor.

---

<sup>71</sup> *Shënim:* Me iniciativë të IKD-së për zbatimin e rekomandimeve të publikuara në raportet analitike që ndërlidhen me trajtimin efikas dhe efektiv të rasteve të korrupsionit nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial, IKD ka mbajtur takime me Kryesuesin e KGJK-së, z. Enver Peci, i cili ka shprehur vullnetin për bashkëpunim për hartimin e Planit të Veprimit për Zgjidhjen e Rasteve të Korrupsionit. IKD ka hartuar draftin e këtij Planit, i cili me ndryshimet dhe plotësimet e KGJK-së është miratuar më 25 shtator 2015. "Plani i Veprimit për Zgjidhjen e Rasteve të Korrupsionit". Këshilli Gjyqësor i Kosovës. 25 shtator 2015.

<sup>72</sup> Neni 14 pika 4. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2713>), (qasur për herë të fundit më 16 mars 2016).



IKD gjatë monitorimit të këtyre takimeve, ka analizuar dhe llogaritur kohën që çdo anëtarë i Këshillit ka marr pjesë në diskutim për çdo pikë të rendit të ditës. Përderisa, në shume pika të rendit të ditës pothuajse nuk ka pasur fare diskutim, ku janë miratuar rregullore, raporte të punës së Gjykatave Themelore, dhe ku janë marrë vendime të rëndësishme për funksionimin e sistemit gjyqësor të Kosovës.

Në takimin e 141 të datës 18 nëntor 2015, para KGJK ka raportuar U.D. së Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Ali Kutllovci, i cili gjatë raportimit ka informuar anëtarët e KGJK-së, se “në këtë gjykatë janë 1719 lëndë penale në pjesën veriore që nuk janë prekur fare, dhe 1254 lëndë civile. Ka pasur 686 lëndë të Departamentit të Krimeve të Rënda që nuk i'u kanë ndarë asnjëherë gjykatësve, dhe më 12.11.2015, ky personalisht i ka shpërndarë ato lëndë dhe tani nuk ka më asnjë të tillë në sirtarë”. Gjatë raportimit ka shprehur shqetësimin që në këtë gjykatë janë në mungesë të 30 gjykatësve, nëse krahasohet me numrin e popullsisë. Prandaj, ka kërkuar nga KGJK plotësimin e pozitave të gjykatësve dhe bashkëpunëtorëve profesional. Kutllovci ka theksuar se ka probleme të shumta edhe më çështjen e sekuestrimit dhe konfiskimit. Sipas tij, gjykatësit në Mitrovicë janë para një gjendje të keqe, dhe ekziston rreziku që mund të largohen të gjithë. Kutllovci gjithashtu ka kërkuar nga KGJK që së paku të vizitojnë një herë apo dy herë në vit, për të parë nga afër gjendjen e tyre.

Pas raportimit të të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, anëtarët e KGJK-së, Enver Peci, Agim Maliqi, Valdete Daka dhe Asllan Krasniqi, kanë diskutuar lidhur me raportin e paraqitur, i cili diskutim ndërlidhet kryesisht lidhur me aspektin statistikor të lëndëve që janë kryer në këtë Gjykatë dhe Degët e saj. Ndër të tjera anëtarët e tjerë të KGJK-së nuk marrin fare pjesë në diskutim lidhur me raportin e prezentuar. U.D. Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, nuk mori përgjigje lidhur me problemet dhe sfidat e paraqitura në raport për vitin 2014 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2015.

Para KGJK-së në këtë takim ka raportuar edhe Zyhdi Haziri, Kryetar i Gjykatës Themelore në Gjilan. Ai ka theksuar se në raport me vitin 2014, në vitin 2015 kanë një efikasitet më të madh të punës. Kjo marrë parasysh edhe faktin se, në vitin 2014 kanë qenë gjithësej 31 gjykatës në të gjitha Degët e Gjilanit, që i bie gjashtë gjykatës më pak se që duhet të kishin (37), por në vitin 2015 kanë ardhur edhe dy gjykatës, të cilët e kanë zbutur situatën. Megjithatë, Haziri ka kërkuar nga KGJK që të plotësohet edhe numri tjetër i gjykatësve, pasi janë në mungesë të katër apo pesë prej tyre. Përveç kësaj, Haziri kërkon nga KGJK që do të ishte mirë, dhe do të ndikonte pozitivisht edhe te gjykatësit edhe të administrata nëse mbledhjet për raportet vjetore të shqyrtuara për Kryetarë të mbaheshin në regjionin për të cilin raportohet.

Lidhur me raportin e prezentuar nga Kryetari i Zyhdi Haziri, ka munguar pothuajse tërësisht debati dhe diskutimi nga anëtarët e KGJK-së. Kryetari nuk është sfiduar me pyetje apo sqarime lidhur me administrimin dhe funksionimin e kësaj gjykate. Vetëm Enver Peci dhe Nebojsa Boricic, marrin pjesë në diskutim. Asnjë anëtar tjetër i KGJK-së nuk diskuton lidhur me raportin.

Në këtë takim ka raportuar edhe Elmaze Syka, Kryetare në Gjykatën Themelore në Pejë. Gjatë kësaj periudhe kjo gjykatë, sipas saj, ka treguar një efikasitet në punë. Megjithatë, ka ngritur shqetësimin për mungesën e gjykatësve, pasi që nga fillimi i vitit 2014, 10 gjykatës kanë qenë jashtë procesit të punës, dhe vetëm pas një viti janë plotësuar vetëm pesë pozita. Por, problemi më i madh qëndron në Degën në Klinës, ku përveç Mbikëqyrësit të Degës, tani nuk ka asnjë gjykatës, ndërkaq numri i lëndëve atje është i madh. Syka gjithashtu ka përmendur faktin se bojkoti 40 ditor i gjykatësve ka ndikuar në punën e tyre, sepse mbi 700 lëndë janë shtyrë, dhe për këtë e fajëson KGJK-në që kanë qëndruar indiferent.

Të vetmit anëtarë të KGJK-së që kanë debatuar lidhur me raportin e Kryetares Syka janë Kryesuesi Enver Peci dhe Valdete Daka. Kryesuesi thekson se duhet të rriten edhe pak kapacitetet me numrin e gjykatësve, por megjithatë gjendja në këtë gjykatë ka konsideruar se është e përballueshme. Përderisa, asnjë anëtarë tjetër i KGJK-së nuk ka marrë pjesë fare në debat apo diskutim lidhur me raportin e prezentuar.

KGJK edhe përkundër faktit se ka marrë vendime me shkrim lidhur me raportet e Kryetarëve të Gjykatave Themelore në Mitrovicë, Gjilan dhe Pejë, votimi formal nga anëtarët e KGJK-së nuk ka ndodhur.

Pikë tjetër e rendit të ditës në këtë takim ishte edhe shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullores për ndryshimin e Rregullores 02/2015 për Përzgjedhjen e Anëtarëve të KGJK-së nga gjyqësori. Edhe në këtë pikë një numër shumë i kufizuar i anëtarëve të KGJK-së marrin pjesë lidhur me tekstin e rregullores, përderisa shumica e anëtarëve fare nuk diskutojnë.

Në takimin e 142 të datës 2 dhjetor 2015, ka raportuar Kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Hamdi Ibrahim, i cili ka prezentuar raportin e punës për vitin 2014. Sipas tij, sfida do të mbetet çështja e trajtimit të lëndëve të vjetra. Çështje tjetër ka qenë edhe puna dhe ngarkesa me lëndë, mungesa e gjykatësve, niveli i punës dhe kualiteti në Departamentin për Krime të Rënda. Si çështje limituese ka përmendur mënyrën se si është rregulluar me ligj përbërja e trupave gjyqësore në Departamentin e Krimeve të Rënda. Si problem tjetër ka përmendur Ligjin për Konfliktet Administrative, i cili cakton një afat kohor prej 90 ditësh për shqyrtimin e një çështje, një afat i cili nuk mjafton që të kryhet një lëndë sepse numri i tyre po rritet gjithnjë. Ibrahim ka adresuar çështjen e kushteve jo të mira në objektin A dhe D të Pallatit të Drejtësisë, siç janë ngrohja dhe mungesa e oksigjenit. Ai ka propozuar që KGJK të hartoj politika më të sakta, më të lehta, të vlerësimit të punës së gjykatësve dhe vlerësimi mos të bëhet vetëm në bazë të numrit të lëndëve të kryera.

Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës Themelore në Prizren, ka prezentuar raportin e punës në Gjykatën Themelore në Prizren, ku sipas tij ka pasur një zvogëlim të numrit të lëndëve. Disa nga problemet që ka përmendur janë mungesa e pesë gjykatësve, problemi me përkthyes ku tregoj që pavarësisht kërkesave, nuk kanë gjetur mirëkuptim në KGJK.

Edhe në rastin e raportimit të dy Kryetarëve të Gjykatave Themelore në Prizren dhe Prishtinë, numër i kufizuar i anëtarëve marrin pjesë në diskutim, ku dallohen Kryesuesi, Valdete Daka dhe Agim Maliqi.

KGJK ka diskutuar edhe lidhur me Kodin e Etikës për Gjykatës. Rreth kësaj pike Kryesuesi ka propozuar që drafti i punuar nga Komisioni për Akte Normative për këtë kod, tu dërgohet të gjithë gjykatësve në mënyrë që ata të dërgojnë komentet dhe vërejtjet e tyre dhe pastaj të aprovohet, me të cilin propozim janë pajtuar anëtarët e KGJK-së. Po ashtu është diskutuar edhe lidhur me kërkesat e gjykatësve për angazhim në procese mësimore dhe miratimin e Rregullores për Bordin e Projektit SMIL. Të dy këto pika janë shtyrë për takimet e radhës.

Në takimin e 143, të mbajtur më 16 dhjetor 2015, KGJK kishte diskutuar lidhur me Raportin e Progresit dhe të gjeturat e këtij raporti që i përkasin gjyqësorit. Në këtë pikë të rendit të ditës kërkohet që të krijohen mekanizma brenda sistemit gjyqësor për të ngritur llogaridhënien dhe transparencën në gjyqësor, reduktimin e lëndëve të vjetra, dhe rritjen e buxhetit për gjyqësorin.

Pikë e rendit të ditës në këtë takim ishte edhe raporti i zbatimit të planit strategjik, ku përveç anëtarit Agim Maliqi, asnjë anëtarë tjetër i Këshillit nuk diskuton lidhur me këtë pikë. Të gjithë anëtarët pajtohen që për këtë çështje nuk ka nevojë të votohet fare.

Në këtë takim u diskutua po ashtu edhe lidhur me Planin e Punës së Komisionit për lëndët e korrupsionit. Kryesuesi Peci ka theksuar se qëllimi është që të bëhet një harmonizim i të dhënave statistikore, sepse ka probleme, dhe të nxirret një pasqyrë e qartë e rasteve. Peci thekson se Plani Strategjik e ka të paraparë se çka duhet të raportohet, dhe se Kryetarët e Gjykatave nuk janë duke i'u përmbajtur atij plani. Prandaj konsideron se në të ardhmen duhet që në mënyrë strikte t'u përmbahen kërkesave të KGJK-së.

### **c) Transparenca e KGJK-së në publikimin e rregulloreve, strategjive, raporteve dhe vendimeve**

KGJK gjatë muajit nëntor ka miratuar dhe publikuar:

- Rregulloren për ndryshimin e Rregullores 02/2015 për Përzgjedhjen e Anëtarëve të KGJK-së nga gjyqësori;
- Rregulloren për Emërimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësor;
- Rregulloren për Emërimin e Ekspertëve Ligjor; dhe
- Ndryshimin e UA 01/2015 për zbatim të vendimit të KGJK për bartje të përgjegjësive nga SKGJK në Gjykata.

KGJK nuk ka publikuar raportet, por ka publikuar vendimet lidhur me:

- Raportimi i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë
- Raportimi i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjiilan
- Raportimi i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë
- Raportimi i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren
- Raportimi i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë

Vendimet tjera të publikuara në uebfaqen e KGJK-së për këtë periudhë janë:

- Burim Emerllahu, gjykatës në Gjykatën Themelore në Gjiilan për transferim në Gjykatën Themelore në Ferizaj
- Venhar Salihu, gjykatës në Gjykatën Themelore në Ferizaj transferohet në Gjykatën Themelore në Gjiilan.
- Manushe Karaçi dhe Hajrije Shala propozohen të emërohen gjykatëse në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme; dhe
- Vendimi për bartjen e përgjegjësive nga SKGJK në Gjykata.

KGJK nuk ka publikuar Raportet e Punës së Gjykatave Themelore në Mitrovicë, Gjiilan, Pejë, Prizren dhe Prishtinë.

KGJK ka përkthyer dhe ka publikuar pothuajse të gjitha rregulloret e miratuara në gjuhën serbe, përveç Rregulloren për Ndryshimin e Rregullores 02/2015 për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit nga gjyqësori.

KGJK nuk ka përkthyer dhe publikuar në gjuhën serbe, asnjë vendim që është miratuar nga KGJK në muajin nëntor dhe dhjetor 2015.<sup>73</sup>

## VI. OBLIGIMET E KPK LIDHUR ME ZBATIMIN E LIGJEVE TË PLOTËSUARA PËR KPK DHE PSH

Neni 19 i Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, përcakton se nenet 3,4,8 dhe 10 të këtij ligji hyjnë në fuqi me datë 1 janar 2016. Përderisa pjesa tjetër e ligjit hyjnë në fuqi 15 ditë pas publikimit në gazetën zyrtare.

Sfidë për KPK është paraqitur periudha e shkurtër kohore për ndërmarrjen e veprimeve dhe aktiviteteve për implementimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me përbërjen e re të KPK-së dhe me kalimin e Sekretariatit nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në KPK. Një ndër mangësitë e ligjit të ndryshuar për KPK, paraqitet mungesa e dispozitave kalimtare lidhur me mandatin e anëtarëve aktual të KPK-së, qoftë nga radhët e anëtarëve prokurorë apo jo prokurorë, por që në të njëjtën kohë ushtrojnë edhe funksionin e Kryeprokurorit të Prokurorive përkatëse, me përjashtim të Kryeprokurorit të Shtetit, i cili me ligj është përcaktuar se shërben si anëtar i KPK-së, sipas detyrës zyrtare. Kjo mungesë ka shkaktuar polarizime dhe probleme të theksuara në praktikë.

Me qëllim të një tranzicioni të lehtë dhe pa pengesa, përmbushjes së obligimeve dhe zbatimin e ligjit për KPK-në më 11 shtator 2015, Këshilli kishte themeluar, një grup të madh punues<sup>74</sup> gjithëpërfshirës të përbërë nga anëtarë të KPK-së, Sekretariatit dhe prokurorë nga Prokuroritë përkatëse për hartimin dhe amandamentimin e rregulloreve të KPK-së.

Sfidë e përmbushjes së obligimeve nga ana e KPK-së, ka qenë procesi i zgjedhjes së anëtarëve të KPK-së, nga radhët e prokurorëve. Kjo ka ardhur duke pasur parasysh faktin se LKPK nuk parasheh dispozita kalimtare lidhur me mandatin e anëtarëve aktual të KPK-së, KPK nuk i ka kushtuar kujdes të shtuar të drejtave të fituara të anëtarëve aktual të Këshillit, duke mos respektuar ligjin, standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira për rastet e ngjashme.<sup>75</sup>

<sup>73</sup> *Shënim:* IKD në fokus të këtij raporti ka përfshirë publikimin dhe përkthimin e dokumenteve nga KGJK deri në fund të vitit 2015. Të dhënat në këtë raport përfshijnë vetëm përmbushjen e obligimeve deri me këtë datë.

<sup>74</sup> Vendim i Këshillit Prokurorial për Themelimin e Grupit Punues për Hartimin dhe Amandamentimin e Rregulloreve të KPK-së. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.913.2015-Vendim-Themelimi\\_i\\_Grupit\\_Punues\\_per\\_Hartimin\\_dhe\\_Amandamentimin\\_e\\_Rregulloreve\\_te\\_KPK-se.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.913.2015-Vendim-Themelimi_i_Grupit_Punues_per_Hartimin_dhe_Amandamentimin_e_Rregulloreve_te_KPK-se.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 22 mars 2016).

<sup>75</sup> *Peticioni nga Miloš Melčák, anëtar i Parlamentit, kërkon anulimin e Aktit Kushtetues nr. 195/2009, Coll., lidhur me shkurtimin e mandatit të pestë në zyrë të deputeve të dhomës.* Është një dallim thelbësor në shkurtimin e mandatit në zyrë nga Këshilli kombëtar Cek përmes aktit kushtetues nr. 64/1990 Coll, në njëren anë, dhe shkurtimin e mandatit në zyrë të dhomës së deputeteve në parlamentin Cek. Tre aktet e para kushtetuese të cituara janë aprovuar para zgjedhjeve të mbajtura dhe kuvendit të konstituar, dhe dy aktet tjera janë aprovuar më vonë. Kështu që kushtet retroaktive të përcaktuara lidhur me ushtrimin e të drejtës së votës (pasive dhe aktive) dhe prezimit në bazë të cilit voutesit kanë vendosur në zgjedhjet për dhomën e deputeteve janë ndryshuar më karakter retroaktiv. GJK konsideron se cenimi i tillë i parimeve bazë kushtetuese të jetë në kundërshtim me parimet mbi ndalimin e retroaktivitetit, në lidhje me parimet e mbrojtjes së arsyeshme të konfidencës për qytetarët në ligj dhe të drejtën për të votuar të lirë, ndër të tjera çështje, e drejta për të votuar me njohjen e kushteve për të krijuar autoritete publike demokratike që rezultojnë nga zgjedhjet, duke përfshirë njohjen e kohëzgjatjes së mandatit në zyrë. GJK konsideron se shkelja e këtyre parimeve kushtetuese që burojnë nga neni paragrafi i Kushtetutës, ndërhyrën në kriteret bazë për një shtet demokratik i qeverisur nga sundimi i ligjit, e mishëruar në nenin 9 paragrafin 2 të Kushtetutës. (Shih linkun [http://www.usoud.cz/en/decisions/?tx\\_ttnews\[tt\\_news\]=468&cHash=b239af8f32f409fe77493adf911e665f](http://www.usoud.cz/en/decisions/?tx_ttnews[tt_news]=468&cHash=b239af8f32f409fe77493adf911e665f)). (Qasur për herë të fundit më 15 janar 2016).

KPK gjatë kësaj faze kalimtare duhet të kishte bashkëpunim më Komisionin për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës, për shpalljen e pozitave të lira të anëtarëve jo prokurorë që vijnë nga radhët e OAK-ut dhe profesori universitar i drejtësisë, i cili bashkëpunim ka munguar dhe ka sjellur KPK në një situatë kur përfaësuesit nga OAK dhe Fakultetit të Drejtësisë ende nuk janë zgjedhur për anëtarë të KPK-së. Madje është shkuar aq larg ku para zgjedhjes së kryesuesit të KPK-së, gjatë muajt dhjetor emrat e kandidatëve nga OAK dhe profesorët e Fakultetëve Juridike i janë dorëzuar KPK-së në vend se ato ti dorëzoheshin Kuvendit të Kosovës.

Po ashtu KPK gjatë fazës kalimtare në pajtim me obligimet që dalin nga neni 5 i ri i ligjit dhe neni 19 paragrafi 2, duhet të hartojë rregulloret dhe dokumentet tjera lidhur me themelimin dhe funksionalizimin e Komisionit për Administrimin e Prokurorive, nga data 1 janar 2016.

Në mesin e këtyre sfidave një sfidë tjetër e KPK-së ka qenë edhe transferimi i Sekretariatit nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në KPK. Duke pasur parasysh së Sekretariati i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, përbën një numër të madh të zyrave dhe personelit, ka qenë e domosdoshme që të plotësohen dhe ndryshohen një numër i madh i rregulloreve që mbulojnë dhe rregullojnë funksionimin e Sekretariatit, si rregulloret për: Funksionimin dhe Veprimtarinë e KPK-së, dispozitat që ndërlihen me Sekretariatit, Rregulloren për Strukturën Organizative dhe Funksionin Mbështetës Administrativ të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. KPK ende nuk ka kryer një obligim të tillë, dhe ende funksionon me rregulloret e vjetra. Edhe përkundër faktit se KPK ka qenë e detyruar të transferoj Sekretariatit nga Zyra e Kryepokurorit të Shtetit në KPK, kjo ende nuk ka ndodhur edhe në muajin prill të vitit 2016. KPK ende funksionon me rregullore të vjetër që rregullon veprimtarinë e Sekretariatit të ZKPSH, edhe pse nga 1 janari 2016, Ligji për KPK ka paraparë që Sekretariati të veproj në kuadër të KPK-së. KPK përmes keqmenaxhimit ka ardhur në pozitë që një institucion kaq i rëndësishëm si është Sekretariati i KPK-së të veproj dhe funksionoj në kundërshtim me ligj. Andaj KPK duhet urgjentisht që këtë çështje ta adresoj dhe të mos vazhdoj me shkelje të ligjit mbi të cilin edhe vetë është themeluar.

Po ashtu KPK tek në muajin dhjetor të vitit 2015, ka miratuar Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Prokurorive, e cila rregullore ka filluar së zbatuari prej 15 janarit 2016. Miratimi i kësaj rregulloreje, ka qenë një ndër obligimet bazë për sistemin prokurorial, duke pasur parasysh se kjo rregullore është bazament për funksionimin dhe administrimin efikas të prokurorive në të gjitha nivelet.

Sfidë kryesore për sistemin prokurorial por edhe atë gjyqësor, mbetet zbatimi i dispozitave ligjore lidhur me rekrutimin dhe procesin e emërimit të prokurorëve dhe gjykatësve. Në fakt, ky ka qenë edhe kriter për Liberalizim të Vizave dhe si e gjetur në Raportin e Progresit të KE-së për Kosovën për vitin 2014, ku ndër të tjera ishte edhe harmonizimi i dispozitave ligjore lidhur me rekrutimin dhe propozimin për emërim të gjykatësve dhe prokurorëve.

Duke pasur parasysh këtë, KGJK dhe KPK në pajtim me obligimet dhe ndryshimet ligjore nga nenet 7 dhe 8, është paraparë që të hartojnë dhe miratojnë rregullore të veçanta lidhur me provimin hyrës për gjykatës dhe prokurorë. Këto rregullore duhet të jenë të harmonizuara në mes të dy Këshillave gjithmonë duke marr parasysh specifikat për gjykatës dhe prokurorë, dhe të cilat duhet të përcaktojnë kritere, kushte dhe procedura të qarta. Për më tepër, kjo paraqet sfide shtesë për dy Këshillat për zbatimin e tyre, sepse një kompetencë e tillë, deri më tani ishte zbatuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës.

Ligji i ri, ka bërë ndryshime rrënjësore edhe sa i përket kritereve që duhet plotësuar kandidatët që aplikojnë për pozitën e prokurorit, andaj në pajtim me këtë, KPK ka miratuar plotësim ndryshimin e Rregullores për Procesin e Rekrutimit, Emërimit dhe Ri-emërimit të Prokurorëve.

## VII. MIRATIMI I LEGJISLACIONIT SEKONDAR DHE POLITIKAVE NGA KPK

KPK gjatë vitit 2015 është përcjellur me shumë polemika dhe paqartësi lidhur me mandatin ligjor të tre anëtarëve KPK-së, respektivisht mandatin e znj. Sevdije Morina, anëtare e KPK-së nga PSRK, z. Jetish Maloku, anëtar i KPK-së nga Prokuroritë Themelore, dhe z. Bajram Uka, anëtar jo prokuror nga Fakultetet Juridike. Përderisa, më 8 mars 2010, znj. Morina ishte emëruar anëtare në atë kohë e KGJK-së dhe njëkohësisht anëtare e Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP), gjatë muajit mars 2011, znj. Morina ishte transferuar si anëtare në KPK të themeluar rishtazi, sipas nenit 43 të Ligjit për KPK, i cili kishte hyrë në fuqi më 1 Janar 2011. Përderisa, z. Maloku më 15 korrik 2010, ishte emëruar anëtar në atë kohë i KGJK-së dhe njëkohësisht anëtare e KPGJP-së. Njëjtë edhe z. Maloku ishte transferuar si anëtar në KPK të themeluar rishtazi, sipas nenit 43 të Ligjit për KPK, i cili ka hyrë në fuqi më 1 Janar 2011. Ligji mbi KPK ka paraparë që mandati i anëtarëve të KPK-së, është pesë vjeçar pa mundësi vazhdimi. Lidhur me mandatet e anëtarëve të lartëpërmendur të KPK-së, kishin dhënë opinion edhe përfaqësuesit ndërkombëtar që mbështesin KPK, të cilët kishin ardhur në përfundim se mandati i anëtarëve prokuror nuk mund të kalojë mandatin pesë vjeçar të përcaktuar me ligj.<sup>76</sup>

Edhe përkundër rekomandimeve të këshilltarëve ndërkombëtarë<sup>77</sup> që mbështesin KPK, i njëjti Këshill kishte vendosur që anëtarëve jo prokurorë të iu vazhdojë mandatin në mënyrë të kundërligjshme znj. Morina dhe z. Maloku deri në fund të vitit 2015.

Përderisa këshilltarët ndërkombëtar të EULEX-it që mbështesin KPK, kanë pasur qëndrim tjetër nga këshilltarët tjerë ndërkombëtarë dhe kanë rekomanduar vazhdimin e mandatit për znj. Morina dhe Z. Maloku deri në vitin 2016. Rekomandimi i EULEX-it dhe vazhdimi në mënyrë të kundërligjshme i mandatit të dy anëtarëve të KPK-së ishte diskutuar edhe në takimin e pestë plenar lidhur me Marrëveshjen për Stabilizim Associm mes Kosovës dhe BE-së, të mbajtur më 8 korrik 2015. Në këtë takim, z. Jean-Eric Paquet, Drejtor për Ballkanin Perëndimor të Komisionit Evropian është shprehur lidhur me zbatimin e pakos së ligjeve, duke theksuar: *“Ne mirëpresin miratimin e katër ligjeve që dalin nga Pakoja e gjyqësorit. Miratimi i legjislacionit është vetëm hapi i parë i ndryshimit të sistemit apo strukturës. Kosova tani ka nevojë të fokusohet në zbatimin rigoroz dhe të përshtatshëm të këtyre ligjeve”*. Z. Paquet ka ngritur shqetësimin lidhur me bazën ligjore të mandateve të disa anëtarëve të KPK-së.

KPK gjatë vendosjes së vazhdimit të mandatit të anëtarëve të kontestuar po ashtu kishte vepruar në kundërshtim me praktikat dhe standardet ndërkombëtare. Gjatë vazhdimit të mandatit të këtyre

<sup>76</sup>Shënim: Këshilltarët ndërkombëtarë të projektit të Bashkimit Evropian që mbështesin Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, në opinionine tyre lidhur me mandatin e anëtarëve prokurorë në KPK, kishin ardhur në përfundim se *“pas analizimit të të gjitha fakteve relevante dhe kornizës ligjore të zbatueshme, Ekipi i Projektit nuk gjenë argumente të mjaftueshme për të mbështetur ligjshmërinë e lejimit të mandatit shtesë njëvjeçar të kërkuar, për njërin nga anëtarët aktual të KPK të transferuar nga KGJK/KPGJP – Znj. Morina apo Z. Maloku”*.

<sup>77</sup>Shënim: Analiza e Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara lidhur me mandatet e anëtarëve prokurorë kishte këshilluar KPK-në se *“mandati i të dy anëtarëve të Këshillit nga KPGJP duhet të skadojë në mars 2015. Kjo paraqet skadimin e natyrshëm të mandatit të anëtarit të parë të emëruar. Pasi që të dyja mandatet fillojnë më emëruarin e parë atëherë edhe do të përfundojnë me skadimin e mandatit të të emëruarit të parë, dhe të dy mandatet duhet të përfundojnë në mars 2015”*. (Ligji mbi përbërjen e përkohshme të KGJK-së, neni 7, paragrafi 1).

anëtarëve të njëjtit kishin marr pjesë në procesin e diskutimit dhe votimit për të vazhduar mandatin e tyre. Ky veprim nga ana e anëtarëve të KPK-së ishte në kundërshtim me rekomandimin e këshilltarëve ndërkombëtarë që mbështesin KPK.<sup>78</sup> Anëtarët e KPK-së për të cilët ishte diskutuar zgjatja e mandatit kishin marr pjesë në diskutim dhe kishin mundësuar kuorumin për zgjatje të mandatit. IKD vlerëson se një veprim i tillë duhet të shqyrtohet nëse është shkelur Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Anëtarëve të KPK-së apo nëse është konsumuar vepra penale e konfliktit të interesit, e cila asnjëherë nuk është trajtuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit dhe vetë organet e Prokurorisë.

KPK deri në fund të vitit 2015, me përbërje të kontestuar dhe me mandate të kundërligjshme të anëtarëve të KPK-së, kishte miratuar rregullore, vendime dhe dokumente tjera të cilat në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën ishin kontestuar, pasi që të njëjtat ishin marr në kundërshtim me hierarkinë e akteve normative në Kosovë.<sup>79</sup>

Vendimet e miratuara nga KPK me përbërje të kundërligjshme, mund të jenë subjekt i procedurave gjyqësore, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese në rastet e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Situatë e njëjtë lidhur me mandatin e kundërligjshëm të anëtarëve të KPK-së, ka ndodhur edhe në Këshillin Gjyqësor të Serbisë, ku në rastin e njohur si “Rasti Saveljić”, ku në bazë të ankesës së paraqitur në Gjykatën Kushtetuese të Serbisë, kjo Gjykatë kishte vendosur lidhur me mandatin e një anëtari të Këshillit Gjyqësor.

Gjykata kishte gjetur se gjatë konstituimit të këtij Këshilli kishte pasur shkelje ligjore, me ç’rast Gjykata Kushtetuese kishte prishur vendimin e Këshillit Gjyqësor të Serbisë të datës 25 dhjetor 2009, sikurse kishte hapur mundësinë që individualisht çdo gjykatës që do të ketë konsideruar se ka qenë i afektuar nga përbërja e kundërligjshme e Këshillit Gjyqësor, të ushtrojë ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese.<sup>80</sup>

---

<sup>78</sup>“Si përfundim, janë konflikte të qarta të interesit që duhen adresuar para zhvillimit të diskutimit dhe votimit. Së pari, asnjëri anëtar i KPK-së, mandati i të cilit është në pyetje nuk duhet të shërbejë në grup punues për pregatitjen e analizës ligjore për dorëzim në Këshill. E dyta, asnjë anëtarë, mandati i të cilit është në pyetje nuk duhet lejuar të marrë pjesë në asnjë diskutim dhe votim mbi mandatin e tyre. Me qëllim të ruajtjes së kuorimit për shqyrtimin dhe votimin final, dy çështjet duhen trajtuar si të ndara. Për mandatin e prokurorëve, asnjëri nga të dy nuk duhet të lejohet të marrë pjesë në diskutim dhe votim.” Analiza e Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara.

<sup>79</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015. Faqe 13. (Shih linkun <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/4eb17bf0-695f-4a4b-bce6-101e66ba55c9/Raporti-per-Kosoven-2015.aspx>). (Qasur për herë të fundit më 22 mars 2016).

<sup>80</sup>Komunikatë për media nga Gjykata Kushtetuese e Serbisë: Me rastin e deklaratës së Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, Nate Mesarović, e cila në ditët e kaluara ka deklaruar në media, në të cilën, thuhet se „Gjykata Kushtetuese e Republikës së Serbisë në mendimin se nuk është plotësuar përbërja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk ndikon në ligjshmërinë e punës, sepse ligji ka përcaktuar se vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor merren me shumicë të votave“ dhe përfundimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor se seancat nga 16 janari 2012 „për shkak se Këshilli i paplotësuar nuk mund të vë në pyetje ligjshmërinë e punës dhe vendimmarrjes“, që e ka vlerësuar edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin numër: VIII U-102/2010 të 28 majit 2010 me të cilin është vendosur në ankesën e gjykatësit të sapozgjedhur Zorana Saveljića“, me qëllim të informimit të plotë, Gjykata Kushtetuese e Serbisë, informon publikun si në vijim: Gjykata Kushtetuese më 28 maj 2010 ka pranuar ankesën e z. Saveljić, dhe ka prishur vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të 25 dhjetorit 2009, në pjesën të cilën gjykatësit i kanë pushuar funksionet gjyqësore. Gjykata Kushtetuese në atë vendim ka sqaruar ekskluzivisht me pyetjen e konstituimit të përbërjes së parë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, lidhur me pyetjen e ligjshmërisë dhe legjitimitetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të tanishëm, Gjykata Kushtetuese deri më tani nuk është deklaruar, vetëm se këtë do ta bëjë, përmes vendimeve të saj në çështjet sipas ankesave të gjykatësve ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. (Shih linkun [http://www.ustavni.sud.rs/page/view/sr-Latn-CS/0-101537/saopstenje-za-javnost?\\_qs=Nate](http://www.ustavni.sud.rs/page/view/sr-Latn-CS/0-101537/saopstenje-za-javnost?_qs=Nate)). (Qasur për herë të fundit më 15 mars 2016).

Njëjtë sikurse në KGJK, procesi i hartimit dhe miratimit të politikave dhe legjislacionit sekondar nga KPK ka qenë dhe mbetet sfidë e vazhdueshme, në aspektin cilësor dhe sasior por edhe aspektet tjera. Edhe KPK vuan nga mungesa e transparencës në lidhje me vendimmarrjen në hartimin e këtij legjislacioni.

IKD gjatë procesit të hulumtimit, ka vërejtur se mungon transparenca në përpilimin e akteve nënligjore, përcaktimit të agjendës së legjislacionit sekondar dhe pjesëmarrja e grupeve të interesit në këtë proces si dhe diskutimet me publikun. Një problem tjetër janë edhe zvarritjet në miratim të akteve nënligjore që nënkupton neglizhencë të KPK-së dhe mungesë të vullnetit që të zbatohen dispozitat ligjore. Ndër të tjera kjo neglizhencë i ka kushtuar KPK-së me komplikime praktike të shumë proceseve që varen nga këto rregullore dhe akte të tjera nënligjore.<sup>81</sup>

### a) Rregulloret

IKD në vazhdim ka analizuar disa prej akteve nënligjore, të cilat janë miratuar në nëntor dhe dhjetor 2015. Gjetjet e IKD-së tregojnë se disa prej akteve të miratuara janë në kundërshtim me ligjet, praktikatat dhe standardet ndërkombëtare.

#### • RREGULLORE PËR KOMISIONIN PËR ÇËSHTJE NORMATIVE

Ligji i plotësuar i KPK-së përmes nenit 8A, ka përcaktuar në mënyrë taksative se Këshilli ka Komisionet e Përhershme, ku hyn edhe Komisioni për Çështje Normative. Po ashtu dispozitat e ligjit bazik kishin paraparë themelimin e Komisioneve, të cilat Këshilli i konsideron të nevojshme.<sup>82</sup> Deri në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të KPK-së, Komisioni për Çështje Normative, ishte themeluar më 4 mars 2013 dhe kishte funksionuar vetëm në bazë të nenit 26 të Rregullores për Funksionimin dhe Veprimtarinë e KPK-së.

KPK në takimin e datës 1 dhjetor 2015, ka miratuar Rregulloren për Komisionin për Çështje Normative, përmes së cilës përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij Komisioni.

Neni 5 i kësaj rregulloreje përcakton se Komisioni do të ketë së paku tre anëtarë dhe mandati i tyre është pesë (5) vite. Kryesuesi i këtij Komisioni zgjedhet nga anëtarët e Këshillit, përderisa anëtarë mund të jenë edhe prokuror. Vlen të theksohet se nuk ka pasur ndonjë debat të rëndësishëm në lidhje me miratimin e kësaj rregullore, madje është diskutuar që të gjitha Komisionet e Përhershme të KPK-së të përfshihen në një rregullore, kjo për shkaqe edhe të zbatimit praktik.<sup>83</sup>

#### • RREGULLORE PËR NDARJEN E LËNDËVE

Ligji i plotësuar për Prokurorin e Shtetit ka përcaktuar që KPK brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të miratojë Rregulloren për Ndarjen e Lëndëve nëpër prokurori sipas sistemit të rastësisë. Në këtë drejtim, KPK më 1 dhjetor 2015, ka miratuar Rregulloren për Ndarjen e Lëndëve<sup>84</sup>, me qëllim të rregullimit të sistemit të ndarjes së lëndëve në institucionin e Prokurorit të Shtetit, obligim ky për të gjithë Kryeprokurorët, prokurorët dhe personelin mbështetës. Pritet që kjo rregullore të lehtësojë këtë

<sup>81</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015. Faqe 13. (Shih linkun [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 15 mars 2016).

<sup>82</sup> Neni 4 paragrafi 1.26. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës. (Shih linkun [http://www.md-ks.net/repository/docs/Ligji\\_per\\_keshillin\\_prokuroral.pdf](http://www.md-ks.net/repository/docs/Ligji_per_keshillin_prokuroral.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 20 janar 2016).

<sup>83</sup> IKD intervistë me z. Florent Muçaj, anëtar jo prokuror i KPK-së nga radhët e shoqërisë civile. Dhjetor 2015.

<sup>84</sup> Rregullore për Ndarjen e Lëndëve. Miratuar më 1 dhjetor 2015. Këshilli Prokurorial i Kosovës. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1357.2015-Rregullore\\_NR.06.2015-Per\\_ndarjen\\_e\\_lendeve.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1357.2015-Rregullore_NR.06.2015-Per_ndarjen_e_lendeve.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).



proces në praktikë, i cili deri më tani madje ka penguar edhe punën efikase në menaxhimin më të mirë dhe më efikas të prokurorive si dhe efikasitetin e prokurorëve.<sup>85</sup>

## • RREGULLORE PËR EMËRIMIN E KRYEPROKURORËVE

Konkluzionet nga takimi sektorial për drejtësi, liri dhe siguri lidhur me procesin e stabilizimit asociativ mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian, i mbajtur në Bruksel më 27-29 janar 2015, kishin paraparë një varg kushtesh që Kosova duhej të plotësonte, deri në qershor të vitit 2015.<sup>86</sup> Një ndër kushtet që KPK duhej të plotësonte ishte emërimi i Kryeprokurorit të PSRK-së. Rrjedhimisht, procesit të emërimit të Kryeprokurorit të kësaj prokurorie duhej të i paraprinte hartimi dhe miratimi i Rregullore për Procesin e Emërimit të Kryeprokurorëve. Edhe përkundër kësaj, KPK ka dështuar që këtë obligim ta realizoj brenda vitit 2015, pasi nuk ka arritur të zgjedhë Kryeprokurorin e PSRK-së dhe Prokurorisë së Apelit, përderisa, Rregulloren që përcakton procedurat, kriteret dhe mënyrën e përzgjedhjes dhe procesin e emërimit të Kryeprokurorit të PSRK-së, Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore ka arritur ta miratojë në dhjetor 2015-të.

Përmes Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2014, është paraparë që kompetencat lidhur me menaxhimin dhe administrimin e PSRK të kalojnë tek prokurorët vendorë, për herë të parë që nga themelimi i kësaj prokurorie. Më 30 maj 2014, KPK me Vendim ka caktuar, ish-Zëvendës/Kryeprokuroren e PSRK, znj. Sevdije Morina, për ushtruese të detyrës së Kryeprokurores së PSRK-së<sup>87</sup>, përderisa, ish-Kryeprokurori i kësaj prokurorie, z. Jonathan Rathel, është caktuar nga misioni i EULEX-it, zëvendëskryeprokuror i PSRK-së. Znj. Sevdije Morina këtë funksion e ka ushtruar deri në muajin gusht të vitit 2015, kur është avancuar në pozitën e prokurores në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Përderisa, KPK ka vazhduar me caktimin e ushtruesve të detyrës në këtë prokurori, respektivisht më 4 gusht të vitit 2015, në këtë pozitë është caktuar prokurori Reshat Millaku, i cili këtë funksion e ushtron edhe në muajin prill të vitit 2016.

KPK në takimin e datës 9 nëntor 2015, ka miratuar Rregulloren për Emërimin e Kryeprokurorëve. Përmes kësaj rregullore, Këshilli ka përcaktuar procedurat e emërimit të Kryeprokurorëve të PSRK-së, Apelit dhe Prokurorive Themelore. Duhet theksuar se kjo është bërë me një vonesë të konsiderueshme.

Përsa i përket kësaj rregulloreje në kuptim të përmbajtjes që ofron, duhet theksuar se përmes kësaj rregullore janë përcaktuar kriteret e veçanta për emërimin e Kryeprokurorëve, të cilat kritere pothuajse janë të njëjta me kriteret e veçanta për ushtrimin e funksionit të prokurorit në PSRK dhe atë të Apelit. Ligji i plotësuar për Prokurorin e Shtetit, në nenin 8 përcakton se për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Apelit, prokurori duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë si prokuror në Departamentet e Specializuara të Prokurorive Themelore apo në PSRK.

Karakteristikë e kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e lartpërmendur është që kriteret për Kryeprokuror të Apelit janë të njëjta me kriteret e përcaktuara në ligj, për të ushtruar funksionin e prokurorit në këto prokurori, që nënkupton se Kryeprokuror i Prokurorisë së Apelit duhet të ketë pesë

<sup>85</sup> IKD intervistë me z. Florent Muçaj, anëtar jo prokuror i KPK-së nga radhët e shoqërisë civile. Dhjetor 2015.

<sup>86</sup> Konkluzionet nga takimi Sektorial për Drejtësi, Liri dhe Siguri lidhur me procesin e Stabilizimit Asociativ mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian, i mbajtur në Bruksel me datë 27-29 janar 2015. (Shih linkun [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press\\_corner/2015/20150223\\_final\\_sapd\\_jls\\_follow-up\\_actions.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/2015/20150223_final_sapd_jls_follow-up_actions.pdf)).

(Qasur për herë të fundit më 15 mars 2016).

<sup>87</sup> Vendim i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Nr. 141/2014, I datës 30 maj 2014, për caktimin e U.D. së Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Vendim\\_588-2014\\_per\\_caktimin\\_e\\_Sevdije\\_Morina\\_UD\\_Kryeprokurore\\_ne\\_PSRK.PDF](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Vendim_588-2014_per_caktimin_e_Sevdije_Morina_UD_Kryeprokurore_ne_PSRK.PDF)). (Qasur për herë të fundit më 20 janar 2016).

(5) vite përvojë pune sa është edhe kriteri për të ushtruar funksionin e prokurorit në këtë prokurori. E njëjta logjikë është zbatuar edhe sa i përket kriterit për pozitën e Kryeprokurorit të PSRK-së.

Po ashtu kjo rregullore është në kundërshtim me Ligjin për Prokurorin e Shtetit, dhe standardin e aplikuar në këtë ligj, me rastin e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit. Ky ligj në nenin 8, përcakton se për të ushtruar funksionin e prokurorit të Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, duhet përvojë pune së paku shtatë (7) vite përvojë pune si prokurorë. Në anën tjetër, për t'u emëruar Kryeprokuror i Shtetit, duhet përvojë së paku tetë (8) vite si prokuror.

Kjo praktikë dhe ky standard nuk është zbatuar edhe tek kriteret për Kryeprokuror të PSRK-së dhe Apelit, duke ulur kriteret në nivel me kriterin që kërkohet për të ushtruar funksionin e prokurorit në këto prokurori, edhe përkundër faktit se Kryeprokurori sipas ligjit për Prokurorin e Shtetit, ka kompetencë dhe përgjegjësi në administrimin dhe menaxhimin e Prokurorisë në të cilën është zgjedhur.

Po ashtu, IKD ka vërejtur se titulli dhe qëllimi i kësaj rregullore nuk përkon me vetë përmbajtjen e saj. Përderisa, KPK përmes kësaj rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për emërimin e Kryeprokurorëve të Prokurorisë përkatëse, pjesë e kësaj rregullore është edhe shkarkimi apo përfundimi i parakohshëm i mandatit të Kryeprokurorëve.

Për më tepër, IKD pas analizës dhe hulumtimit të ligjit të aplikueshëm në Kosovë, vlerëson se nenet 12 dhe 13 të Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorëve<sup>88</sup> janë në kundërshtim me vetë Kushtetutën, ligjin për Prokurorin e Shtetit, me ligjin për KPK dhe me praktikën dhe standardet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë, duke përcaktuar kriterë dhe procedura shtesë, lidhur me përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryeprokurorit të Prokurorisë përkatëse, jashtë atyre të përcaktuara me ligj.

Neni 109 dhe 110 i Kushtetutës përcakton se emërimi dhe shkarkimi i prokurorëve duhet të bëhet vetëm në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me ligj. Po ashtu, neni 4 i ligjit të plotësuar për Prokurorin e Shtetit ka përcaktuar se emërimi dhe shkarkimi i Kryeprokurorit të PSRK-së, Apelit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorisë Themelore bëhet në pajtim me ligj. Përderisa, i njëjti ligj në nenin 20 përcakton e mandati i prokurorit përfundon me dorëheqje, shkarkim, vdekje, me arritjen e moshës së pensionimit, me humbjen e aftësisë të punës për shkaqe mjekësore të vërtetuara dhe nëse nuk ri-emërohet me mandat të përhershëm.

Ligji i plotësuar për KPK-në poashtu ka përcaktuar se vlerësimin e performancës së prokurorëve me mandat të përhershëm ku hyn edhe vlerësimi i performancës së Kryeprokurorëve. Ky vlerësim në bazë të ligjit bëhet çdo tre vite, dhe nuk parashihet vlerësim të performancës së prokurorëve apo Kryeprokurorëve me mandat të përhershëm jashtë këtij kriteri dhe procedure të përcaktuara me ligj.

Rregullorja për emërimin e Kryeprokurorëve, ka përcaktuar kriterë dhe procedura shtesë, jashtë asaj që është përcaktuar me Kushtetutë dhe ligj. Këto kriterë kanë paraparë mundësinë që një prokuror apo Kryeprokuror të shkarkohet në rastet kur dështon në kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj, kur dështon në menaxhimin e Prokurorisë të cilën e udhëheq apo kur nuk i zbaton udhëzimet dhe urdhërat e Kryeprokurorit të Shtetit të dhëna me shkrim lidhur me efikasitetin në punë, unifikimin e praktikave dhe për mosnjohimin e Kryeprokurorit të Shtetit sipas udhëzimeve të dhëna nga ai.

---

<sup>88</sup> Rregullore për Emërimin e Kryeprokurorëve. Këshilli Prokurorial i Kosovës. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1161.2015.\\_Rregullore\\_NR.03.2015\\_-\\_Per\\_Emerimin\\_e\\_Kryeprokuroreve\\_-KPK.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1161.2015._Rregullore_NR.03.2015_-_Per_Emerimin_e_Kryeprokuroreve_-KPK.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).

Po ashtu, me nenin 13 të kësaj rregulloreje është paraparë që Kryeprokurori i Shtetit drejtpërdrejt të propozoj shkarkimin e një Kryeprokurori në qoftë se plotësohen kriteret e lartpërmendura dhe të caktuara në nenin 12 të rregullores, të cilat nuk janë të përcaktuara me ligj.

Neni 12 dhe 13 të rregullores janë në kundërshtim me frymën e ligjit për KPK, i cili përcakton se Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve është kompetent për të vlerësuar performancën e prokurorëve dhe Kryeprokurorëve dhe se i njëjti Komision për punën e tij i përgjigjet vetëm KPK-së.

Po ashtu, plotësim ndryshimi i ligjit për KPK-në, në nenin 2 të tij, përcakton dhe i jep kompetencë KPK-së vetëm sa i përket nxjerrjes së Rregullores për procedurën e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit dhe emërimit të Kryeprokurorëve të Prokurorive. Në asnjë dispozitë të ligjit nuk është paraparë nxjerrja e Rregullores lidhur me shkarkimin apo përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryeprokurorëve të Prokurorive përkatëse, përveç rasteve kur bëhet vlerësimi i rregulltë i performancës apo në rastet e shqiptimit të masave disiplinore nga mekanizmat kompetent brenda KPK-së.

Po ashtu propozimi që Kryeprokurori i Shtetit të inicoj shkarkimin e Kryeprokurorëve të Prokurorive përkatëse bie në kundërshtim me praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtarë që për qëllim kanë ruajtjen e pavarësisë dhe mos ndikimit të jashtëm. Komisioni i Venecias në opinionin numër 712/2013, të datës 24 mars 2014, lidhur me draft ligjin për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosna dhe Herzegovinës, ka dhënë rekomandime konkrete, për të evituar mundësitë për të fuqizuar pushtetin individual të një personi apo pozite të caktuar siç është rasti i pozitës së Kryeprokurorit të Shtetit. Respektivisht ky komision ka sqaruar lidhur me nenin 53 të draft ligjit të lartpërmendur se *“problem shtesë lidhur me këtë nen është fuqizimi i Kryeprokurorit të Shtetit për të emëruar zëvendës-shëfën e Kryeprokurorëve nga radhët e prokurorëve të emëruar në zyrë dhe të cilët plotësojnë kushtet e nevojshme. Ai/Ajo pastaj njofton për vendimin KLGJP. Si duket këto emërimë janë tërësisht në duart e Kryeprokurorit të Shtetit. Në një sistem hierarkik si ai i Bosna dhe Herzegovinës, dorëzimi i fuqisë aq të madhe lidhur me emërimin, në një individ të vetëm, veçanërisht pa asnjë kusht për të konsultuar me askend tjetër, mund të ndikoj që Kryeprokurori i Shtetit të zgjedhë zëvendësit për interesin e tij dhe mungesën e pavarësisë së nevojshme për të zgjedhur prokurorët e mirë”*.<sup>89</sup>

Po ashtu në këtë opinion Komisioni i Venecias, jep sqarime dhe rekomandime konkrete edhe lidhur me procesin e vlerësimit të prokurorëve dhe gjykatësve, Kryetarëve të Gjykatave apo Kryeprokurorëve. Ndër të tjera në opinionin e tij, Komisioni i Venecias në mënyrë decisive sqaron se është e pajustificueshme që me draftligjin për KLGJP t'i lejohet Kryetarit të Gjykatës Supreme apo Kryeprokurorit të Shtetit, dhe t'i jepet fuqi për të marr vendim lidhur me nevojën për vlerësimin e performancës së Kryetarëve të Gjykatave apo Kryeprokurorëve të niveleve më të ulta. Sipas këtij opinionin nëse ka probleme konkrete në ndonjë rast konkret, duhet të filloj procedura disiplinore duke përfshirë sigurimin e garancioneve të domosdoshme.<sup>90</sup> Për më tepër, Komisioni vlerëson se kriteret

<sup>89</sup>Komisioni i Venecias në opinionin numër 712/2013, të datës 24 mars 2014, lidhur me draft ligjin për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosna dhe Herzegovinës. Faqe 16. *“Një problem shtesë është se neni 53 i draft Ligjit i jep të drejtë Kryeprokurorit për të zgjedhur zëvendës kryeprokurorët prej prokurorëve të emëruar që i kanë plotësuar kërkesat e domosdoshme. Ai ose ajo pastaj e lajmëron vendimin e KLGJP. Duket se këto emërimë janë tërësisht në duart e Kryeprokurorit. Në sistemin hierarkik sikurse ai i BeH, dhënia e aq shumë të drejtave mbi emërimin e një individi të vetëm sidomos kur një gjë e tillë bëhet pa e konsultuar askend tjetër, do të ishte model për kryeprokurorin të selektojë kandidatët e zgjedhur për shkak të përputhshmërisë së tyre dhe kanë mungesë të aftësisë së të menduarit të pavarur të domosdoshëm për një prokuror të mirë.”* (Shih linkun [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2014\)008-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2014)008-e)). (Qasur për herë të fundit më 10 shkurt 2016).

<sup>90</sup>Komisioni i Venecias në opinionin numër 712/2013, të datës 24 mars 2014, lidhur me draft ligjin për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosna dhe Herzegovinës. Faqe 17, pika 87. .” (Shih linkun

lidhur me vlerësimin duhet të jenë të caktuara në ligj, duhet të jenë transparente dhe jo dykuptimshme, të publikuara më herët, lidhur me mundësinë për të shkarkuar një gjykatës apo Kryetar Gjykatë. Çdo tejkallim i kësaj procedure do të mund të hapte mundësinë për të pasur manipulime të inicuar dhe të bazuara në baza politike dhe personale.

- **RREGULLORE PËR REKRUTIMIN, EMËRIMIN DHE RI-EMËRIMIN E PROKURORËVE TË SHTETIT**

KPK në pajtim me obligimet që kanë dalë nga ligji i plotësuar për Prokurorin e Shtetit dhe Ligjit të plotësuar për KPK më 11 dhjetor 2015, ka miratuar Rregullore për Rekrutimin, Emërimin dhe Ri-emërimin e Prokurorëve të Shtetit. Kjo rregullore në të vërtetë është plotësim i Rregullores së njëjtë e cila ishte miratuar nga KPK në shtatorin e vitit 2013.<sup>91</sup> Në këtë kuptim këtu nuk ka ndonjë risi të madhe, në kuptim të zgjidhjeve të reja.

Sfidë kryesore për sistemin prokurorial dhe atë gjyqësor, mbetet zbatimi i dispozitave ligjore lidhur me rekrutimin dhe procesin e emërimit të prokurorëve dhe gjykatësve. Kriter për Liberalizim të Vizave dhe si e gjetur në Raportin e Progresit të KE-së për Kosovën për vitin 2014, ndër të tjera ishte edhe harmonizimi i dispozitave ligjore lidhur me rekrutimin dhe propozimin për emërim të gjykatësve dhe prokurorëve.

Duke pasur parasysh këtë, KGJK dhe KPK në pajtim me obligimet dhe ndryshimet ligjore nga nenet 7 dhe 8, duhet të hartojnë rregullore të veçanta lidhur me provimin hyrës për gjykatës dhe prokurorë. Këto rregullore duhet të jenë të harmonizuara në mes të dy Këshillave, gjithmonë duke marr parasysh specifikat për gjykatës dhe prokurorë, dhe të cilat duhet të përcaktojnë kritere, kushte dhe procedura të qarta, dhe të harmonizuara. Për më tepër, kjo paraqet sfidë shtesë për dy Këshillat, sepse një kompetencë e tillë, deri më tani ishte zbatuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës.

Një ndër kritikata e vazhdueshme me të cilat është përcjellur sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial, nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, është ai që ndërlidhet me integritetin e kandidatëve të propozuar për prokuror të shtetit apo gjykatës. Po ashtu Raporti i Progresit për Kosovën në mënyrë të vazhdueshme ka kritikuar Kosovën lidhur me dërgimin e propozimeve të kandidatëve për prokuror dhe gjykatës të rinj me integritet të kontestuar.

Rregullorja e miratuar nga KPK lidhur me procesin e emërimit të prokurorëve, përmes nenit 21 të saj, në mënyrë të përgjithshme ka përcaktuar vetëm procesin e vlerësimit të integritetit personal të kandidatëve për prokurorë, duke mos sqaruar dhe përcaktuar se çka nënkuptohet me integritet personal dhe profesional, mangësi kjo e cila shkakton probleme të mëdha në praktikë.

Mungesa e kritereve të qarta të përcaktuara me ligj apo akte nënligjore, lidhur me atë se çka nënkuptohet me integritet personal, ka mbetur për të u vlerësuar vetëm nga anëtarët e<sup>92</sup> Komisionit për Rekrutim të themeluar nga KPK. Kjo në praktikë ka shkakuar situata kur Komisioni për Rekrutim i ka propozuar KPK-së kalimin e kandidatëve për prokurorë me të kaluar penale, të cilët kanë qenë të akuzuar për kryerjen e veprave penale, apo të kandidatëve të cilët kishin dështuar në procesin e vlerësimit dhe verifikimit prokurorial. Kjo ka sjellur situata kur vet KPK të ketë propozuar te

---

[http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2014\)008-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2014)008-e) ). (Qasur për herë të fundit më 10 shkurt 2016).

<sup>91</sup> Rregullore për Procesin e Rekrutimit, Emërimit dhe Riemërimit të Prokurorëve. Këshilli Prokurorial i Kosovës. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1045.2013-Rregullore\\_Nr.03.2013-Per\\_procesin\\_e\\_rekrutimit,emerimit\\_dhe\\_riemerimit\\_te\\_prokuroreve1.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1045.2013-Rregullore_Nr.03.2013-Per_procesin_e_rekrutimit,emerimit_dhe_riemerimit_te_prokuroreve1.pdf) ). (Qasur për herë të fundit më 15 mars 2016).

<sup>92</sup>“Kalimi i lehtë i prokurorëve nëpër “sitën” e dekretimit”. Kallxo.com. (Shih linkun <http://kallxo.com/kalimi-i-lehte-i-prokuroreve-neper-siten-e-dekretimit/>). (Qasur për herë të fundit më 22 mars 2016).

Presidenti i Republikës kandidatë, të cilët në fazat e mëhershme të rekrutimit nuk ishin propozuar nga vetë KPK, për emërim për shkak të integritetit të kontestuar. Po ashtu, një numër i caktuar i kandidatëve për prokurorë janë propozuar nga KPK dhe janë emëruar nga Presidenti i Republikës edhe pse të njëjtit paraprakisht kishin rënë për shkak të integritetit në Këshillin Gjyqësor gjatë aplikimit të tyre për gjykatës.<sup>93</sup>

Miratimi i kësaj rregullore nga KPK, paraqet paradoks shtesë me vetë faktin, se ul kriteret dhe standardin e vlerësimit dhe verifikimit prokurorial të kandidatëve për prokuror në minimum, të cilat kriteret dhe standarde ishin aplikuar dhe ndërtuar përmes Rregullores për Emërimin e Prokurorëve të miratuar më 23 shtator 2013<sup>94</sup>, dhe Rregulloreve të mëhershme dhe zbatuara në disa procese të rekrutimit nga vetë KPK.

Ulja e kriterit dhe standardit lidhur me vlerësimin dhe verifikimin e gjithmbarshëm të kaluarës së kandidatëve për prokurorë, mos harmonizimi dhe shkëmbimi i informatave mes KPK-së dhe KGJK-së lidhur me këta kandidatë, do të mundësoj dhe legjitimoj që një numër i madh i kandidatëve, të cilët kanë nuk kanë kaluar në të kaluarën, propozohen dhe të emërohen si prokurorë. Në të kaluarën ka pasur prokurorë, të cilët në fazat e mëhershme të aplikimit qoftë për funksionin e gjykatësit apo prokurorit, nuk i kanë plotësuar kriteret dhe nuk ishin propozuar për dekretim për shkak të integritetit të kontestuar apo dyshimeve tjera. Sidoqoftë, përmes kësaj rregullore KPK i ka hap rrugë që të njëjtit shumë shpejt të mund të jenë pjesë e sistemit prokurorial.

Vërehet qartë se politika e tilla të miratuara nga vetë KPK, dëmtojnë rëndë në radhë të parë integritetin e vet sistemit prokurorial, sikurse me veprime të tilla ndikojnë në humbjen e besimit të publikut në këtë sistem.

Po ashtu, themelimi i Komisionit për Rekrutim në bazë të nenit 5 të kësaj rregulloreje, është në kundërshtim me frymën dhe qëllimin për të cilin është themeluar vetë KPK. Në bazë të këtij neni, Komisioni përbëhet nga Kryeprokurori i Shtetit, një prokuror nga ZKPSH, një prokuror nga PA, dhe dy prokurorë nga niveli themelor.

Kjo përbërje, nuk parasheh që kryetar i këtij Komisioni duhet të jetë një anëtar nga KPK, i emëruar nga vetë Këshilli, një praktikë dhe standard i aplikuar dhe zbatuar që nga themelimi i KPK-së në vitin 2011. Përkundrazi, me rregullore është përcaktuar drejtëpërdrejtë që kryetar i këtij Komisioni të jetë Kryeprokurori i Shtetit dhe katër prokuror nga prokuroritë tjera, duke mos përfshirë asnjë anëtarë nga KPK, dhe duke anashkaluar KPK-në pothuajse në tërësi në procesin e rekrutimit të prokurorëve. I vetmi përfaqësues në këtë komision nga KPK është vetë Kryeprokurori i Shtetit. Përbërja e tillë është në kundërshtim me nenin 110 të Kushtetutës, e cila përcakton se KPK është organi që do të rekrutoj dhe propozoj kandidatët për prokurorë. Po ashtu, neni 1.4 e Ligjit bazik të KPK, përcakton në mënyrë të qartë se *“Këshilli është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për zyrën prokuroriale si dhe vlerëson, ngrit në detyrë, disiplinon, shkarkon, transferon dhe ofron mbështetje për trajnimin e prokurorëve.”*

Edhe përkundër faktit se Kryeprokurori i Shtetit është anëtar i KPK-së, funksioni i tij dhe pozita si Kryeprokuror i Shtetit, dhe caktimi i tij si Kryetar i këtij Komisioni, paraqet konflikt të kompetencave dhe përgjegjësi në mes të institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe KPK-së. Caktimi i Kryeprokurorit

---

<sup>93</sup> Shih funksotën 93.

<sup>94</sup>Rregullore për Procesin e Rekrutimit, Emërimin dhe Riemërimin të Prokurorëve. Këshilli Prokurorial i Kosovës. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1045.2013-Rregullore\\_Nr.03.2013-Per\\_procesin\\_e\\_rekrutimit,emerimit\\_dhe\\_riemerimit\\_te\\_prokuroreve1.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1045.2013-Rregullore_Nr.03.2013-Per_procesin_e_rekrutimit,emerimit_dhe_riemerimit_te_prokuroreve1.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 15 mars 2016).

të Shtetit, në këtë Komision në cilësinë e kryetarit, përbën rrezik për fuqizimin e pozitës së Kryeprokurorit të Shtetit, dhe nënshkrimin e KPK-së, qasje kjo që është në tërësi në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të përmendura më lartë dhe të krijuara nga Komisioni i Venecias.

Karakteristikë e kësaj rregulloreje është po ashtu, nënshkrimi i saj nga Kryeprokurori i Shtetit dhe Kryesuesi i KPK-së, i cili duhet të jetë një gabim teknik, pasi që edhe Ligji për KPK dhe Rregullorja për Funksionimin dhe Veprimtarinë e KPK-së, përcakton dhe parasheh se nënshkrimi i dokumenteve të miratuara në KPK, është kompetencë ekskluzive e Kryesuesit të KPK-së<sup>95</sup>, dhe se nënshkrimi i një dokumenti të miratuar në KPK nga Kryeprokurori është shkelje ligjore dhe tejkalim i kompetencave të Kryeprokurorit të Shtetit.

#### **• RREGULLORE PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT DHE ZËVENDËSKRYESUESIT TË KPK-SË**

KPK më 29 dhjetor 2015, ka miratuar Rregullore për Zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesin e KPK-së. Edhe në këtë rregullore, vërehet një imponim dhe ushtrim i autoritetit të Kryeprokurorit të Shtetit në raport me KPK-në dhe anëtarëve të tij.

Ky imponim i autoritetit të Kryeprokurorit të Shtetit vihet në pah, në radhë të parë për faktin se merr një përgjegjësi dhe kompetencë kolegjiale të Këshillit, dhe e bartë në kompetencën e tij individuale, duke filluar nga fillimi i procedurës së nominimeve për Kryesues dhe Zëvendës-kryesues të KPK-së, të gjithë anëtarëve të KPK-së. Në bazë të nenit 4 të kësaj rregullore, të gjithë kandidatët e interesuar për të kandiduar për kryesues dhe zëvendës-kryesues të KPK-së, duhet që këtë komunikim ta bëjnë tek Kryeprokurori i Shtetit, duke specifikuar pozitën për të cilën aplikon.

Përderisa procesi i përzgjedhjes së Kryesuesit të KPK-së në takimin e mbajtur më 12 janar 2016<sup>96</sup>, është realizuar në mënyrë të rregullt, ku për pozitën e Kryesuesit të KPK-së, kishin kandiduar tre anëtarë të KPK-së, Blerim Isufaj nga PSRK, Bahri Hyseni, prokuror nga Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorisë Themelore në Ferizaj me përvojë punë afër tre vite si prokuror, dhe Idain Smaijli, prokuror nga Departamenti për Krime të Rënda i Prokurorisë së Apelit. Nga procesi i votimit në raundin e dytë, për Kryesues të KPK-së është zgjedhur Blerim Isufaj me tetë (8) vota ndaj Bahri Hysenit, i cili nga ky proces i votimit ka marr vetëm dy (2) vota, nga dhjetë (10) anëtarët prezent.

Në anën tjetër procesi i përzgjedhjes së zëvendës-kryesuesit të KPK-së, është realizuar në kundërshtim me vetë nenin 1 të kësaj rregullore, e cila përcakton se procesi i përzgjedhjes së kryesuesit dhe zëvendës-kryesuesit të KPK-së, është i hapur, transparent, i paanshëm dhe objektiv dhe se procesi zbatohet në pajtim me parimet e konkurrencës. Edhe përkundër faktit se rregullorja përcakton se për zëvendës-kryesues duhej të zhvillohej e njëjta procedurë e konkurimit në mes të kandidatëve të interesuar, Kryeprokurori i Shtetit si kryesues i seancës së parë të KPK-së sipas ligjit të ri mbi KPK-në, vendos që përmes votimit Idain Smaijli të zgjedhet zëvendës-kryesues i KPK-së, duke ua mohuar anëtarëve tjerë të drejtën e konkurimit.<sup>97</sup> Kjo për më tepër interferon qartazi në shkelje të të drejtave të njeriut.

<sup>95</sup> Neni 4 - Rregullorja për Funksionimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës, parasheh që Kryetari i KPK-së, nënshkruan vendimet dhe dokumentet në emër të KPK-së. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.290.2013-Rregullore\\_me\\_nr.01.2013-KPK.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.290.2013-Rregullore_me_nr.01.2013-KPK.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 15 mars 2016).

<sup>96</sup> Mbledhja e 111-të e Këshillit Prokurorial të Kosovës e mbajtur më 14 janar 2016. (Shih linkun [https://www.youtube.com/watch?v=EF\\_HrMeQz5U](https://www.youtube.com/watch?v=EF_HrMeQz5U)). (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2016).

<sup>97</sup> Shih fusnotën 97.

Po ashtu takimi i parë i KPK-së për vitin 2016, në pajtim me ligjin e plotësuar për KPK-në, është karakterizuar me përjashtimin e anëtarit të shoqërisë civile dhe marrjen e mandatit kushtetues dhe ligjor në mënyrë të kontestuar nga KPK, përderisa zgjedhja e anëtarit jo prokuror të KPK-së, nga radhët e shoqërisë civile ishte bërë pas një konkursi publik të shpallur nga KPK në bazë të ligjit Nr. 03/L-224 për KPK dhe dispozitave të tjera të këtij ligji dhe Rregulloren për Funkcionimin dhe Veprimtarinë e KPK-së.<sup>98</sup> Ky përjashtim arbitrar ka nisur më herët, me hapjen e konkursit publik për zgjedhjen e anëtarit nga radhët e shoqërisë civile, respektivisht më 5 nëntor 2016, mirëpo është finalizuar me një përjashtim arbitrar ku anëtari i shoqërisë civile edhe pse ka mandat 5 vjeçar pa asnjë arsyetim nuk është ftuar në mbledhjet pas datës 1 janar 2016.<sup>99</sup>

Për më tepër si dhe për të argumentuar atë që u tha më lartë vlen të theksohet se neni 7 i Ligjit për KPK ka paraparë se mandati i anëtarit të KPK-së është 5 (pesë) vjeçar, ashtu siç është paraparë edhe në vendimin për zgjedhjen e anëtarit të KPK-së nga shoqëria civile.<sup>100</sup> Duke iu referuar vendimit për zgjedhjen e anëtarit të KPK-së nga shoqëria civile, mandati i tij ka filluar të rrjedh nga data 9 shtator 2014, kur edhe është mbajtur mbledhja e 78 e KPK-së, mbledhje në të cilën z. Florent Muçaj është zgjedhur anëtar jo prokuror i KPK-së nga radhët e shoqërisë civile dhe është votuar në mënyrë unanime, pa asnjë votë kundër.<sup>101</sup> Po ashtu, sipas nenit 7 të ligjit Nr. 03/L-224 për KPK dhe vendimit të datës 9 shtator 2014, mandati 5 (pesë) vjeçar i anëtarit të KPK-së nga shoqëria civile rrjedhimisht përfundon me datë 09 shtator 2019.

Siç u theksua më lartë përkundër kësaj, KPK në takimin e datës 5 nëntor 2015, ka marr vendim nr.321/2015, lidhur me shpalljen e konkursit për anëtarë të KPK nga shoqëria civile, i cili konkurs është shpallur më 21 nëntor 2015. Vendimi i KPK-së për ndërprerjen e mandatit të z. Muçaj dhe shpalljes së konkursit ka ndërprerë në mënyrë kundër kushtetuese dhe kundër ligjore mandatin e anëtarit të shoqërisë civile në KPK, të fituar sipas kushtetutës dhe ligjit. Për më tepër, kjo ndërprerje e parakohshme e mandatit, nuk mund të bëhet me vendim, ligj e as me Kushtetutë sepse kjo në kundërshtim me të drejtën për t'u zgjedhur, sipas nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.<sup>102</sup> Kjo e drejtë është e garantuar me Kushtetutë dhe është vërtetuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës ku kishte ndaluar ndërprerjen e parakohshme të mandatit të Presidentes së Republikës së Kosovës, sipas rasteve K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12<sup>103</sup>, ku ky aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese, ka efekt *erga omnes* për mandatet kushtetuese dhe ndërprerjen e parakohshme të tyre. Kjo praktikë e ndërprerjes së mandatit është po ashtu e ndaluar edhe me standardet ndërkombëtare kushtetuese<sup>104</sup>.

Vendimi lidhur me ndërprerjen e mandatit të anëtarit të KPK-së nga shoqëria civile dhe mohimit të ushtrimit të drejtës së tij të garantuar me Kushtetutë dhe ligj është subjekt i procedurave gjyqësore

---

<sup>98</sup> Shih dokumentet në vijim: Kushtetutën e Republikës së Kosovës; Ligjin Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës; Rregulloren për Funkcionimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Vendimin nr.260/2014 i datës 15.09.2014.

<sup>99</sup> IKD intervistë me z. Florent Muçaj, anëtar jo prokuror i KPK-së nga radhët e shoqërisë civile. Dhjetor 2015.

<sup>100</sup> Pika 1 e dispozitivit të vendimit nr.260/2014 të datës 15.09.2014.

<sup>101</sup> Procesverbali dhe transkripi i Mbledhjes së 78-të të KPK-së, pika e 5-te e rendit të ditës.

<sup>102</sup> Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

<sup>103</sup> Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12, Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012.

<sup>104</sup> *Petitioni nga Miloš Melčák, anëtar i Parlamentit, kërkon anulimin e Aktit Kushtetues nr. 195/2009, Coll., lidhur me shkurtimin e mandatit të pestë në zyre të deputeve të dhomës.* (Shih linkun [http://www.usoud.cz/en/decisions/?tx\\_ttnews\[tt\\_news\]=468&cHash=b239af8f32f409fe77493adf911e665f](http://www.usoud.cz/en/decisions/?tx_ttnews[tt_news]=468&cHash=b239af8f32f409fe77493adf911e665f)). (Qasur për herë të fundit më 15 janar 2016).

pranë Gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese, për çka akoma nuk ka asnjë vendim apo përgjigje nga asnjëra instancë.<sup>105</sup>

- **RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS**

KPK në takimin e mbajtur më 29 dhjetor 2015, ka miratuar Rregulloren për Organizimin dhe Veprimtarinë e KPK-së, e cila rregullore në të vërtetë është plotësim ndryshim i Rregullores për Funkcionimin dhe Veprimtarinë e KPK-së, të miratuar më 4 mars 2013.<sup>106</sup> IKD gjatë vlerësimit të analizës së dy rregulloreve, vëren se me Rregulloren e re, KPK ka arritur të adresoj disa prej obligimeve që kanë dal nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KPK-në, sikurse vëren se dispozita të caktuara të kësaj rregulloreje janë në kundërshtim me ligjin e lartpërmendur.

Sikur edhe në rastet e tjera të theksuara më lartë, KPK edhe përmes kësaj rregulloreje bie nën ndikimin e autoritetit të Kryeprokurorit të Shtetit, lidhur me thirrjen e takimeve të jashtëzakonshme të KPK-së të përcaktuar me nenin 19 të kësaj rregullore. Në bazë të këtij neni, takimet e jashtëzakonshme të Këshillit për të diskutuar çështje urgjente mund të thirren me kërkesë nga Kryesuesi i Këshillit, Kryeprokurori i Shtetit apo pesë anëtarë të KPK-së. Përmes kësaj dispozite, pozita e Kryesuesit të KPK-së dhe Kryeprokurorit të Shtetit barazohen dhe kanë raport të privilegjuar në raport me anëtarët e tjerë të KPK-së, të cilët në raste të tilla duhet të jenë së paku pesë (5) anëtarë.

Përderisa, kjo e drejtë e siguruar për Kryesuesin dhe Kryeprokurorin e Shtetit, me këtë rregullore iu mohohet zëvendës-kryesuesit. Për më tepër, kjo dispozitë bie në kundërshtim me të drejtat dhe autorizimet që Ligji për KPK i ka siguruar Zëvendës-Kryesuesit të KPK-së, i cili automatikisht zëvendëson Kryesuesin e Këshillit kur ai mungon.<sup>107</sup>

- **RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORIT TË SHTETIT**

KPK më 31 dhjetor 2015<sup>108</sup>, ka miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Funkcionimin e Prokurorit të Shtetit, dhe do të filloj së zbatuari nga 15 janari 2016. Miratimi i kësaj rregullore është një e arritur e KPK-së dhe përmbushje e një obligimi ligjor lidhur me organizimin, administrimin, menaxhimin dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit. Kjo për faktin se sistemi prokurorial i Kosovës ka kaluar në strukturën e re organizative më 1 janar 2013 dhe këtij Këshilli i janë dashur tre vite për të hartuar dhe miratuar një rregullore, e cila konsiderohet si dokument bazë dhe i domosdoshëm për funksionimin dhe veprimtarinë e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

IKD gjatë vlerësimit dhe analizimit të kësaj rregullore, ka vërejtur se numër i madh i dispozitave të kësaj rregullore janë përsëritje e dispozitave të marra nga Ligji për Prokurorin e Shtetit. Teksti i nenit gjashtë i kësaj rregullore është pothuajse përsëritje e tekstit të nenit 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit për Prokurorin e Shtetit.

---

<sup>105</sup> IKD intervistë me z. Florent Muçaj, anëtar joprokuror i KPK-së nga shoqëria civile. Dhjetor 2015.

<sup>106</sup> Rregullore për Funkcionimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Miratuar më 4 mars 2013. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.290.2013-Rregullore\\_me\\_nr.01.2013-KPK.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.290.2013-Rregullore_me_nr.01.2013-KPK.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).

<sup>107</sup> Neni 4: "Zëvendëskryesuesi ushtron përgjegjësitë dhe detyrat e Kryesuesit, kur ai mungon. Zëvendëskryesuesi ka autoritet të plotë për të vepruar në emër të Këshillit në rast të mungesës apo paafësisë së Kryesuesit. Ligji Nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Shih linkun <http://shkk.rks-gov.net/desk/inc/media/E04FE92F-0905-41D2-9499-BA14C9EEE367.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 22 mars 2016).

<sup>108</sup> Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Funkcionimin e Prokurorit të Shtetit. Këshilli Prokurorial i Kosovës. 31 dhjetor 2015.



Po ashtu, neni 7 i kësaj rregulloreje, paragrafi 1.3 përcakton se Kryeprokurori i Shtetit kryeson Komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve për Kryeprokurorë dhe në emër të Komisionit i rekomandon KPK-së, kandidatin për Kryeprokuror të Prokurorisë përkatëse. Përderisa, procesi i rekrutimit, emërimin, ri-emërimin dhe propozimit për shkarkim të prokurorëve janë kompetenca ekskluzive të KPK-së të përcaktuara me Ligjin për KPK-së, edhe në këtë rast, kjo dispozitë është në kundërshtim me frymën e ligjit të lartpërmendur, duke fuqizuar pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit në raport me procesin e emërimin të Kryeprokurorëve, duke tejkaluar kompetencat dhe autorizimet e Kryeprokurorit të Shtetit në raport me KPK-në.

Kjo dispozitë është tejkalim i procedurave dhe kompetencave të Kryeprokurorit të Shtetit, në raport me KPK, dhe paraqet rrezik potencial, që një kompetencë e tillë të keqpërdoret, respektivisht kjo do të mund të hapte mundësinë për të pasur manipulime të inicuar dhe të bazuara në baza politike dhe personale, gjatë procesit të emërimin të Kryeprokurorëve.<sup>109</sup>

Po ashtu pika 1.13 e nenit 7 të kësaj rregullore është në kundërshtim me ligjin për KPK-në dhe Kushtetutën e Kosovës, që përcaktojnë qartë se propozimi për shkarkim të prokurorëve është kompetencë ekskluzive e KPK-së, dhe atë vetëm sipas rekomandimit të Komisionit për Vlerësim të Performancës së Prokurorëve apo Komisionit Disiplinor të KPK-së. Në asnjë dispozitë të ligjit për KPK-në apo Prokurorin e Shtetit nuk ka bazë ligjore përmes së cilës, Kryeprokurori i Shtetit mund të propozoj shkarkimin e prokurorëve apo Kryeprokurorëve. Kjo dispozitë është në kundërshtim edhe me opinionin e Komisionit të Venecias lidhur me emërimin apo shkarkimin e prokurorëve.<sup>110</sup>

Gjithashtu edhe tek neni 9 i kësaj rregulloreje vërehet tendenca e forcimit të pozicionit të Kryeprokurorit të Shtetit, dhe minimizimit të pozicionit të KPK-së në raport me Kryeprokurorët e Prokurorive përkatëse, në kundërshtim me frymën e ligjit për KPK-në dhe PSh-në. Paragrafi 1.6 i këtij neni përcakton se asnjë Kryeprokuror i nivelit më të ulët nuk mund të komunikoj me publikun dhe mediat pa pasur një kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit. Kjo dispozitë është në kundërshtim me vetë Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror, i cili përcakton se prokurori mban komunikim të hapur dhe aktiv me publikun dhe mediet. Ky kod është miratuar nga vetë KPK në vitin 2012.<sup>111</sup>

Po ashtu, ky nen cenon rëndë pavarësinë e Kryeprokurorëve të Prokurorive përkatëse, kompetencave dhe përgjegjësisë që Ligji për Prokurorin e Shtetit iu ka deleguar në administrimin dhe menaxhimin e prokurorive në të cilat janë emëruar.

Për më tepër kjo dispozitë centralizon pushtetin lidhur me komunikimin me media dhe publikun vetëm në duart e Kryeprokurorit të Shtetit dhe me këtë edhe në uljen e mëtutjeshme të transparencës dhe llogaridhënies së istemit prokurorial. Ky kontroll dhe tejkalimi i parimit të subordinimit, paraqet mundësinë që ky sistem të jetë subjekt i ndërhyrjeve nga jashtë apo ndikimeve politike.<sup>112</sup>

---

<sup>109</sup> Shih fusnotën 90.

<sup>110</sup> Shih fusnotën 90

<sup>111</sup> Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë. Miratuar nga KPK me datë 31 korrik 2012. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.911.2012-Kodi\\_i\\_etikes\\_per\\_prokuror.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.911.2012-Kodi_i_etikes_per_prokuror.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 25 mars 2016).

<sup>112</sup> Përmbledhje e opinionëve dhe raporteve të Komisionit të Venecias, lidhur me prokurorët: “*Ligji mbi organizimin dhe procedurën e zyrës së Prokurorit, duhet të definoj prokurorinë si sistem i autoriteteve relativisht të pavarura, mundësisht të organizuar në korrespondencën e sistemit gjyqësor. Kjo do t’i bije që autoriteti më i lartë të kontrolloj menjëherë atë të nivelit më të ulët. Megjithatë, autoriteti më i lartë nuk duhet të kontrolloj direkt atë më të ulët. Në këtë mënyrë, sistemi prokurorial do të mbrohet nga intervenimet ose ndikimet direkte politike.*” Faqe 29. (Shih linkun [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-PI\(2015\)009-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-PI(2015)009-e)). (Qasur për herë të fundit më 25 mars 2016).

Dispozita tjera të kësaj rregulloreje që janë në kundërshtim me ligjin për KPK-në dhe ndërhynë në kompetencat e Këshillit nga Kryeprokurori i Shtetit janë neni 27 paragrafi 2, i cili përcakton së Kryeprokurori i Shtetit në bashkëpunim me Këshillin është përgjegjës për strukturimin e brendshëm dhe përcaktimin e numrit të zyrtarëve brenda administratës së Prokurorit të Shtetit.

Kjo dispozitë është në kundërshtim të drejtpërdrejt me detyrat dhe kompetencat e Këshillit të përcaktuara me nenin 4 pika 1.14 të Ligjit bazik të KPK-së, i cili përcakton qartë së është kompetence ekskluzive e KPK-së për të mbikëqyrur administrimin e Prokurorive dhe personelit të saj. Në asnjë dispozitë të ligjit të KPK-së apo PSh-së, nuk është paraparë një kompetencë e tillë e rezervuar për Kryeprokurorin e Shtetit.

- **PLANI STRATEGJIK (2016-2018) DHE PLANI I VEPRIMIT PËR NGRITJËN E EFIKASITETIT TË SISTEMIT PROKURORIAL NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT DHE KRIMEVE EKONOMIKE, PËRFSHIRË SEKUESTRIMIN DHE KONFISKIMIN E PASURISË SË PALIGJSHME**

KPK më 1 dhjetor 2015, ka miratuar Planin Strategjik (2016-2018) dhe Planin e Veprimit për Ngritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme.

Ky Plan Strategjik ka përcaktuar disa qëllime, si zvoglimi i lëndëve të pazgjidhura, rritjen e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja, ngritjen e nivelit të bashkëpunimit me institucione, ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve të specializuara, llogaridhënien dhe transparencën.

Edhe përkundër faktit se KPK përmes këtij Plani Strategjik ka shprehur vullnet deklarativ në ngritjen e llogaridhënies dhe transparencës së sistemit prokurorial në trajtimin e e rasteve të përmendura në këtë plan, në praktikë ndodh e kundërta. IKD ka kërkuar nga KPK dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit qasje në Planin Strategjik të miratuar nga KPK, por ka marr përgjigje negative lidhur me kërkesen e paraqitur duke u bazuar në ligjin mbi qasjen në dokumente publike.<sup>113</sup>

Shqetësuese po ashtu është përgjigja dhe qëndrimi zyrtar i KPK-së, lidhur me Planin Strategjik të miratuar ku ende pa filluar zbatimin i saj nga prokuroritë, pranojnë faktin se kjo strategji e miratuar ka mangësi dhe se e njëjta do të plotësohet me rekomandimet e marra nga anëtarët e Këshillit dhe përfaqësuesit ndërkombëtar që mbështesin punën e Këshillit.

Përmes këtij Plani Strategjik sistemi prokurorial njeh faktin se sistemi i drejtësisë nuk ka arritur ndonjë sukses të duhur në luftimin e kryesve të veprave penale që janë subjekt në kuadër të këtij plani, dhe se sipas sistemit prokurorial ka rezultuar negativisht në reputacionin e organeve të drejtësisë.

KPK konstaton se ky Plan Strategjik është në linjë me objektivat e Planit të Veprimit për ngritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor në trajtimin e lëndëve të korrupsionit, të aprovuar nga KGJK. Ky plan është hartuar nga IKD në bashkëpunim me KGJK-në. Pas propozimit të planit nga IKD, me disa plotësime dhe ndryshime ky plan ishte miratuar nga KGJK.

---

<sup>113</sup>Përgjigje nga zyrtari për qasje në dokumente publike i caktuar nga KPK. “Këshilli Prokurorial me datë 1 dhjetor 2015, ka miratuar Planin Strategjik (2016 - 2018) dhe Planin e Veprimit për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme, mirëpo ky plan do të plotësohet me rekomandimet e marra nga anëtarët e Këshillit dhe përfaqësuesit ndërkombëtar që mbështetin punën e Këshillit. Pas plotësimit dhe ndryshimit me këto rekomandime Plani do të publikohet në ueb faqet e Prokurorit të Shtetit dhe të Këshillit Prokurorial”. Komunikim i IKD-së me zyrtarin për qasje në dokumente publike të KPK-së përmes postës elektronike.

KPK në pikën pesë (5) të këtij plani ka përcaktuar lëndët me prioritet të lartë në kuadër të PSRK dhe Prokurorive Themelore, në bazë të pozitës zyrtare të kryesit dhe shumës së përfitimit apo dëmit të shkaktuar me vepër penale.

Gjithashtu në pikën gjashtë (6) të këtij plani, KPK ka paraparë themelimin e Njësitit Antikorrupsion, Krimeve Ekonomike, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Duke pasur parasysh volumin e madh të lëndëve në Prokurorinë Themelore në Prishtinë si dhe faktin se afërsisht 60% të lëndëve të korrupsionit apo krimeve ekonomike në tërë Kosovën, janë në punë në këtë prokurori, themelimi i këtij Njësi mund të vlerësohet si objektiv strategjik që do të rezultoj me ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në trajtimin dhe luftimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, nëse ka vullnet dhe përkushtim.

IKD duke analizuar dhe vlerësuar Planin Strategjik dhe dispozitat lidhur me Njësitin Antikorrupsion, vlerëson se KPK në kuadër të autorizimeve dhe përgjegjësi të tij, ka kompetenca në zhvillimin dhe miratimin e politikave që ndërlidhen me ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit dhe kriminalitetit në përgjithësi, siç është përcaktuar edhe me nenin 4 të Ligjit për KPK-në.

Sidoqoftë, IKD konsideron se dispozitat e këtij Plani Strategjik që ndërlidhen me caktimin e prokurorëve në Njësitin Antikorrupsion në bazë të procedurave të përcaktuara nga Këshilli, bien në kundërshtim me Ligjin për Prokurorin e Shtetit, respektivisht me nenin 4, i cili përcakton së Kryeprokurori udhëheq me punën dhe përfaqëson Prokurorinë për të cilën është emëruar. Kryeprokurori është përgjegjës për punën e Prokurorisë dhe për punën e vet i përgjigjet Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK-së. Prokurorët i përgjigjen Kryeprokurorit për punën e vet.

Caktimi i prokurorëve në Njësitin Antikorrupsion, cenon autoritetin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe mund të konsiderohet ndërhyrje në kompetencat dhe përgjegjësitë që ligji ka përcaktuar lidhur me menaxhimin dhe administrimin e Prokurorisë përkatëse nga Kryeprokurori.

KPK rezervon të drejtën për të transferuar apo ngritur në detyrë prokurorët e shtetit në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me ligj, sidoqoftë çdo ndërhyrje në administrimin dhe menaxhimin e brendshëm të një prokurorie përkatëse, jashtë procedurave dhe kriterëve të përcaktuara me ligj, cenon autoritetin e Kryeprokurorëve dhe me këtë edhe shkel kompetencat dhe përgjegjësitë e garantuara me ligj.

Caktimi i prokurorëve nga KPK qoftë edhe përmes bashkëpunimit me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, përjashton Kryeprokurorin e kësaj prokurorie nga përgjegjësia lidhur me dështimet eventuale apo mos përmbushja e obligimeve të përcaktuara me këtë Plan Strategjik.

Pika 8 e këtij Plani Strategjik përcakton vlerësimin e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit. Përmes kësaj pike KPK synon të ngrisë llogaridhënien dhe ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e veprave penale të përcaktuara me këtë plan strategjik. Përderisa, dispozitat e këtij plani që kanë të bëjnë me kompetencat e dhëna mekanizmit mbikëqyrës për të ngritur llogaridhënien e prokurorëve dhe Kryeprokurorëve, të cilët dështojnë në përmbushjen e obligimeve që dalin nga ky dokument përmes rekomandimit për iniciimin e procedurave disiplinore ndaj tyre, janë të mirëseardhura dhe duhet punuar që këto dispozita të zbatohen në praktikë. Zbatimi i tyre kërkon

vullnet dhe përkushtim në radhë të parë të vetë KPK dhe të evitohen praktikat e deri tanishme, kur ky vullnet ka munguar dhe nuk ka gjetur zbatim në praktikë.<sup>114</sup>

Gjithashtu, KPK edhe në këtë plan strategjik, delegon kompetenca dhe përgjegjësi tek mekanizmat e tij të brendshëm që janë në kundërshtim me Kushtetutë, ligjet që rregullojnë sistemin prokurorial dhe praktikat dhe standardët ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë<sup>115</sup>. KPK mekanizmit mbikqyrës i delegon kompetenca për të rekomanduar shkarkimin e drejtpërdrejtë të prokurorëve apo kryeprokurorëve të cilët dështojnë në përmbushjen e obligimeve.

Pika 9 e këtij Plani Strategjik ka paraparë për herë të parë në sistemin e drejtësisë Institutin e Shpërblimit për Prokurorë, me qëllim të stimulimit të prokurorëve për të punuar më shumë në zgjidhjen e suksesshëm të lëndëve të parapara me këtë plan. Shpërblimi i paraparë më këtë strategji arrin shumën prej 150 deri në 400 euro për Njësitin Antikorrupsion, me kusht që ky Njësit dhe prokurorët e angazhuar të kenë realizuar me sukses qëllimet e plani strategjik dhe planit të veprimit.

Pika 9 e këtij plani është në kundërshtim në radhë të parë me Ligjin për Prokurorin e Shtetit, respektivisht nenin 21, paragrafin 1.8 i cili përcakton “*secili prokuror me mandat të përhershëm në Prokurorinë Themelore pranon pagë jo më pak se shtatëdhjetë përqind (70%) e pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore. Këshilli do të nxjerr skemën për kompensime shtesë që pasqyron përgjegjësitë e veçanta të prokurorit që paraqiten para Departamentit të Krimeve të Rënda pranë Gjykatës Themelore, por në asnjë rast shuma e pagës bazë dhe pagesës shtesë nuk do të kalojë nëntëdhjetë për qind (90%) të pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore.*

Shpërblimi i paraparë më Plan Strategjik prej 150 euro deri në 400 Euro, si pagesë shtesë do të tejkalon pagën e Kryeprokurorëve të Prokurorisë Themelore, dhe me këtë është në kundërshtim të drejtpërdrejt me Ligjin bazik për Prokurorin e Shtetit.

Nëse merret për bazë se të njëjtat standarde duhet të aplikohen për prokurorë<sup>116</sup> dhe gjykatës, Komisioni i Venecias ndan mendimin se pagat për gjykatës duhet të korrespondojnë më dinjitetin e

<sup>114</sup> “Dështimin në lidhje me regjistrimin e rasteve të korrupsionit e ka konstatuar vetë KPK, përmes Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, duke krijuar (shkurt 2014) Komisionin për Mbikëqyrjen dhe Verifikimin e lëndëve të korrupsionit nëpër prokurorin 139. Rezultatet e punës së këtij komisioni, nxorën në shesh papërgjegjshmëri të madhe të një zinxhiri të zyrtarëve nëpër prokurori, prej prokurorëve deri të zyrtarët e stafit mbështetës, të cilët nuk kishin respektuar rregullat e Mekanizmit Përcjellës për regjistrimin e rasteve të korrupsionit në bazën e të dhënave. Këto gjetje dhe rekomandime të Komisionit, ishin miratuar në mbledhjen e KPK-së, të mbajtur më 25 shkurt 2014, ku ishte nxjerrë vendimi me nr. 45-2014140, përmes të cilit janë obliguar të gjithë Kryeprokurorët që të iniciojnë masa disiplinore ndaj personave që kanë dështuar të respektojnë rregullat për regjistrimin e lëndëve të korrupsionit në Mekanizmin Përcjellës. Përkundër shkeljeve të shumta të cilat ishin evidentuar nga Komisioni dhe vendimit të prerë të KPK-së që të merreshin masa ndaj personave përgjegjës, Kryeprokurorët asnjëherë nuk kanë ndërmarr ndonjë veprim për zbatimin e këtij Vendimi, respektivisht nuk kanë iniciuar procedura disiplinore ndaj asnjë prokurori dhe punonjësi, për dështimet e tyre. Duke parë hezitimin e Kryeprokurorëve për të mbajtur përgjegjësi zyrtarët e tyre, KPK në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014141, ka marrë vendim që Kryeprokurorët e PTh -ve dhe PSRK-së të raportojnë në lidhje me zbatimin e vendimit me nr. 45-2014 të datës 25 shkurt 2014. KPK përmes këtij vendimi ka kërkuar përgjegjësi drejtpërdrejt nga Kryeprokurorët për mos ndëshkimin e prokurorëve dhe zyrtarëve të tyre për mos regjistrimin e rasteve të korrupsionit. IKD shpreh shqetësimin e dyfishtë për Kryeprokurorët, të cilët nuk e kanë zbatuar vendimin e organit më të lartë në sistemin prokurorial, KPK-së, por gjithashtu shpreh shqetësim të madh për moszbatimin e vendimit nga KPK, për t'i ndëshkuar Kryeprokurorët, në rast se ata, nuk i ndëshkojnë prokurorët dhe punonjësit e tyre për shkeljet e evidentuara. Ky reagim është në vazhdim e reageimeve të IKD-së ndaj KPK-së, e cila po dështon të adresojë çështjet më të rëndësishme rreth zbatimit të vendimeve të veta që ndërlihen me luftimin e korrupsionit në Kosovë.” Luftimi i korrupsionit në Kosovë, prioritet në letër”. 10 dhjetor 2015. Faqe 78-79. (Shih linkun <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2015/12/1.-FINAL-Lufta-kunder-korrupsionit-ne-Kosove-prioritet-ne-leter-08.12.2015-Repaired1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 15 janar 2016).

<sup>115</sup> Shih fusnotën 90

<sup>116</sup> “Ashtu si për gjyqtarët, shpërblimi në përputhje me rëndësinë e detyrave të kryera, është esencjal për një sistem gjyqësor të drejtë dhe efikas. Një shpërblim i mjaftueshëm është poashtu i nevojshëm për të zvogëluar rrezikun nga korrupsioni i prokurorëve”. RAPORT MBI STANDARDET EUROPIANE LIDHUR ME PAVARËSINË E SISTEMIT GJYQËSOR: PJESA II – SHËRBLIMI I PROKURORISË, i miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën e tyre plenare 85. (Venecia, 17-

profesionit të gjykatësit dhe se paga adekuate është e një rëndësie të veçantë për të mbrojtur gjykatësin nga ndikimi i jashtëm. Niveli i pagës duhet të vendoset në bazë të kushteve sociale, duke krahasuar nivelin e pagave të zyrtarëve më të lartë. Caktimi i pagës duhet të bazohet në një standard të përgjithshëm dhe të përcaktohet në kritere objektive dhe transparente, dhe asesi në performancën individuale të gjykatësit. Bonuset apo shtesat përfshin elemente të diskrecionit dhe duhet të përjashtohen.<sup>117</sup>

Qëndrim pothuajse të njëjtë lidhur me pagat e gjykatësve mban edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara në komentin nr. 32, që ndërlidhet me zbatimin e nenit 14 të Konventës për të Drejtat Politike dhe Civile e aplikueshme drejtpërdrejtë në Kosovë. Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës mban qëndrim të njëjtë përmes rekomandimit nr. R(94) 12, Parimi III, para, 1b. Po ashtu neni 13 i Kartës Universale të Gjykatësve përcakton se gjykatësit duhet të pranojnë pagesë të mjaftueshme për të siguruar pavarësi të vërtetë ekonomike. Paga nuk duhet të bazohet në rezultate të gjykatësit, dhe nuk guxon të zvoglohet gjatë shërbimit të tij. Përderisa, mbrojtja e pavarësisë së gjykatësve është e garantuar edhe me Kushtetutë, siç është rasti i nenit 3, seksionit të Kushtetutës së SHBA-ve që përmban ndalesë të drejtpërdrejtë për zvoglimin e pagesës së gjykatësit gjatë ushtrimit të funksionit të tij. Natyrisht, zvoglimi i pagës së gjykatësve ose prokurorëve mund të bëhet vetëm atëherë kur ndaj tyre shqiptohen masa disiplinore nga mekanizmat e brendshëm të llogaridhënies.

#### **b) Vendimet e KPK**

KPK nga 1 nëntori i vitit 2015 deri më 31 dhjetor 2015, ka marr 21 vendime, të cilat janë publikuar në uebfaqen zyrtare të KPK-së dhe PSh-së. Nga këto 21 vendime të nxjerra nga KPK, është miratuar *Plani i Punës së Njësitit për Shqyrtimin e Përformancës së Prokurorive për vitin 2016*, vendimi për miratimin e katër rregulloreve të miratuara nga KPK, si *Rregullorja për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës-Kryesuesit të KPK-së, Rregullore për Organizimin dhe Veprimtarinë e KPK-së, Rregullore për Organizimin e Brendshëm të Prokurorit të Shtetit dhe Rregullore për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve*. Më 29 dhjetor 2015, KPK ka marr *Vendim për themelimin e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit, Krimeve Ekonomike, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme në Departamentin për Krime të Rënda dhe Departamentin e Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë*. Po ashtu më 29 dhjetor 2015, KPK ka marr *Vendim për themelimin e Komisionit Mbikëqyrës në Luftimin e Korrupsionit, Krimeve Ekonomike, përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme*.

Më 10 nëntor 2015, KPK kishte marr vendim për shpalljen e zgjedhjeve për anëtarë të KPK-së nga PSRK dhe Prokuroritë Themelore dhe vendimin për themelimin e Komisionit Zgjedhor për Zhvillimin e Zgjedhjeve për Anëtarë të KPK-së, nga radhët e prokurorëve.

Ndërsa me 5 nëntor 2015, KPK ka marr Vendim për shpalljen e konkursit për anëtarë jo prokurorë të KPK-së, nga shoqëria civile. Po ashtu Më 5 nëntor 2015, KPK , kishte miratuar vendimin për miratimin e Rregulloreve për: Emërimin e Kryeprokurorëve, Skemën e Kompensimit të Anëtarëve dhe Komisioneve të KPK-së si dhe Komisionin Disiplinor dhe Procedurën Disiplinore ndaj Anëtarëve të KPK-së. Po me këtë datë KPK ka marr keto vendime për: Themelimin e Komisionit për Zgjedhjen

---

18 dhejtor 2010). Faqe 13, pika 69. (Shih linkun [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2010\)040-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2010)040-e)). (Qasur për herë të fundit më 24 shkurt 2016).

<sup>117</sup>RAPORT MBI PAVARËSINË E SISTEMIT GJYQËSOR – PJESA I: PAVARËSIA E GJYQTARËVE, miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën e tyre plenare 82. (Venecia, 12-13 Mars 2010). Faqe 10. (Shih linkun [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2010\)004-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2010)004-e)). (Qasur për herë të fundit më 24 shkurt 2016).

e Drejtorit të Sekretariatit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Shpalljen e Konkursit të Brendshëm për Prokurorë në ZKPSH dhe Vendimin për përfundimin e mandatit të prokurorit Jusuf Mejzini për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Më 1 dhjetor 2015, KPK kishte marr Vendim përmes së cilit është miratuar raporti përfundimtar për punën e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së 21 prokurorëve. Po me këtë datë KPK poashtu kishte themeluar Komisionin për Shqyrtimin e Përshtatshmërisë së Kandidatëve të Nominuar nga Shoqëria Civile për Anëtarë të KPK-së. Më 1 dhjetor 2015, KPK kishte marr Vendim përmes së cilit ishte miratuar lista e kandidatëve të nominuar për anëtarë të KPK-së, Vendim për ndryshimin e vendimit të KPK-së nr. 308/2015, Vendim për transferimin e prokurorit Rafet Halimi nga Departamenti i Përgjithshëm i PTh në Ferizaj në Departamentin e Përgjithshëm të PTh në Prishtinë, si dhe Vendim për transferimin e përhershëm të prokurorit Elez Blakaj nga PTh në Prishtinë në PSRK. Me këtë datë ishte marr edhe Vendimi për caktimin e prokurorit Lulzim Sylejmani në Komisionin për Ri-konsiderim në vend të prokurorit Jusuf Mejzini, të cilit i kishte pushuar funksioni i prokurorit për shkak të pensionimit, si dhe vendimin për themelimin e Komisionit për Shqyrtimin e Vendimit të KPK-së lidhur me angazhimin e ekspertëve.

IKD gjatë vlerësimit dhe analizimit të këtyre vendimeve ka gjetur se një numër i caktuar i këtyre vendimeve janë në kundërshtim me ligjin për KPK-në, Ligjin për Prokurorin e Shtetit apo aktet e brendshme të KPK-së. Kjo tregon në qartazi përkushtimin dhe moskujdesin e KPK-së në kuptim të marrjes së vendimeve që nuk kanë një bazë ta qartë ligjore dhe janë në kundërshtim me ligjin. Fatkeqësisht kjo praktikë e ka përcjellur në vazhdimësi këtë institucion.

Vendimi i KPK-së, me numër 334/2015, i datës 1 dhjetor 2015<sup>118</sup>, lidhur me miratimin e raportit përfundimtar për punën e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së 21 prokurorëve, ka qenë subjekt i kundërshtimit nga tre prokurorë të Departamenteve të Përgjithshme të PTh në Prishtinë dhe Gjakovë lidhur me vlerësimin dhe notimin nga Komisioni për Vlerësim të Performancës së Prokurorive. KPK nga tre ankesat e prokurorëve ka miratuar një ankesë dhe ka kërkuar nga Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve për të vlerësuar performancën e prokurorit Arian Gashi. Përderisa, ankesat e prokurorëve Fitore Sadikaj dhe Armend Hamiti nuk janë miratuar.<sup>119</sup>

Vendimi i KPK-së për ri-vlerësim të performancës së prokurorit Arian Gashi është në kundërshtim me Rregulloren për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, respektivisht, nenit 31 të kësaj rregullore<sup>120</sup>, e cila përcakton qartë se KPK si shkallë e dytë, vendos për vlerësimin e prokurorit. Në bazë të këtij neni, KPK mund të kërkoj informata shtesë nga Kryeprokurori apo prokurori i ngarkuar me detyra menaxhuese, Komisioni Vlerësues dhe të intervistoj prokurorin, i cili ka paraqitur kundërshtimin ndaj vendimit të Komisionit Vlerësues.

Për më tepër rregullorja në asnjë dispozitë nuk e parasheh që i njëjti komision, i cili ka bërë vlerësimin e të njëjtit prokuror të bëjë ri-vlerësimin, në rast të kundërshtimit. Sikurse, në çdo rast kur i njëjti komision do të bënte ri-vlerësimin dhe në bazë të ri-vlerësimit do të kishte poentim apo vlerësim

---

<sup>118</sup> Vendim për miratimin e raportit përfundimtar për punën e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve. Këshilli Prokurorial i Kosovës. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1289.2015-Vendim-Miratohet\\_Raporti\\_përfundimtar\\_per\\_punen\\_e\\_Komisionit\\_per\\_Vleresimin\\_e\\_Performances\\_se\\_Prokuroreve.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1289.2015-Vendim-Miratohet_Raporti_përfundimtar_per_punen_e_Komisionit_per_Vleresimin_e_Performances_se_Prokuroreve.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).

<sup>119</sup> Mbledhja e KPK-së e mbajtur më datës 1 dhjetor 2015. Këshilli Prokurorial të Kosovës. (Shih linkun <https://www.youtube.com/watch?v=MnPFjEkX9aY>). (Qasur për herë të fundit më 15 shkurt 2016).

<sup>120</sup> Rregullorja për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve. Këshilli Prokurorial i Kosovës. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr\\_1186\\_2013-Rregullore\\_per\\_Vleresimin\\_e\\_Performances\\_se\\_Prokuroreve.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr_1186_2013-Rregullore_per_Vleresimin_e_Performances_se_Prokuroreve.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).

tjetër nga vlerësimi i parë, siç është rasti konkret, do të diskreditonte punën e komisionit jo vetëm në rastin konkret por edhe lidhur me vlerësimin e performancës së prokurorëve tjerë.

Në rastin konkret KPK, ka shkelur procedurat dhe dispozitat e Rregullores për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, rregullore e cila ishte miratuar nga pothuajse të gjithë anëtarët e KPK-së.

Ky vendim i KPK-së, përforcon konkluzionet dhe të gjeturat e raportit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015, i cili ndër të tjera thotë se KGJK dhe KPK se nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të hartuar dhe marr vendime ne pajtim të plotë me hierarkinë e akteve normative.<sup>121</sup>

KPK më 29 dhjetor 2015, ka marr Vendim për themelimin e Komisionit Mbikqyrës në Luftimin e Korrupsionit, Krimeve Ekonomike, Sekuestrimit dhe Konfiskimit të Pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme.<sup>122</sup> IKD vlerëson KPK-në për themelimin e këtij Komisioni, me qëllim të mbikëqyrjes efektive të punës së prokurorëve dhe prokurorive në luftimin e korrupsionit në Kosovë, si dhe në arritjen e rezultateve konkrete lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale.

IKD në vazhdimësi kishte rekomanduar KPK përmes raporteve të saj periodike për themelimin e komisionit të tillë. Sidoqoftë, përmes këtij vendimi, nuk është shfuqizuar Vendimi i kundërligjshëm i Kryeprokurorit të Shtetit me numër A.nr.404/2015, përmes së cilit ishte themeluar Komisioni Mbikëqyrës për rastet penale të korrupsionit në përbërje me Zëvendës-Kryeprokuroren e Shtetit, Sevdije Morina dhe tre prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, Lulëzim Sylejmani dhe Laura Pula.<sup>123</sup>

### **c) Pjesëmarrja dhe diskutimi i anëtarëve të KPK-së në takime**

KPK gjatë muajit nëntor dhe dhjetor 2015 ka mbajtur katër takime. IKD ka vërejtur se KPK në të gjitha këto takime, asnjëherë nuk ka zhvilluar takimet në përbërje të plotë të anëtarëve. Në takimin e 107 të KPK-së ka munguar vetëm anëtari i KPK-së, sipas detyrës zyrtare, Ministri i Drejtësisë Hajredin Kuçi. Në takimin e 108, të datës 10 nëntor 2015, nga nëntë anëtarë të KPK-së, tre prej tyre kanë munguar në takim (z. Hajredin Kuçi, z. Bajram Uka dhe z. Idain Smajli). Në takimin e 109, të datës 1 dhjetor 2015, kanë munguar anëtarët e KPK-së, z. Hajredin Kuçi dhe z. Jetish Maloku. Ndërsa në takimin e 110, të datës 29 dhjetor 2015, kanë munguar z. Hajredin Kuçi, z. Idain Smajli dhe z. Sylë Hoxha.

---

<sup>121</sup> “KGJK dhe KPK kanë pasur vonesa të konsiderueshme në aprovimin e dokumenteve strategjike, rregulloreve dhe vendimeve e akteve të tjera. Ende nuk ka kapacitete të mjaftueshme për hartimin e rregulloreve dhe për marrjen e vendimeve në përputhje të plotë me aktet normative në fuqi. Në KGJK dhe KPK ka mungesë të kapaciteteve për të monitoruar zbatimin e vendimeve të tyre.” *Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015.* (Shih linkun <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/4eb17bf0-695f-4a4b-bce6-101e66ba55c9/Raporti-per-Kosoven-2015.aspx>). (Qasur për herë të fundit më 10 shkurt 2016).

<sup>122</sup> Vendim për Themelimin e Komisionit Mbikëqyrës për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike. Këshillit Prokurorial i Kosovës. (Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/395\\_Vendim\\_Themelohet\\_Komisioni\\_Mbikqyres\\_ne\\_luftimin\\_e\\_Korrupsionit\\_dhe\\_Krimeve\\_Ekonomike\\_-\\_KPK.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/395_Vendim_Themelohet_Komisioni_Mbikqyres_ne_luftimin_e_Korrupsionit_dhe_Krimeve_Ekonomike_-_KPK.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 20 mars 2016).

<sup>123</sup> “Ky vendim ka përcaktuar që Komisioni ka për detyrë të vizitojë të gjitha prokuroritë dhe të kërkojë nga secili prokuror rastet e korrupsionit që i kanë në punë, për të vlerësuar veprimet e ndërmarra nga ta. Pas verifikimit, Komisioni ka për detyrë të përgatisë raport tek Kryeprokurori i Shtetit. Një vendim i tillë është në kundërshtim me frymën e ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe cenon rëndë pavarësinë e prokurorëve në trajtimin e lëndëve individuale dhe mund të konsiderohet ndërhyrje e drejtpërdrejtë në punën e prokurorëve.” Miftaraj E. dhe Musliu B. “Luftimi i korrupsionit, prioritet në letër”. *Instituti i Kosovës për Drejtësi.* Prishtinë, dhjetor 2015. (Shih linkun: <http://kli-ks.org/luftimi-i-korrupsionit-ne-kosove-prioritet-ne-leter>). (Qasur për herë të fundit më 10 janar 2016).

Në bazë të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, kuorumi për takimet e Këshillit është me gjashtë (6) anëtarë dhe vendimet e Këshillit merren me shumicë të thjeshtë të votave nga anëtarët e pranishëm, përveç nëse ligji e përcakton ndryshe.<sup>124</sup>

IKD gjatë monitorimit të takimeve të KPK-së, ka vërejtur mungesën e debatit në mes të gjithë anëtarëve të KPK-së lidhur me pikat që kanë qenë pjesë e diskutimit. Përderisa, një numër i kufizuar i anëtarëve të Këshillit kanë marr pjesë aktive në takime të Këshillit, duke bërë vërejtjeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve lidhur me politikën, strategjitë dhe vendimet e diskutuara dhe miratuara në Këshill, një numër i madh i anëtarëve kanë qenë pasiv, dhe pjesëmarrja e vetme ka qenë gjatë procesit të votimit.

IKD gjatë monitorimit të këtyre takimeve, ka analizuar dhe llogaritur kohën që çdo anëtarë i Këshillit ka marr pjesë në diskutim për çdo pikë të rendit të ditës. Përderisa, në shumë pika të rendit të ditës pothuajse nuk ka pasur fare diskutim, dhe ku janë miratuar rregullore, janë marr vendime të rëndësishme për funksionimin e sistemit prokurorial të Kosovës.

Në takimin e 107 të KPK-së, Këshilli ka miratuar një varg vendimesh. Në këtë takim është marr Vendim për shpalljen e konkursit për prokurorë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ku nga tetë anëtarë prezent, vetëm anëtari i KPK-së nga OAK-u merr pjesë në diskutim. Asnjë anëtar tjetër i KPK-së nuk diskuton lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhe i njëjti vendim votohet në mënyrë unanime. Pikë e rendit të ditës në këtë takim ishte edhe shpallja e konkursit për tre anëtarët jo prokurorë të KPK-së. Në këtë pikë të rendit të ditës të gjithë anëtarët e KPK-së marrin pjesë në diskutim ku edhe zhvillohet debat mes të anëtarëve të KPK-së. Kjo pikë e rendit të ditës votohet me tre vota për dhe një kundër. Gjatë diskutimit të kësaj pike të rendit të ditës anëtari i KPK-së nga shoqëria civile Florent Muçaj, konteston shpalljen e konkursit për anëtarë të KPK-së nga shoqëria civile, për arsye se anëtari aktual ka mandat deri në vitin 2019 dhe se një vendim i tillë për shpalljen e konkursit është kundërkushtetues, kundër ligjor dhe kundër praktikës kushtetuese.

IKD gjatë analizës së bërë ka vlerësuar se Vendimi i lartpërmendur i miratuar nga KPK, është në kundërshtim me vetë nenin 3<sup>125</sup> të ligjit të plotësuar dhe ndryshuar për KPK-në, i cili në mënyrë të qartë përcakton se “Tre (3) anëtarët jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial, të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas nenit 65 (10) të Kushtetutës, zgjedhen me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, bazuar në një listë prej së paku tre (3) kandidatëve për secilën pozitë të propozuara nga organet përkatëse e që përfshin, një (1) anëtar nga OAK-u dhe një (1) profesor nga Fakultetet Juridike të Republikës së Kosovës.

Në bazë të këtij neni dhe praktikave të ndërtuara nga Kuvendi i Kosovës edhe lidhur me procesin e zgjedhjes së anëtarëve të KGJK-së, është kompetencë e Kuvendit të Kosovës për të shpallur konkurs për dy anëtarët e KPK-së që vijnë nga radhët e OAK-ut dhe Fakulteteve Juridike. Vendimi i KPK-së është kundërkushtetues dhe kundërligjor, dhe tejkalim i kompetencave dhe autorizimeve të saj.

Në takimin e datës 10 nëntor 2015, KPK ka marr vendim për shpalljen e zgjedhjeve për anëtarët e KPK-së nga rradhët e Prokurorëve të PSRK-së dhe të Prokurorive Themelore, për themelimin e

---

<sup>124</sup> Neni 12 pika 2 e Ligjit bazik për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Nga 1 janari 2016, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka 13 anëtarë dhe kuorumi për takime të KPK-së është nëntë anëtarë.

<sup>125</sup> Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03L224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. (Shih linkun [http://md-ks.net/repository/docs/LIGJI\\_ER\\_NDRYSHIMIN\\_DHE\\_PLOTESIMIN\\_E\\_LIGJIT\\_NR\\_03L-224\\_PER\\_KESHILLIN\\_PROKURORIAL\\_TE\\_KOSOVES-shqip.pdf](http://md-ks.net/repository/docs/LIGJI_ER_NDRYSHIMIN_DHE_PLOTESIMIN_E_LIGJIT_NR_03L-224_PER_KESHILLIN_PROKURORIAL_TE_KOSOVES-shqip.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 13 janar 2016).



Komisionit Zgjedhor të KPK-së për zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarët e KPK-së nga radhët e Prokurorëve.

IKD gjatë monitorimit të këtij takimi, ka vërejtur se mungon debati përmbajtësor nga të gjithë anëtarët prokurorë në KPK apo disa nga ta edhe nuk marrin fare pjesë në diskutim, përderisa anëtarët jo prokurorë nga OAK dhe shoqëria civile kontribuojnë në pjesën më të madhe të takimit përmes diskutimit, debatit dhe ofrimit të rekomandimeve konkrete.

Në takimin e datës 1 dhjetor 2015, KPK ka marr këto vendime:

- Vendim për themelimin e komisionit për shqyrtimin e vendimit të KPK-së me numër KPK/NR.81/2013, i datës 22 mars 2013, lidhur me angazhimin e ekspertëve,
- Vendim për ndryshimin e vendimit me numër KPK/NR.158/2015, i datës 26 qershor 2015, ku në vend të z. Jusuf Mejzini, caktohet anëtari i komisionit për ri-konsiderim z. Lulzim Sulejmani, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit,
- Vendim- Elez Blakaj, Prokuror i Shtetit me mandat të përhershëm në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, transferohet me detyrë të përhershme në PSRK,
- Vendim-Shpend Krasniqi Prokuror në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, transferohet në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm,
- Vendim për miratimin e listës së kandidatëve të nominuar për anëtarë të KPK-së
- Vendim për miratimin e raportit përfundimtar për punën e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, përkitazi me vlerësimin e dyte të 21 Prokurorëve të Shtetit me mandat të përhershëm.

Pjesëmarrja e anëtarëve të KPK-së në debat dhe diskutim pothuajse është minimale. Gati të gjitha rregulloret dhe vendimet e miratuara në këtë takim kanë kaluar pa asnjë debat apo diskutim nga anëtarët e KPK-së. Miratimi i tillë i dokumenteve në KPK jep përshtypjen së Këshilli është kthyer në një makineri votimi, dhe votohet çdo dokument apo strategji që paraqitet nga Komisioni për Akte Normative, duke mos vlerësuar fare nëse të njëjtat dokumente janë në pajtim apo harmoni me Kushtetute apo ligj. Në bazë të vlerësimit të bërë nga IKD, del se KPK symbyllurazi i beson akteve të paraqitura nga Komisioni për Akte Normative, Komisionet tjera apo grupet punuese të themeluara nga KPK. Kjo në praktikë po rezulton me miratim të dokumenteve dhe politikave në Këshill që janë në kundërshtim me hierarkinë e normativës ligjore, dhe jo rrallë here vendimet e KPK-së të jenë të bazuara në interesa personale të personave të caktuar qoftë në Këshill apo në institucionin e Prokurorit të Shtetit. Kjo praktikë e zbatuar nga KPK, është kritikuar edhe nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2015, i cili thekson: *“KGJK dhe KPK janë ballafaquar me vonesa të mëdha në miratimin e dokumenteve strategjike, rregulloreve dhe vendimeve apo akteve tjera. Ende nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të hartuar rregullore apo marr vendime në përputhje të plotë me*

*hierarkinë e aktive normative. Ka mungesë të kapaciteteve brenda KGJK dhe KPK për të monitoruar zbatimin e vendimeve të tyre”.*<sup>126</sup>

Edhe në këtë takim dallohen anëtarët jo prokurorë me pjesëmarrje aktive në debat dhe diskutim gjatë shqyrtimit të rregulloreve dhe vendimeve në Këshill. Përderisa, shumica e anëtarëve prokurorë nuk marrin fare pjesë në diskutim.

Në takimin e datës 29 dhjetor 2015, KPK ka miratuar: Planin e Punës së Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive për vitin 2016, ka miratuar Rregulloren për Zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës-kryesuesit të KPK-së, Rregulloren për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së, për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit, për vlerësimin e performancës së prokurorive, është miratuar Plani strategjik (2016-2018) dhe plani i veprimit për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme, është themeluar Njësi për luftimin e korrupsionit, krimeve ekonomike dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme në departamentin e përgjithshëm dhe departamentin për krime të rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, është themeluar Komisioni Mbikqyrës në luftimin e korrupsionit, krimeve ekonomike dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme dhe raporti financiar për Prokurorin e Shtetit për vitin 2015.

Edhe në këtë takim të KPK-së ku janë miratuar një varg i politikave dhe dokumenteve strategjike që ndërlidhen me funksionimin e sistemit prokurorial, mungon debati dhe diskutimi në mes të anëtarëve të KPK-së. Po thuajse në të gjitha vendimet e miratuara në këtë mbledhje kalojnë pa pyetje, diskutim apo kërkesa për sqarime nga raportuesit e këtyre pikave të rendit të ditës. Pothuajse të gjitha rregulloret e propozuara nga Komisioni për Akte Normative apo grupet punuese të themeluara nga KPK, kalojnë dhe votohen nga anëtarët e KPK-së.

#### **d) Transparenca e KPK në publikimin e rregulloreve, strategjive dhe vendimeve**

KPK gjatë muajit nëntor dhe dhjetor ka miratuar dhe publikuar Rregulloret e më poshtme:

- Rregullore për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve;
- Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Funksionimin e Prokurorit të Shtetit;
- Rregullore për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Rregullore për Zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Rregullore për Komisionin për Çështje Normative;
- Rregullore për Ndarjen e Lëndëve;
- Rregullore për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit;
- Rregullore për Emërimin e Kryeprokuroreve;

---

<sup>126</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015. Faqe 13. (Shih linkun [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 10 shkurt 2016).

- Rregullore për Skemën e Kompenzimit të Anëtarëve dhe Komisioneve të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Rregullore për Punën e Komisionit Disiplinor dhe Procedurën Disiplinore ndaj Prokurorëve;
- Rregullore për Zgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Rregullore për Përcaktimin e Rregullave dhe Procedurave për Organizimin e Provimit për Kandidatët për Prokurorë.
- KPK gjatë muajit dhjetor ka miratuar Planin strategjik (2016-2018) dhe planin e veprimit për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. I njëjti plan strategjik dhe plani i veprimit nuk janë publikuar në uebfaqet e KPK-së dhe Psh-së.
- KPK gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit 2015, ka miratuar dhe publikuar gjithsejt njëzet (2) Vendime.
- KPK gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit 2015, ka miratuar planin e punës së Njësitit për Shqyrtimin e Përformancës së Prokurorëve.
- Në uebfaqen e KPK-së, pothuajse asnjë rregullore, vendim apo dokumente tjera nuk janë të publikuara në gjuhën serbe.

## VIII. REKOMANDIMET

IKD duke pasur parasysh të gjitha obligimet e pazbatuara nga pakoja e ligjeve të gjyqësorit si dhe obligimet e reja, të cilat kanë dalë si rezultat i plotësimit ndryshimit të pakos së ligjeve të gjyqësorit, nxjerrë një varg rekomandimesh konkrete për Ministrinë e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës. Përpilimi i këtyre rekomandimeve është bërë si rezultat i hulumtimit ligjor dhe standardeve ndërkombëtare që ndërlidhen me pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit. Zbatimi i këtyre rekomandimeve konkrete do të ndikojë në rritjen e pavarësisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë dhe gjithashtu do të mundësohet zbatimi efikas dhe i efektshëm i pakos së ligjeve të gjyqësorit. Në vazhdim IKD ka paraqitur rekomandimet specifike për secilin institucion.

### a) Rekomandimet për Ministrinë e Drejtësisë

1. Ministria e Drejtësisë të inicioj amendamentimin e nenit 105 paragrafi 1 dhe nenit 109 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me mandatin fillestar për gjykatës dhe prokurorë. Rekomandohet të hiqet mandati fillestar dhe emërimet të jenë të përhershme me rastin e dekretimit të gjykatësve dhe prokurorëve.
2. Ministria e Drejtësisë rekomandohet që përmes plotësimit ndryshimit të parasheh dispozita kalimtare lidhur me trajtimin e lëndëve që janë aktualisht në punë në ZPD. Përmes ndryshimeve duhet të adresohet çështja e afateve kohore të trajtimit të rasteve nga ZPD, Komisionet Disiplinore dhe Këshillat, të cilat duhet të përshtaten me kontekstin dhe specifikat e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Kufizimi i përcaktuar prej një viti, duhet të rishikohet dhe ky afat të zgjatet në së paku dy vite. Duke pasur për bazë resurset aktuale të ZPD-së dhe numrin e madh të lëndëve në këtë zyrë, IKD rekomandon që *“procedura disiplinore ndaj gjykatësve dhe prokurorëve nuk do të fillohet dhe zbatohet në Komisionin Disiplinor të KGJK*

*dhe KPK, pasi që të kaloj afati dy (2) vjeçar nga njoftimi i pranuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, për shkeljen e supozuar dhe gjashtë (6) vite nga dita shkeljes së supozuar”.*

3. Sa i përket afatit kohor për trajtimin e rasteve të dorëzuara nga ZPD, IKD rekomandon që Komisioni Disiplinor të përfundojë rastin si shkallë të parë brenda afatit prej gjashtë (6) muaj. Ndërsa, në rastet e ankesave, KGJK dhe KPK rekomandohet që trajtimin e këtyre rasteve ta përfundojë brenda afatit kohor prej tre (3) muajve.
4. Ministria e Drejtësisë rekomandohet të përcaktojë dispozita ligjore në të gjitha rastet e iniciuara nga ZPD për shkelje të supozuara ndaj gjykatësve dhe prokurorëve, duhet të përfundohen për të vërtetuar shkeljet dhe për të mbajtur përgjegjës. Në rastet kur këta gjykatës apo prokurorë bëjnë kërkesë për dorëheqje, e njëjta nuk duhet t’iu aprovohet deri në përfundimin e procedurave të iniciuara disiplinore. Sikurse në rastet kur gjykatësi dhe prokurori ka dhënë dorëheqje dhe ka informacion tek ZPD se të njëjtit kanë mundur të kryhen shkelje disiplinore, të njëjtit duhet të ndiqen për të vërtetuar shkeljet e supozuara dhe t’u shqiptohen masa disiplinore.
5. Çështja e pavarësisë së ZPD-së duhet të adresohet me urgjencë në mënyrë që të garantohet funksionimi i pavarur i kësaj zyre, përmes së cilës do të mundësohet rritja e llogaridhënies së bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale dhe ngritjes së besimit të publikut në këto institucione.
6. Plotësim ndryshimi i ligjeve të lartpërmendura duhet të siguroj mbrojtjen efektive gjyqësore lidhur me vendimet e dy Këshillave (KGJK dhe KPK) në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me vendimet që ndërlidhen me disiplinimin, emërimin, ri-emërimin, propozimin për shkarkim, vlerësimin dhe transferimin e gjykatësve dhe prokurorëve.

#### **b) Rekomandimet për Kuvendin e Kosovës**

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të shpreh vullnetin e plotë për të amandamentuar Kushtetutën lidhur me nenin 105 (1) dhe 109 (5) lidhur me mandatin fillestar për gjykatës dhe prokurorë. Komisioni i Venecias rekomandon që gjykatësit dhe prokurorët të emërohen me mandat të përhershëm deri në pensionim.

#### **c) Rekomandimet për Këshillin Gjyqësor të Kosovës**

1. Duke pasur parasysh sfidat dhe pengesat me të cilat është ballafaquar sistemi gjyqësor në zbatimin e Planit Strategjik 2007-2012, dhe mungesës së vullnetit për të zbatuar obligimet dhe përgjegjësitë që kanë dalë nga ky plan, është e domosdoshme që KGJK në bashkëpunim me Gjykatën Supreme dhe Kryetarët e Gjykatave të ngritin nivelin e koordinimit, bashkëpunimit dhe llogaridhënies në zbatimin e objektivave që dalin nga Plani Strategjik i Gjyqësorit të Kosovës 2014-2019.
2. Koordinatorin e caktuar nga KGJK për monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik rekomandohet të përgatisë raporte dhe të raportojë rregullisht në KGJK lidhur me zbatimin e Planit Strategjik. KGJK rekomandohet që raportimet e Koordinatorit të caktuar për monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik t’i shqyrtojë me seriozitet në mënyrë që të njëjtat të prodhojnë efektet e duhura për të arritur objektivat e përcaktuara me plan.
3. KGJK rekomandohet që të ketë prioritet miratimin e Rregullores për Klasifikimin dhe Kualifikimin e Dokumenteve në Sistemin Gjyqësor të Kosovës. Plotësim ndryshimi i ligjit për Gjykatat parashihet se gjykatat publikojnë aktgjykimet e plotëfuqishme në faqë zyrtare të

internetit në afat orej 60 ditësh nga data e arritjes së plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale. Më qëllim të zbatimit të këtij obligimi dhe obligimeve tjera lidhur me dokumentet tjera në sistemin gjyqësor, KGJK duhet të bëjë miratimin e rregullave, kritereve dhe procedurave lidhur me kualifikimin dhe klasifikimin e dokumenteve. Kjo do të lehtësonte komunikimin mes sistemit gjyqësor me media, publikun dhe palët e interesuara sikurse do të rristë nivelin e sigurisë së dokumenteve dhe kufizimin e qasjes në këto dokumente të personave të paautorizuar.

4. Rekomandohet përgatitja e udhëzimeve për zbulimin e informatave në mënyrë që të rritet komunikimi aktiv dhe gjithëpërfshirës mes Këshillave dhe publikut, dhe i njëjti të jetë i bazuar në ligj. Rekomandohen trajnime specifike për çështje të marrëdhënieve me publikun për anëtarët e Këshillit, gjykatësit, zëdhënësit dhe personelin mbështetës. Klasifikimi dhe kualifikimi i dokumenteve dhe informacioneve në sistemin gjyqësor duhet të jetë në harmoni me obligimet që dalin nga ligji për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.
5. KGJK rekomandohet që të ketë prioritet miratimin e Rregullores për Komunikim me Publikun dhe Mediat. Miratimi i kësaj rregulloreje duhet të përcaktoj procedurat, kriteret dhe mënyrën e bashkëpunimit mes KGJK-së, Gjykatave me publikun, mediat dhe palët e interesuara.
6. Rekomandohet të bëhet zhvillimi i kapaciteteve për planifikim strategjik dhe menaxhim, duke krijuar Zyrën për Planifikim Strategjik në KGJK ose të paktën të caktojë zyrtarë për zbatimin e këtyre aktiviteteve, siç përcaktohet në Planin Strategjik të Gjyqësorit 2014-2019.
7. KGJK të ndërtoj mekanizëm për të obliguar Kryetarët e Gjykatave që të raportojnë para Këshillit sipas obligimeve që dalin nga ligji, të ushtrojë mbikëqyrje efektive, respektivisht të mbajë përgjegjës Kryetarët e Gjykatave Themelore në rastet kur nuk respektojnë obligimet për raportim në KGJK në baza periodike.
8. KGJK rekomandohet të miratoj Rregulloren për Publikimin e Aktgjykimeve. KGJK ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ, por i cili nuk plotëson nevojat dhe kërkesat e ligjit dhe standardeve ndërkombëtare për rregullimin e çështjes së publikimit të aktgjykimeve. Prandaj, IKD rekomandon miratimin e Rregullores, e cila duhet të përcaktoj procedurat që duhet të zbatohen nga të gjitha gjykatat gjatë zbatimit të këtij obligimi, duke përfshirë përgjegjësitë e zyrtarëve dhe afateve që do të caktohen dhe respektohen në implementimin e obligimeve që dalin nga ligji.
9. KGJK duhet të krijojë infrastrukturë dhe resurse të nevojshme njerëzore dhe profesionale për të mundësuar publikimin e aktgjykimeve/vendimeve përfundimtare të Gjykatave të të Kosovës, në përputhje me obligimet ligjore. Kujdes të shtuar duhet kushtuar mbrojtjes së të dhënave personale, krijimit të infrastrukturës adekuate, trajnimit dhe specializimit të zyrtarëve përgjegjës.
10. KGJK rekomandohet të miratoj Rregulloren për Gjykatën Supreme rreth menaxhimit, caktimit të gjykatësve dhe caktimit të kolegjeve dhe kryesuesve të kolegjeve.
11. KGJK rekomandohet të miratoj Rregulloren për Gjykatën e Apelit rreth caktimit të gjykatësve në Departamente për të siguruar efikasitet në trajtimin e lëndëve, caktimin e udhëheqësve të departamenteve sipas nevojës dhe që siguron se secila lëndë i caktohet kolegjeve.

12. KGJK rekomandohet të miratojë Rregullore për Procedurën e Përzgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe të Kryetarëve të Gjykatave.
13. KGJK rekomandohet të ndryshojë dhe plotësojë Rregulloren aktuale për Vlerësimin e Performancës së Gjykatësve.
14. KGJK rekomandohet të miratojë Rregullore për Rregullat dhe Procedurat që Qeverisin Ankesat ndaj vendimeve të KGJK-së rreth zhvendosjes së përhershme apo transferimit kundër vullnetit të Gjykatësve që tejkalojnë periudhën gjashtë (6) mujore.
15. KGJK dhe KPK duhet të ndryshojnë dhe plotësojnë Rregulloren e KGJK-së për Funkcionimin e Zyrës së ZPD-së ku përcaktohet në mënyrë të qartë çështja e mandatit të Drejtorit të ZPD-së, e cila rregullore do të jetë në fuqi deri në miratimin e ligjit të veçantë për Zyrën e Prokurorit Disiplinor.

#### **d) Rekomandimet për Këshillin Prokurorial të Kosovës**

1. KPK rekomandohet të rishikojë Planin Strategjik për Bashkëpunim Ndër-institucional në Luftën Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit 2013-2015. Rishikimit të planit strategjik duhet të i paraprijë analiza dhe vlerësimi i riskut lidhur me veprat penale karakteristike, duke përfshirë objektivat dhe rezultate të matshme dhe pritshme, mbi të cilat prokurori i shtetit në bashkëpunim dhe koordinim me Policinë dhe agjencitë tjera që zbatojnë ligjin do të drejtonin aktivitetet dhe veprimet e tyre në parandalimin dhe luftimin efikas dhe të suksesshëm të kriminalitetit.
2. KPK rekomandohet të rishikojë Planin Strategjik (2016-2018) dhe Planin e Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme.
3. KPK rekomandohet të miratojë Rregulloren për Klasifikimin dhe Kualifikimin e Dokumenteve në Sistemin Prokurorial të Kosovës. Klasifikimi dhe kualifikimi i dokumenteve dhe informacioneve në sistemin prokurorial duhet të jetë në harmoni me obligimet që dalin nga ligji për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.
4. KPK rekomandohet të miratojë Rregulloren për Komunikim me Publikun dhe Median. Miratimi i kësaj rregulloreje do të përcaktonte procedurat, kriteret dhe mënyrën e bashkëpunimit mes KPK-së, prokurorive me publikun, mediet dhe palët e interesuara.
5. KPK rekomandohet të miratojë Rregullore për Procedura Disiplinore efektive (për prokurorë, anëtarët e KPK-së). KPK në pajtim me plotësim ndryshimet e LKPK, rekomandohet të ndryshoj Rregulloren për Komisionin Disiplinor të KPK-së për prokurorë, përbërjen e Komisionit Disiplinor, trajtimin e lëndëve disiplinore nga Komisioni Disiplinor dhe KPK, në afate të arsyeshme kohore, etj.
6. KPK rekomandohet të miratojë Rregulloren për Përgjegjësinë Disiplinore të Anëtarëve të KPK-së. Miratimi i kësaj rregulloreje ka rëndësi të veçantë për ngritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së anëtarëve të KPK-së gjatë ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësisë të tyre sipas ligjit dhe akteve të brendshme të KPK-së.
7. KPK rekomandohet të miratojë Rregulloren për Standardizim lidhur me Ligjërimin e Prokurorëve. Pjesëmarrja e prokurorëve në aktivitetet të jashtme profesionale, duke përfshirë

ligjërimin në universitete publike apo private duhet të jetë i bazuar në rregulla dhe procedura të miratuara në KPK, me qëllim të ruajtjes së imazhit të sistemit prokurorial karshi publikut.

8. KPK rekomandohet të miratojë Procedurat Standarde të Veprimit lidhur me evitimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit nga anëtarët e KPK-së. Perceptimi dhe besimi i publikut, prokurorëve dhe stafit mbështetës në vendimet e miratuara nga KPK gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre është i një rëndësie të veçantë. Andaj, KPK dhe anëtarët e KPK-së duhet të zbatojnë standarde të larta profesionale dhe të evitojnë çdo situatë nga e cila mund të fitohet perceptimi i publikut, medias apo qytetarëve se vendimet e tilla janë të bazuara apo mund të ketë perceptim se janë të bazuara në interesa personale apo pasurore.
9. KPK rekomandohet të miratojë Rregullore për Rregullat dhe Procedurat që Qeverisin Ankesat ndaj vendimeve të KPK-së rreth zhvendosjes së përhershme apo transferimit kundër vullnetit të Prokurorëve që tejkalojnë periudhën gjashtë (6) mujore.
10. KPK duhet të miratojë Rregullore të veçantë për bashkëpunëtorët profesional dhe praktikant në Prokurori.